Edhe pse kanë kaluar mbi 32 vite tashmë, Luan Leka i mban mend sikur të kishin ndodhur dje, ndjenjat e dyzuara më të cilat përcillte procesin e ndryshimit të sistemit. Ishte zyrtar i lartë në Drejtorinë Mekanike, institucion ky që varej në atë kohë nga Ministria e Industrisë dhe Minerave dhe që kishte për detyrë të siguronte lëndë të para për industrinë e ndryshme. Tkurrja e punës se shumë ndërmarrjeve të industrisë ishte një parathënie e vështirësive dhe e pasigurisë që po skicohej edhe për zyrtarët e asaj kohe të çdo niveli. Ndaj, përjetimit të ankthit që vjen nga pasiguria për të ardhmen nuk kishte si t'i shpëtonte as Luan Leka. Nga ana tjetër, brenda kuadrin të detyrës së tij, duke sfiduar ndërkohë edhe vështirësitë, por duke bërë një aksion spektakolar menaxhimi, ai arriti të siguronte lëndën e parë në Itali për një ndërmarrje, me gjysmën e çmimit me të cilin e blinte shteti. Dhe në sajë të kësaj lëvizjeje arriti të fitonte rreth 8500 dollarë. Sot, pas 32-33 viteve, ai i referohet me një krenari legjitime këtij kujtimi.

"8500 dollarë, në kushtet, kur një familje në atë kohë i kishte shpenzimet mujore 100 dollarë, do të

Even though more than 32 years have passed, Luan Leka remembers the mixed feelings he had during the system change as if it were yesterday. At that time, he was a senior official in the Mechanical Directorate, an institution under the Ministry of Industry and Mines, responsible for securing raw materials for various industries. The shrinking operations of many industrial enterprises were a prelude to the difficulties and uncertainties facing officials at all levels. Thus, Luan Leka could not escape the anxiety of an uncertain future. However, within the scope of his duties, he made a spectacular management move by securing raw materials from Italy for a company at half the price the state was paying. Thanks to this move, he earned about 8,500 dollars. Today, he looks back on this memory with legitimate pride.

"8,500 dollars, at a time when a family's monthly expenses were 100 dollars, meant securing about 8 years of family sustenance. And that's exactly what I told my wife: we have



thotë të siguroje rreth 8 vjet bukën e familjes. Dhe pikërisht kështu i thosha gruas: kemi siguruar bukën për 8 vite”, kujton sot biznesmeni i mirënjohur.

Megjithatë, fitimi i një shume të tillë, gjë e pazakontë për kohën, nuk është se e vetëkënaqi. Përkundrazi, e nxiti akoma më shumë në këtë rrugë. Ndaj më pas filloi të sjellë karrige dhe tavolina plastike. “Gjysma e lokaleve të asaj kohe janë mobiluar me produktet që tregtoja unë”, thotë ai. Pikërisht në këto momente, Ministri i atëhershëm i Industrisë, Abdyl Xhaja e thërret dhe i thotë që është përzgjedhur për zv. Ministër. Pra një udhëkryq tjetër shfaqet para Luan Lekës, ku, nga alternativa që do zgjidhte do të përcaktohej edhe e ardhmja. “Por, unë tashmë e kisha bërë zgjedhjen, pasi, përveçse isha nën euforinë e një biznesi që ecte mirë, kisha konsoliduar ndërkohë edhe idenë e hapjes së një fabrike salami”, tregon ai.

Dhe kështu, një ditë të bukur të vitit 1993, në ambientet e ish-markatës së “21 Dhjetorit” mori rrugë fabrika e përpunimit të mishit “EHW”. Nuk ishte ndër të parat fabrika të sektorit, pasi në atë kohë kishte mbi 30 prodhues sallami. Por, i qartë për mënyrën se si do të ecte para, ku cilësia do të ishte kali kryesor i luftës, Luan Leka arriti të joshte e t’i merrte ish-Kombinatit të Mishit disa prej specialistëve më të zotë të tij, duke u ofruar paga pesë herë më të larta sesa ato që merrnin në vendin e mëparshëm të punës.

Udhëtimi i kompanisë EHW nga viti në vit ishte i pandalshëm. Aktiviteti i saj njihje vetëm rritje. Ndonëse numri i kompanive prodhuese në sektorin e përpunimit të mishit ka qenë i lartë kurdoherë, sërish EHW duket sikur e ka pasur

secured bread for 8 years,” recalls the well-known businessman today.

However, earning such an amount, unusual for the time, did not satisfy him. On the contrary, it spurred him even more. He then began to import plastic chairs and tables. “Half of the venues at that time were furnished with the products I traded,” he says. At that moment, the then Minister of Industry, Abdyl Xhaja, called him and told him he was selected to be Deputy Minister. Another crossroads appeared before Luan Leka, where his choice would determine his future. “But I had already made my choice, as, besides being in the euphoria of a thriving business, I had also consolidated the idea of opening a salami factory,” he says.

And so, on a beautiful day in 1993, in the premises of the former “21 Dhjetori” market, the meat processing factory “EHW” began. It was not among the first factories in the sector, as there were over 30 salami producers at that time. But, with a clear vision where quality would be the main focus, Luan Leka managed to lure some of



betejën vetëm me vetveten. Duke u përsosur. Duke rritur standardet. Duke u investuar në mënyrë sistematike. Duke rritur numrin e produkteve. Dhe duke akumuluar vit pas viti, suksese në përmasa aq të mëdha, sa pikërisht këto u bënë premisa për ta zgjeruar aktivitetin, me blerjen edhe të kompanive të tjera.

Fillimisht u ble “Uji Qafshatama”, një veprim biznesi ky që shkonte në harmoni të plotë me filozofinë e Luan Lekës si biznesmen, për t’u përqëndruar vetëm në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të konsumit të përditshëm. Kur e bleu kompaninë “Qafshatama”, ajo ishte thjesht një kapanon i rëndomtë i ambalazhimit të një uji shumë të mirë. Më pas, u ndërtua një fabrikë moderne, ndërsa kohët e fundit u investua dhe u ndërtua edhe një fabrikë tjetër, akoma më e madhe se e mëparshmeja. Duke e kthyer kështu ujin “Qafshatama” në një konkurent të fortë në treg.

Në historikun e Lekës si biznesmen, si një nga veprimet më të bukura të biznesit përfshihet blerja e “Conad Albania”. Kur i erdhi propozimi për ta blerë këtë rrjet të njohur supermarketesh, situata që po përjetonte Conad në Shqipëri ishte e pafavorshme. Për aq kohë sa kishte funksionuar në Shqipëri, Conad kishte akumuluar humbje sistematike, duke u ndjekur në këtë fat të keq edhe nga supermarketet e tjera të njohura si Mercator, Carrefour, etj. Ndaj, duhej një vision i madh, një strategji e qartë, një vetëbesim i palëkundshëm në aftësitë menaxhuese të vetvetes për t’u përgjigjë pozitivisht ofertës për blerje. Luan Leka i kishte të gjitha këto cilësi,

the best specialists from the former Meat Combine, offering them salaries five times higher than their previous jobs.

The journey of the EHW company from year to year was unstoppable. Its activity only grew. Although the number of manufacturing companies in the meat processing sector has always been high, EHW seemed to have had the battle only with itself. By perfecting its methods, raising standards, investing systematically, increasing the number of products, and accumulating successes year after year, these achievements laid the foundation for expanding its activity by acquiring other companies.

First, “Qafshatama Water” was bought, a business move that fully aligned with Luan Leka’s philosophy as a businessman, focusing solely on producing and trading daily consumption products. When he bought the “Qafshatama” company, it was just a regular packaging warehouse for very good water. Later, a modern factory was built, and recently another even larger factory was established, turning “Qafshatama” water into a strong competitor in the market.

One of the most notable business moves in Leka’s career was the purchase of “Conad Albania”. When he received the proposal to buy this well-known supermarket chain, Conad’s situation in Albania was unfavorable. It had accumulated systematic losses, similar to other well-known supermarkets like Mercator and Carrefour. A great vision, clear strategy, and unwavering confidence in his managerial abilities were needed





ndaj vendosi ta pranonte sfidën, duke u bërë me kalimin e kohës pronar i pothuajse të gjithë kuotës së aksioneve të “Conad Albania”. Dhe, që nga çasti që u bë pronar, filloi administrimin e rreptë të kompanisë, duke mbyllur supermarketet që dilnin sistematikisht me humbje, duke i zëvendësuar ato me të reja, duke kontrolluar kostot, duke ofruar vetëm produkte të cilësisë së lartë, etj. Rezultatet nuk munguan. Humbjet erdhën duke u zvogëluar brenda një periudhe të arsyeshme kohe dhe më pas, kompania filloi duke dalë me fitim. Tashmë nuk bëhet më fjalë nëse ajo do regjistrojë ose jo fitim në fund të vitit ushtrimor, por kureshtja është se sa është rritur fitimi i saj krahasuar me një vit më parë.

Së fundmi, Conad i është nënshtruar një tjetër veprimi reformues. Nëse deri tani produktet e tij janë shitur në supermarketet e kompanisë, por edhe me franchise, tashmë kompania ka vendosur t’i tregtojë produktet e saj vetëm në supermarketet e veta. Krahas tri supermarketeve të mëdha që janë hapur së fundmi në Tiranë, Durrës e Fier, janë në process edhe tri të tjera. Arsyeja pse u bë i nevojshëm ky hap lidhet me dëshirën e kompanisë Conad Albania për të ruajtur dhe forcuar sa më shumë reputacionin e vet. Që, për hir të vërtetës, duhet thënë se me mënyrën e mëparshme të bashkëpunimit, nuk garantohej në maksimum.

Gjatë vitit 2023, Grupi “EHW” e vazhdoi traditën e rritjes së vazhdueshme, duke regjistruar rreth 145 milionë euro xhiro biznesi në tri kompanitë.

to respond positively to the purchase offer. Luan Leka had all these qualities, so he decided to accept the challenge, becoming, over time, the owner of almost the entire share of “Conad Albania”. From the moment he became the owner, he began strict management of the company, closing consistently loss-making supermarkets, replacing them with new ones, controlling costs, and offering only high-quality products.

The results were evident. The losses shrank within a reasonable period, and then the company began to turn a profit. Now, it’s no longer a question of whether it will record a profit at the end of the fiscal year, but rather how much its profit has increased compared to the previous year. Recently, Conad has undergone another reform. Previously, its products were sold in the company’s supermarkets and through franchises. Now, the company has decided to sell its products only in its supermarkets. Alongside the three large supermarkets recently opened in Tiranë, Durrës, and Fier, three more are in the process. This step was necessary to preserve and strengthen Conad Albania’s reputation as much as possible, which was not fully guaranteed with the previous cooperation model.

In 2023, the “EHW” Group continued its tradition of continuous growth, registering about 145 million euros in business turnover across the three companies.





AVNI PONARI

CEO i "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA"

Emri i kompanisë: Sigal Uniqa Group Austria
(Sigal Shqipëri, Sigal Kosovë, Sigal Maqedoni,
Sigal Jetaë, Fondi i Pensioneve Sigal)

Xhiro e biznesit 2023: 110 million EURO
Ndryshimi në % 23/22: +25

**Numri i punonjëseve
dhe agjentëve:** 2100
Vendndodhja: Tiranë, Prishtinë, Shkup

AVNI PONARI

CEO of SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Company Name: Sigal Uniqa Group Austria
(Sigal Shqipëri, Sigal Kosovë, Sigal Maqedoni,
Sigal Jetaë, Fondi i Pensioneve Sigal)

Turnover 2023: 110 million EUR
Difference in % 23/22: +25

**No. of employees
and agents:** 2100
Location: Tirana, Prishtina, Skopje

Teksa lëvizte me makinë në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Avni Ponarit i zunë sytë ish-Ministrin nga i cili varej institucioni ku ai punonte si oficer marine. Ishte Ministri që si rezultat i mospëlqimit të një fejtoni, të shkruar nga Ponari e të botuar në gazetën e ushtrisë, u angazhua personalisht që Avni Ponari të largohej nga profesioni që ai e donte aq shumë. Ishte Ministri, që me vendimin e tij, i dha Avni Ponarit ankthin e parë që vjen nga papunësia. Ishte Ministri, i cili me veprimin e tij e ballafaqoi oficerin e ri dhe babain e dy fëmijëve të vegjël me shqetësimin dhe pasigurinë që të jep papunësia.

Tashmë me një status të ri, Avni Ponari ndaloi makinën afër ish-eprorit të tij, doli nga makina, i dha dorën dhe e pyeti: “A më njeh?”

“Sigurisht që të njoh”, iu përgjigj ish-Ministri, me një buzëqeshje në fytyrë, e ndoshta i përgatitur psikologjikisht edhe për ndonjë shfryrje mllëfi

As he drove along Boulevard “Dëshmorët e Kombit,” Avni Ponari noticed the former Minister from whom the institution he worked for as a naval officer was dependent. It was this Minister who, due to dissatisfaction with an article Ponari wrote and published in the military newspaper, personally ensured Ponari’s departure from the profession he cherished. It was the Minister who, with his decision, introduced Avni Ponari to the first anxiety stemming from unemployment. It was the Minister who confronted the young officer and father of two small children with the worry and insecurity that unemployment brings.

Now with a new status, Avni Ponari stopped his car near his former superior, got out of the car, extended his hand, and asked, “Do you recognize me?” “Of course I do,” replied the former Minister, with a smile, perhaps psychologically

nga ana e “viktimës” së tij të dikurshme. Por ajo që ndodhi ishte e kundërta e asaj që mund të presupozonte. Ponari nxori një kartëvizitë nga xhepi dhe ia la në dorë duke e shoqëruar me fjalët: “Sa herë të kesh nevojë, për çdo gjë që të kesh nevojë dhe kurdoherë që të kesh nevojë, trokit në derën time pa ngurrimin më të vogël”.

Po pse kjo ofertë bujare? Ç’ishte deklarimi i këtij disponimi dashamirës? Shprehje konsiderate dhe vlerësimi prej Avni Ponarit për ish-eporin që e shkarkoi nga puna? Sjellje sipas predikimit kristian për të mos iu përgjigjur tjetrit “sy për sy e dhëmbë për dhëmbë”? Asnjëra nga këto. Hapja e derës, dhënia e lejes për të trokitur kurdoherë aty për çfarëdo lloj nevoje ishte thjesht një veprim në bazë të një konkluzioni filozofik. Ishte një veprim që u bë si rrjedhojë e të shikuarit pozitivisht të gjërave dhe të ngjarjeve.

Shkarkimi nga puna, edhe pse me preteks qesharak, ishte njëri nga gurët e themelit, me të cilin më pas Avni Ponari ndërtoi perandorinë “SIGAL”. Pas këtij shkarkimi ai u fut në industrinë e sigurimeve, duke mbuluar kryesisht sigurimet e mjeteve motorike dhe të anijeve në udhëtim. Por kur edhe nga kjo punë pati telashe të tjera me eporët, atëherë kupa u mbush. Nuk mendoi më për punësimin e radhës, gjë që do t’i sillte problemet e radhës. Por mendoi të mos humbë më kohë, shfrytëzoi ligjin e porsadalë për liberalizimin e tregut të sigurimeve, aplikoi për të marrë licencën e kompanisë private, të projektuar në kokën e tij mbi bazën e një vizioni pa limite dhe filloi punën për konkretizimin e tij. Gjithë ditëve rrugëve të Shqipërisë, qytet më qytet për të ngritur rrjetin e shitjes së policave të sigurimit. Gjithë ditën me përpjekje të stërmundimshme për të krijuar “ushtrinë” e siguruesve. Në ditë të caktuara ka rastisur të përshkojë edhe 1000 kilometra brenda ditës, duke shkuar në 5 qytete të Shqipërisë nga Veriu në Jug. Dhe bëhet fjalë për një kohë kur rrjeti rrugor ishte i shkatërruar dhe udhëtimi me automjet ishte torturë e vërtetë. Gjithë ditën në punë në funksion të “SIGAL”-it, kësaj “foshnje” që sapo kishte lindur e duhej të rritej, ndërkohë që në darkë kthehej tek fëmijët që i kishin munguar përgjatë ditës. Por sapo

prepared for any lingering resentment from his former “victim.” But what happened was the opposite of what one might expect. Ponari pulled out a business card from his pocket and handed it over, saying, “Whenever you need anything, for any reason, and whenever you need it, knock on my door without hesitation.”

But why such a generous offer? Was it a declaration of goodwill? A considerate expression and appreciation from Avni Ponari towards the former superior who had fired him? A Christian-like behavior of not answering “eye for an eye, tooth for a tooth”? None of these. Opening the door, giving permission to knock anytime for any need was simply an action based on a philosophical conclusion. It was an action taken as a result of a positive outlook on things and events.

Dismissal from his job, though on a ridiculous pretext, was one of the foundational stones with which Avni Ponari later built the empire of “SIGAL.” After this dismissal, he entered the insurance industry, primarily covering motor vehicle and travel insurance. But when he faced troubles again with superiors in this job, the cup was full. He no longer thought about the next employment, which would bring its own problems. Instead, he thought not to waste any more time, utilized the law of open market for insurance liberalization, applied for the license of the private company designed in his head based on an unlimited vision, and started working to materialize it. All day on the roads of Albania, city by city, to establish the sales network of insurance policies. All day with tireless efforts to create an “army” of insurers. On certain days, he managed to cover up to 1000 kilometers within a day, visiting 5 cities of Albania from north to south. And this is a time when the road network was in disrepair and driving was a real torture. All day at work for “SIGAL,” this “baby” that had just been born and needed to be nurtured, while in the evening he returned to his children whom he had missed throughout the day. But as soon as he began to calm down and relax somewhat physically from the long and exhausting day, his mind was back on “SIGAL,”



niste të qetësohej e të çlodhej disi fizikisht nga dita e gjatë dhe e mundimshme, mendja i rrinte tek “SIGAL” dhe mezi priste të zbardhte, për të nisur sërish dedikimin ndaj krijesës së tij të biznesit.

Momenti kur takoi ish-Ministrin e tij, i përket një kohe kur “SIGAL” kishte marrë drejtim e rrugë, kishte lënë pas ata konkurrentë që ishin në treg dhe kishte filluar rolin e lidërshpit në tregun e sigurimeve. Dhe në euforinë e suksesit, Avni Ponari përcaktonte nëpërmjet analizës së tij si një nga kontribuesit e rëndësishëm edhe vendimin për pushimin nga puna.

Që nga çasti kur “SIGAL” siguroi rolin primar në tregun e sigurimeve, e ka ruajtur këtë rol dhe e ka forcuar nga viti në vit. Duke u rritur, duke u forcuar dhe konsoliduar, “Sigal Uniqa Group Austria” ka arritur të ketë një impakt të madh në jetën e gjithsecilit që ka ndërtuar marrëdhënie me të. Të sigurohesh do të thotë dinjitet, intergritet për gjithsecilin. Të sigurosh shtëpinë do të thotë se në rast fatkeqësish natyrore mos të rriësh me sytë e drejtuar nga institucionet publike me shpresë në mëshirës së tyre, por të zgjidhësh problemin konform kontratës që kë nënshkruar me kompaninë e sigurimeve.

Të sigurohesh për shëndetin do të thotë që nëse të “zë e keqja” të mos rriësh në shpresë të apeleve për ndihmë e solidaritet, që me shumë mundësi ka të mos vijë, por t’i drejtohesh kompanisë së sigurimit për pagesën e faturave. Dhe dalim pastaj edhe tek një ndër arsyt kryesore pse veprimtaria e “Sigal Uniqa Group Austria” është kaq e suksesshme. Është

eagerly awaiting dawn to resume dedication to his business creation.

The moment he met his former Minister belongs to a time when “SIGAL” had taken the lead, leaving behind competitors in the market and begun to assume a leadership role in the insurance market. And in the euphoria of success, Avni Ponari also decided through his analysis as one of the important contributors to the decision to be laid off. Since “SIGAL” secured the leading role in the insurance market, it has maintained and strengthened this role year after year. Growing, strengthening, and consolidating, Sigal Uniqa Group Austria has had a significant impact on the lives of everyone who has built a relationship with it. To insure means dignity, integrity for everyone. Insuring your home means not relying on public institutions for mercy in case of natural disasters, but solving the problem according to the contract signed with the insurance company.

To ensure health means that if “evil strikes”

sepse ajo nuk i shmanget detyrimit kryesor që ka një kompani sigurimi e që është pagimi i dëmeve. Vetëm në Shqipëri mbi 22 për qind e totalit të dëmeve Jo-Jetë ose afro 14 milionë euro janë paguar nga “Sigal”. Kurse Sigal Jetë ka rreth 58 për qind të totalit të dëmeve të paguara. Dhe kur ke reputacionin e një kompanie serioze dhe të përgjegjshme, atëherë edhe klientët të besojnë. Ndaj dhe aktiviteti i kompanisë, vetëm në Shqipëri, është rritur rreth 13 për qind krahasuar me vitin paraardhës.

E vërteta është se “SIGAL UNIQA GROUP Austria” ka ofruar gjithmonë mundësi të reja aty ku të tjerët nuk i shohin, ndaj është një hap para në ofrimin e produkteve novatore, të thjeshta, të shpejta dhe pa kosto shtesë. I kushtohet shumë rëndësi rritjes së efikasitetit nëpërmjet optimizimit të mëtejshëm të modelit të biznesit, duke rritur produktivitetin. Janë thjeshtëzuar dhe automatizuar pjesa më e madhe e proceseve të punës, janë shkëmbyer dhe zbatuar praktikatat më të mira të punës, është optimizuar më tej marrja në sigurim dhe vendosja e çmimeve. Modeli i biznesit është përmirësuar nëpërmjet adoptimit të mënyrave të reja të qasjes ndaj klientëve dhe pasurimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve, të cilat ofrojnë vlerë shtesë për klientët. Kompania ka rritur vizibilitetin e brandit dhe tërheqjen ndaj produkteve egzistuese dhe atyre të reja. Në misionin për të qenë më shumë sesa kompani sigurimi, SIGAL ka zgjeruar modelin e biznesit përtej fondit të sigurimeve, duke thelluar fokusin tek menaxhimi i aseteve dhe biznesit të fondeve të pensionit. Është punuar më tej edhe me promovimin dhe rritjen e vetëdijesimit mbi kujdesin dhe mbrojtjen e risikut. Po qe se do të kishim mundësi të monitoronim nga afër Avni Ponarin për një periudhë të caktuar kohe, me siguri do të konstatojmë që fjala më e përdorur e tij gjatë ditës është “SIGAL”. Dhe ka të drejtë. Sepse “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” është tashmë jo vetëm realitet i rëndësishëm në tregun financiar shqiptar, por edhe një ide e 25 viteve më parë, e transformuar në një gjigand brenda një harku kohor 25-vjeçar. SIGAL është gjurma e suksesit të Avni Ponarit, është kryevepra që e ka përmbushur dhe realizuar plotësisht atë.

not to rely on appeals for help and solidarity, which are unlikely to come, but to turn to the insurance company to pay bills. And then we come to one of the main reasons why the activity of “Sigal Uniqa Group Austria” is so successful. It is because it does not shun the main obligation of an insurance company, which is to pay damages. In Albania alone, over 22% of the total non-life damages or approximately 14 million euros have been paid by “Sigal.” Sigal Life has paid around 58% of the total damages. And when you have the reputation of a serious and responsible company, then clients trust you. Hence, the company’s activity, in Albania alone, has increased by about 13% compared to the previous year.

The truth is that “SIGAL UNIQA GROUP Austria” has always offered new opportunities where others do not see them, so it is a step ahead in offering innovative products, simple, fast, and without additional costs. Much importance is given to increasing efficiency through further optimization of the business model, thereby increasing productivity. Most work processes have been simplified and automated, best work practices have been exchanged and applied, insurance acquisition and pricing have been further optimized. The business model has been improved through adopting new approaches to customer engagement and enriching the range of products and services that provide added value to customers. The company has expanded its business model beyond the insurance fund, focusing on asset management and pension fund business. Further work has been done on promoting and increasing awareness of risk care and protection. If we had the opportunity to monitor Avni Ponari closely for a certain period of time, we would surely find that his most used word during the day is “SIGAL.” And he is right. Because “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” is now not only a significant reality in the Albanian financial market, but also an idea 25 years ago, transformed into a giant within a 25-year timeframe. SIGAL is Avni Ponari’s footprint of success, it is the masterpiece that he has fully fulfilled and realized.



MALTIN KORKUTI

Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank

Emri i kompanisë: Credins Bank
Xhiro e biznesit 2023: 128 milionë EURO
Numri i punonjësve: 1038
Zyrat qendrore: Tiranë

MALTIN KORKUTI

General Director of Credins Bank

Company Name: Credins Bank
Turnover 2023: 128 million EUR
No. of employees: 1038
Headquarter: Tirana

Credins Bank udhëhoqi një tjetër vit të suksesshëm në disa drejtime. Të gjitha nismat financiare të ndërmarra, kanë ndjekur me një koherencë të plotë trajektoren strategjike të vendosur për vitin 2023. Ishte një vit i rëndësishëm ku shumëllojshmëri ngjarjesh shoqëruan 20 vjetorin e Credins bank, duke sjellë si në aspektin financiar ashtu edhe në atë social një performancë dinjitoze. Credins vazhdoi të ruajë pozita solide në treg si banka e parë në portofolin e kredisë dhe e dytë në total asetesh dhe depozitash. Credins tregoi impenjim maksimal për t'iu përshtatur trendeve globale që sjell vazhdimisht tregu financiar e kryesisht ai bankar. Në këtë aspekt, shënuam një rritje edhe në zgjerimin e numrit të klientëve, duke bërë që Credins të ishte zgjedhja e duhur për investimet e tyre. Credins bank e zgjeroi edhe më tej veprimtarinë financiare ku një nga arritjet për tregun ekonomiko-financiar në Shqipëri ishte edhe lançimi i ofertës së parë publike të instrumentave të borxhit të llojit të obligacioneve. Jo vetëm në statusin e nënshkruesit të këtij emetimi, por edhe si

Credins Bank has had another successful year in various areas. All financial initiatives undertaken have consistently followed the strategic plan set for 2023. This year was especially significant, marked by numerous events celebrating the 20th anniversary of Credins Bank, showcasing both financial and social achievements. Credins maintained a solid market position, leading in the credit portfolio and ranking second in total assets and deposits. The bank demonstrated a strong commitment to adapting to global trends in the financial and banking sectors. In this regard, we saw growth in our customer base, making Credins the preferred choice for their investments. Additionally, Credins expanded its financial activities, achieving a milestone for the Albanian economic-financial market with the launch of the first public offering of debt instruments in the form of bonds. As both the underwriter of this issuance and the founder of Albania's first private stock exchange, Credins displayed a successful and ambitious vision for the development of the business sector and the local economy.

The banking industry has seen significant

Adresa: Rruga Vaso Pasha, Nr. 8, Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 46 700 777
E-mail: info@bankacredins.com

Address: Vaso Pasha Street, No. 8, Tirana, Albania
Phone: + 355 46 700 777
E-mail: info@bankacredins.com



themeluesi i Bursës së parë private shqiptare, Credins tregoi se ka një vizion të sukseshëm dhe ambicioz për zhvillimin e sektorit të biznesit por edhe të ekonomisë vendase.

Industria bankare ka marr një hov të madh zhvillimi dhe ku konkurrenca e tregut është e madhe. Dizenjuam produkte të reja dhe sollëm larmi ofertash të dedikuara sipas segmenteve të klientëve. Objektivi kryesor ishte ofrimi i produkteve apo shërbimeve konkurruese si në terma të produkteve me benefite në efikasitetin e ofrimit të tyre, zgjerimin e kanaleve në të cilat ofrohen, termat kohore, lehtësim procedurash, etj. Kredihënia u bazua në njohjen e potencialit të klientëve tanë besnik, si dhe të rinj në varësi të veçorive të sektoreve ku ata operojnë. Partneriteti më institucione financiare ndërkombëtare si rasti i Mastercard i dhanë zë, hartimit të ofertave të veçanta mbi promovimin e kartave me parapagesë dhe ofertave për klientët e rinj. Credins sërisht inicioi fushata mbi bazën e shpërblyerjes të klientëve kartëmbajtës si dhe incentivimin e klientëve biznes të pajisur me POS. Duke ruajtur pozicionin si një nga bankat që ofron interesa të favorshme në produktet

development, even amidst strong market competition. We designed new products and introduced a variety of offers tailored to different customer segments. Our main objective was to provide competitive products and services, focusing on benefits in efficiency, channel expansion, timing, and procedure simplification, among others. Lending was based on recognizing the potential of our loyal and new customers, depending on the specific characteristics of their sectors. Partnerships with international financial institutions, such as Mastercard, supported the creation of special offers promoting prepaid cards and new customer offers. Credins also initiated reward-based campaigns for cardholders and incentives for business clients equipped with POS systems. By maintaining a position as one of the banks offering favorable interest rates on investment products, the launch of special term deposit offers was a natural part of our strategy to serve our customers with preferential rates. Support for sectors such as tourism, agriculture, energy, and others remained a focus to strengthen and develop these crucial sectors of the local economy.

Referring to the global situation and changes

e investimit, lançimi i ofertave speciale për depozitat me afat erdhën natyrshëm si pjesë e një strategjie për t'iu shërbyer klientëve tanë me norma preferenciale. Mbështetja e sektorëve si: turizmi, bujqësia, energjia etj ishte sërish në fokusin tonë për të forcuar dhe zhvilluar këto sektorë të rëndësishëm të ekonomisë vendase.

Nëse i referohemi situatës globale, pra ndryshimet e tregjeve financiare, rritja e normës bazë të interesit në Eurozone, Amerikë, Angli edhe Shqipëria ka arritur të jetë krahë tendecave të tregut, më qëllim menaxhimin efektiv të likuiditetit dhe investimeve afatgjatë. Rritja e inflacionit edhe pas përpjekjeve për ta mbajtur atë të ulët ka ndikuar në normat e interesit të kredive dhe depozitave. Objektivi ynë kryesor ka qenë menaxhimi i likuiditetit dhe investimi në letra me vlerë vendase dhe të huaja.

Bankingu digjital, sot është kryefjala dhe Credins nuk ka kursyer çdo investim në inovacion duke përmblusur nevojat e klientëve. Gjatë 2023, numri i klientëve në platformën Credins online arriti mbi 61% të totalit të individëve aktivë. POS-et janë një tjetër kanal digjital që kanë njohur rritje me mbi 50% në numrin e trasaksioneve krahasuar me 2022, i nxitur edhe nga faktorë të tjerë si rritja e penetrimit të kartave, iniciativat e qeverisë për të promovuar pagesat pa para dhe popullariteti i tregtisë elektronike (e-commerce). Rritje shënoi gjithashtu edhe numri i transaksioneve dhe volumit në ATM më 14% krahasuar me vitin 2022.

Banka Credins ka përmirësuar portfolet duke e tejkuluar tregun për sa i përket aktivitetit huadhënës dhe grumbullimit të fondeve nga klientët përkatësisht. Gjithashtu, Credins vazhdoi të ketë një pjesë tregu të konsiderueshëm në totalin e aktiveve dhe në totalin llogarive të

in financial markets, the increase in the base interest rate in the Eurozone, America, and the UK influenced Albania to align with market trends, aiming for effective liquidity management and long-term investments. The rise in inflation, despite efforts to keep it low, affected interest rates on loans and deposits. Our main objective was managing liquidity and investing in domestic and foreign securities. Digital banking is now a key focus, and Credins has invested heavily in innovation to meet customer needs. In 2023, the number of clients on the Credins online platform reached over 61% of active individuals. POS devices saw over a 50% increase in transactions compared to 2022, driven by factors like card penetration growth, government initiatives promoting cashless payments, and the popularity of e-commerce. The number and volume of ATM transactions also increased by 14% compared to 2022.

Credins Bank improved its portfolios, outperforming the market in terms of lending activity and fund collection from clients. Credins also maintained a significant market share in total assets and client accounts, keeping pace with market growth and even improving its market share compared to the previous year: total assets at 16.5% and client accounts at 17.6%. In line with international standards, we have applied





klientëve duke mbajtur ritmin e rritjes së tregut dhe madje duke përmirësuar peshën në treg krahasuar me një vit më parë, përkatësisht: total aktive 16.5% dhe llogaritë e klientëve 17.6%

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, kemi aplikuar përmirësime në lidhje me matjen dhe monitorimin e riskut të likuiditetit dhe të normës së interesit, duke përcaktuar limite dhe instrumente të reja në menaxhimin e këtyre rreziqeve. Janë implementuar sisteme në lidhje me automatizimin e proceseve për përllogaritjen e indikatorëve sipas kërkesave rregullatore dhe të brendshme. Fokus të rëndësishëm ka pasur në mirëadministrimin e vlerësimeve të kolateralëve për mbulimin sa më lartë të ekspozimeve në risk dhe përfshirjen e një game më të gjerë të kolateralëve, përfshirë edhe instrumenta të reja financiare dhe produkteve të sigurimeve.

Arsyeya çfarë e bën të veçantë Credins bank, është dhe investimi në burime njerëzore. Angazhimi ynë për të ofruar mirëqenie financiare më paketa të shumta benefitesh, kanë njohur rritje të jashtëzakonshme çdo vit, duke ofruar edhe një kulturë moderne në socializimin e stafeve. Përgjatë vitit 2023 që përkoi dhe me 20 vjetorin e bankës, Credins zgjodhi të vinte me një strategji paketash financiare të përditësuara. Paga e 13 dhe 14, bonusi i performancës, kreditë preferenciale, skema e vjetërsisë së punës dhe ajo e besnikërisë, jetë dhe shëndet (cash plan),

improvements in measuring and monitoring liquidity risk and interest rate risk, setting new limits and instruments for managing these risks. Systems have been implemented to automate processes for calculating indicators according to regulatory and internal requirements. Significant focus has been on the proper administration of collateral evaluations to maximize risk exposure coverage, including a wider range of collaterals and new financial instruments and insurance products.

What makes Credins Bank special is its investment in human resources. Our commitment to providing financial well-being through multiple benefits packages has seen extraordinary growth each year, offering a modern culture of staff socialization. During 2023, which also marked the bank's 20th anniversary, Credins introduced updated financial package strategies. The 13th and 14th salaries, performance bonuses, preferential loans, seniority and loyalty schemes, life and health (cash plan), staff retreats, and various trainings are just some of the benefits for every employee. This strategy aims not just for a successful business but also for our empathetic and visionary ability to create a favorable work environment that harmonizes both the financial and emotional aspects of each employee.

Talking about Credins Bank comes with great responsibility due to its status and impact, even in the social aspect. A bank that counts significant





DHURO

PËR NJË BUZËQESHJE!

FUQIZIMI I SHOQËRISË DHE INOVACIONIT



E-mail: info@smile.al

staf retreat, trajnimet e ndryshme, janë vetëm disa nga përfitimet për çdo punonjës. Kjo është një strategji që nuk synon thjesht për të patur një biznes të suksesshëm por aftësia jonë empatike dhe vizionare për të krijuar një klimë pune të favorshme e cila, synon të harmonizojë si aspektin financiar ashtu edhe atë emocional të çdo punonjësi.

investments in community well-being and progress. We have invested in fields that bring progress to the country, such as technology, economy, employment, environment, tourism, education, culture, sports, and more. This mindset has made Credins not only the number one choice for every Albanian but also earned maximum respect for all the work done in the development of Albanian

Të flasësh për Credins Bank kërkon një përgjegjësi të madhe, për vetë statusin dhe impaktin që ajo ka krijuar edhe në aspektin social. Një bank që numëron investime të mëdha në funksion të mirëqenies së komunitetit dhe progresit të tij. Kemi investuar në fusha që sjellin përparim për vendin si në teknologji, ekonomi, punësim, mjedis, turizëm, arsim, kulturë, sport etj. Kjo mendësi ka bërë që Credins të jetë jo vetëm zgjedhja numër një e çdo shqiptari, por të gëzojë njëherazi respektin maksimal për të gjithë punën absolute të bërë në zhvillim të shoqërisë shqiptare. “SDG Business Pioneers” çmimi i akorduar nga United Nation of Albania në 2023, ishte shpërblimi i sakrificës që Credins bank ka dhënë në 20 vite. Ndihe mi krenar që jemi e para bankë që merr këtë çmim prestigjioz duke ndjekur 17 objektivat për zhvillim dhe qëndrueshmëri të vendosura nga OKB. Antarësimet në UN Global Compact dhe UN Woman tregojnë se Credins bank është e angazhuar të ndjek modelet më të mira në botë.

Credins Bank, ka një angazhim maksimal në zhvillimin e kanaleve digjitale dhe duke u bazuar në strategjinë e saj, do të vazhdojë të ketë në fokus ofrimin e produkteve tërësisht digjitale. Ofrimi i zgjedhjeve inovative dhe të personalizuar për klientët tanë, janë ambicia jonë më e madhe profesionale. Ne do të vazhdojmë të jemi partneri kryesor duke suportuar çdo kërkesë dhe nevojë me produkte atraktive, procedura efektive, skema konkurruese dhe shërbim të shkëlqyer, ashtu siç Credins ka ofruar në 21 vite.

society. The “SDG Business Pioneers” award given by the United Nations of Albania in 2023 was a recognition of Credins Bank’s sacrifice over 20 years. We are proud to be the first bank to receive this prestigious award, following the 17 sustainable development goals set by the UN. Memberships in the UN Global Compact and UN Women demonstrate that Credins Bank is committed to following the best global models. Credins Bank is fully committed to developing digital channels and, based on its strategy, will continue to focus on providing entirely digital products. Offering innovative and personalized solutions for our clients is our greatest professional ambition. We will continue to be the main partner supporting every request and need with attractive products, efficient procedures, competitive schemes, and excellent service, as Credins has offered for 21 years.





MARIO BRACCI

*Administrator i Përgjithshëm
i kompanisë "ANTEA CEMENT"*

Emri i kompanisë: Antea Cement
Xhiro e biznesit 2023: 96 million EURO
Numri i punonjësve: 188
Vendndodhja: Thumanë

MARIO BRACCI

*General Administrator
of the company "ANTEA CEMENT"*

Company Name: Antea Cement
Turnover 2023: 96 million EUR
No. of employees: 188
Location: Thumane

Janë të shumtë personat që telefonojnë në numrin tonë, me iluzionin se po flasin me përfaqësues të kompanisë së prodhimit të çimentos 'Antea Cement'. Kërkesa e tyre është e thjeshtë: duan sasi të caktuara çimentoje. Por kërkesat si këto, që në kushte normale do të ngazëllenin këdo, sepse janë mundësi e mirë për ta bërë ndërmjetësin në kontratë, tek ne nuk lënë asnjë emocion të tillë. Kjo pasi ne e dimë mirë se 'Antea Cement' është kompani që funksionon me kapacitet të plotë. E dimë mirë se për 'Antea Cement' kërkesat për produkt janë më të mëdha sesa ajo ka mundësi t'i plotësojë. Pra, ajo bën pjesë tek ai grupi i pak kompanive, që e dinë që në fillim të vitit se të gjithë prodhimin e kanë të shitur. Për 'Antea Cement' tregu nuk ka surpriza, nuk ka improvizime, nuk sjell ndonjë vështirësi që ajo nuk mund ta përballojë. 'Antea Cement' nga viti në vit e ka situatën nën kontroll, çka do të thotë se performancat vetëm sa i përmirësohen.

Many people call our number, under the illusion that they are speaking with representatives of the cement production company 'Antea Cement.' Their request is simple: they want specific quantities of cement. But requests like these, which under normal conditions would excite anyone because they present a good opportunity to act as an intermediary in a contract, do not evoke such emotions in us. This is because we know well that 'Antea Cement' is a company operating at full capacity. We know well that the demand for 'Antea Cement' products is greater than it can supply. Thus, it belongs to that small group of companies that knows at the beginning of the year that all its production is sold. For 'Antea Cement,' the market has no surprises, no improvisations, and presents no difficulties it cannot handle. From year to year, 'Antea Cement' has the situation under control, meaning its performance only improves.

The year 2023 is an exception to this rule,

Plant address: "Boka e Kuqe" Borizane,
Kruje, 40km north of Tirana, ALBANIA
Tel: +355 4450 2373
Mob: +355 68 8040 019/67 3055 355
E-mail: tsaka@anteacement.com

Plant address: "Boka e Kuqe" Borizane,
Kruje, 40km north of Tirana, ALBANIA
Tel: +355 4450 2373
Mob: +355 68 8040 019/67 3055 355
E-mail: tsaka@anteacement.com



Viti 2023 përbën përjashtim nga ky rregull, pasi aktiviteti i kompanisë ishte thuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës. Të ardhurat e kompanisë arritën në 12 miliardë lekë. Edhe në vitin paraardhës aktiviteti i kompanisë ishte po kaq.

Por kompania pati një përmirësim të ndjeshëm në treguesin më të rëndësishëm të saj, atë të fitimit. Gjatë vitit 2023, Antea Cement siguroi një fitim para tatimit prej 3.4 miliardë lekësh, që është rreth 1.6 miliardë lekë më shumë sesa në vitin paraprak. Rritja e këtij treguesi erdhi prej uljes së kostove financiare, por kompania bën pjesë në grupin e fatlumëve, të cilëve u ka trokitë fati tek dera. Kjo pasi, si kompani që është kredituar në euro, zhvlerësimi i monedhës europiane, përballë lekut shqiptar, ka bërë që 'Antea Cement' të sigurojë disa para më shumë edhe nga ky komponent. Jo vetëm kaq, por për mirë ka ndikuar tek kompania edhe ndryshimi i raportit mes tregut të brendshëm dhe atij të eksportit. Si rrjedhojë e projekteve të qeverisë në kuadër të rindërtimit nga tërmeti, por edhe bumit të ndërtimeve publike e private në Shqipëri, 'Antea Cement' ka destinuar më

as the company's activity was almost at the same level as the previous year. The company's revenue reached 12 billion ALL. Even in the previous year, the company's activity was at the same level.

However, the company saw a significant improvement in its most important indicator, profitability. In 2023, Antea Cement secured a pre-tax profit of 3.4 billion ALL, which is about 1.6 billion ALL more than the previous year. This increase came from lower financial costs, but the company also benefited from favorable circumstances, such as the depreciation of the Euro against the Albanian Lek, which allowed 'Antea Cement' to secure additional funds from this component. Moreover, the change in the





shumë produkt për tregun vendas dhe më pak për eksport sesa zakonisht. Kështu, produkti i eksportit përbënte 26 për qind të totalit.

Shpenzimet për përfitimet e punonjësve janë rritur, kurse pagesat në favor të institucioneve publike thuajse janë dyfishuar. Ato ishin 1.3 miliardë lekë, ndërkohë që në vitin paraprak ishin 796 milionë lekë.

Ndërkohë, kompania ka vazhduar me përgjegjësitë e veta sociale, duke iu gjendur pranë nevojave të komunitetit dhe të bashkive të ndryshme, e duke i ndihmuar me produkt sipas

ratio between the domestic market and exports positively impacted the company. As a result of government projects related to earthquake reconstruction and a boom in public and private construction in Albania, ‘Antea Cement’ allocated more product to the domestic market and less for export than usual. Consequently, export products accounted for 26 percent of the total.

Employee benefits expenses increased, while payments to public institutions nearly doubled. They were 1.3 billion ALL, compared to 796 million ALL the previous year.





mundësive të saj. Ka vazhduar gjithashtu të ruajë e të përforcojë edhe profilin si kompani shumë serioze, si kompani që respekton dhe mbron mjedisin, si kompani që kujdeset për të drejtat e punëmarrësit.

Kur ‘Antea Cement’ lindi shumë vite më parë, si rrjedhojë e një investimi kolosal, pritshmëritë ishin të larta për të. Në vitet në vijim të aktivitetit, ajo i realizoi plotësisht pritshmëritë, duke u shndërruar në njërin prej kompanive më serioze e me reputacion në Shqipëri.

Për drejtorin e përgjithshëm të saj, Mario Bracci, viti 2023 ishte një tjetër vit suksesi nën drejtimin e Antea Cement. Pronarët e kompanisë duket se kanë bërë goditjen e duhur me emërimin e zotit Bracci në krye të kompanisë, pasi që nga dita kur ai është vënë në krye, kompania ka regjistruar vetëm përmirësim performancash.

Meanwhile, the company has continued its social responsibilities, supporting the needs of the community and various municipalities by providing products within its means. It has also maintained and strengthened its profile as a very serious company, respecting and protecting the environment, and caring for workers’ rights.

When ‘Antea Cement’ was founded many years ago, as a result of a colossal investment, expectations were high. In the following years, it fully met these expectations, becoming one of the most serious and reputable companies in Albania. For its general director, Mario Bracci, 2023 was another successful year leading Antea Cement. The company’s owners seem to have made the right decision by appointing Mr. Bracci as the head of the company, as it has shown continuous performance improvements since his appointment.





“AGRO-BLEND” GROUP

Xhiro e biznesit 2023: 95 milion EURO
Ndryshimi në % 23/22: +18
Numri i punonjësve: 303
Vendndodhja: Tiranë

“AGRO-BLEND” GROUP

Turnover 2023: 95 milion EUR
Difference in % 23/22: +18
No. of employees: 303
Location: Tirana

“Agro-Blend” ka vite që është ngritur në nivelin e një grupi të mirëfilltë. Madje në mesin e atyre grupeve që kanë arritur në realitetin aktual që e gëzojnë më mënyrën më të natyrshme, si akumulim suksesesh vit pas viti, e që më pas kanë sjellë rritjen sasiore të vazhdueshme, efektivitetin sistematik, për të mbërritur në një grup që gjatë vitit 2023 iu afrua 100 milionë eurov në aktivitet. Ose për të qenë më të saktë, gjatë vitit 2023 grupi regjistroi një xhiro prej rreth 9.7 miliardë lekësh me një rritje 17-18 për qind krahasuar me vitin paraardhës. Pra, Agro-Blend nuk e ka shtuar dhe diversifikuar aktivitetin nëpërmjet blerjeve apo privatizimeve të pronave të ndryshme, por ia ka arritur ta bëjë këtë nëpërmjet investimeve të mirëfillta, të nisura fillimisht si ide biznesi, për të përfunduar në fabrika prodhimi.

“Agro-Blend” nisi veprimtarinë në vitin 1995, si një kompani e tregimit të inpueteve bujqësore dhe për shumë kohë ishte (dhe vazhdon të jetë) mbështetëse dhe faktor zhvillimi për fermerët dhe bujqësinë shqiptare. Pra lindi si një kompani, me një natyrë të tillë veprimtarie që e kthente atë në faktor real zhvillimi për një nga sektorët që ishte konsideruar dhe vazhdon të konsiderohet

“Agro-Blend” has risen to the level of a fully-fledged group over the years. It is among those groups that have achieved their current reality in the most natural way, accumulating successes year after year, which has led to continuous quantitative growth, systematic effectiveness, and becoming a group that in 2023 approached 100 million euros in activity. To be more precise, in 2023, the group registered a turnover of around 9.7 billion lek, with a growth of 17-18 percent compared to the previous year. “Agro-Blend” did not expand and diversify its activities through the acquisition or privatization of various properties, but achieved this through genuine investments, starting initially as business ideas and culminating in production factories.

“Agro-Blend” began its operations in 1995 as a company trading agricultural inputs and for a long time has been (and continues to be) a supporter and development factor for Albanian farmers and agriculture. It was born as a company with such a nature of activity that made it a real development factor for one of the sectors considered, and continues to be considered, one of the priorities of

Adresa: Vorë, Tiranë
 Tel +355 47/600180, +355 48/302 720
 Fax +355 47/600370, +355 48/30 2721
 Email: @agroblend.com

Address: Vora, Tirana
 Tel +355 47/600180, +355 48/302 720
 Fax +355 47/600370, +355 48/30 2721
 Email: @agroblend.com



si një nga prioritetet e ekonomisë kombëtare. Çdo vit, aktiviteti i “Agro-Blend” ishte në rritje të vazhdueshme, por në vitet e mëpasme, drejtuesit e saj gjykuan si kohë të përshtatshme për të hyrë edhe në industrinë e përpunimit të miellit. Si rezultat, ndëruan një fabrikë moderne me teknologjinë e fjalës së fundit, që arriti të bëhet shpejt faktor i rëndësishëm në industrinë shqiptare të prodhimit të miellit, duke ofruar në treg rreth 20 produkte. Por edhe me synime të qarta për të qenë një lider në rajon, pasi të gjitha mundësitë i ka. Investimi i fjalës së fundit të teknologjisë, lënda e parë e një cilësie të lartë, linja e prodhimit e parametrave europianë, laborator bashkëkohor si dhe stafi i specializuar janë garancitë e arritjes së këtij qëllimi.

rëndësishëm në operacionet e kompanisë. Flota e mjeteve të rënda të kompanisë siguron transportin e materialeve të ndërtimit që tregtojmë dhe gjithashtu ofron shërbime transporti për palë të treta.

Numri i marrëveshjeve të nënshkruara për transportin tokësor të palëve të treta ka shënuar një rritje të dukshme në vitin 2023, krahasuar me vitin e kaluar, duke reflektuar rritjen e kërkesës për këto shërbime.

MATERIALET E NDERTIMIT DHE BETON, INERTE

Në vitin 2023, sektori i materialeve të ndërtimit i Rafaelo 2002 ka shënuar një performancë të shkëlqyer dhe ka kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të kompanisë. Ky sektor mbulon tregtinë e një game të gjerë produktesh ndërtimi, përfshirë tullat, betonin dhe inertet. Gjatë vitit, departamenti ka regjistruar një numër të lartë shitjesh, duke përfshi 303.000 copë tulla dhe 130.000 kg hekur zgare. Cimentoja ka arritur në 457.000 kv, ndërsa zhavor lumi, granili dhe cakelli janë shitur në një vlerë totale prej 49.900 m³. Beton i cilësisë së parë, një produkt kyç për sektorin e ndërtimit, ka arritur në 26.000 m³ në vlerë prodhimi dhe shitjeje. Në përmbledhje, të ardhurat e realizuara nga këto aktivitete për vitin 2023 kapin shumën e 3.510.346.716 lekëve. Ky rezultat i jashtëzakonshëm është një dëshmi e forcës dhe ndikimit të Rafaelo 2002 në tregun e materialeve të ndërtimit dhe pasqyron angazhimin e kompanisë për cilësi dhe përkushtim në ofrimin e produkteve të shkëlqyera për ndërtim.

RAFAELO FARM

Në vitin 2024, Rafaelo Group ka zgjeruar portofolin me hapjen e sektorit të ri, Rafaelo Farm, një investim strategjik ky me një vlerë prej 66.183.486 lekësh. Ky sektor ka kontribuar në rritjen e numrit të punonjësve, me 273 të punësuar në kompaninë Rafaelo më 2002 dhe 338 në kompaninë Rafaelo Resort gjatë vitit 2023. Rafaelo Farm, i vendosur në Gjorm, është i fokusuar në prodhimin e produkteve të freskëta, përfshirë perime dhe fruta të cilësisë së lartë, të kultivuara me standarde të avancuara. Ky investim thekson angazhimin e



CONSTRUCTION MATERIALS, CONCRETE, AND AGGREGATES

In 2023, Rafaelo 2002's construction materials sector recorded outstanding performance and made a significant contribution to the company's economic growth. This sector covers the trade of a wide range of construction products, including bricks, concrete, and aggregates. During the year, the department recorded high sales volumes, including:

- 303,000 bricks
- 130,000 kg of rebar
- 457,000 kv of cement
- 49,900 m³ of river gravel, granite, and chippings
- 26,000 m³ of first-class concrete

Revenues generated from these activities for 2023 amounted to 3,510,346,716 ALL. This remarkable result underscores Rafaelo 2002's strength and impact in the construction materials market and reflects the company's commitment to quality and dedication to providing excellent construction products.

RAFAELO FARM

In 2024, Rafaelo Group expanded its portfolio with the opening of a new sector, Rafaelo Farm, a strategic investment valued at 66,183,486 ALL.



Rafaelo Group për të ofruar produkte të freskëta dhe të shëndetshme për tregun, duke mbështetur një sistem të qëndrueshëm dhe të integruar të prodhimit bujqësor.

RAFAELO LAKE HOTEL 5*

Rafaelo Group ka realizuar një investim të rëndësishëm në sektorin e turizmit me ndërtimin e hotelit të ri Rafaelo Lake Hotel 5*, një projekt me një vlerë investimi prej 77.264.021 lekësh. Ky hotel, i vendosur në Shëngjin, është hapur me një event të madh më 27 korrik dhe ka arritur të realizojë një xhiro prej 20.425.300 lekësh që nga ajo ditë. Me një kapacitet prej 180 dhomash dhe mundësinë për të akomoduar deri në 450 klientë, Rafaelo Lake Hotel 5* është projektuar për të ofruar një përvojë të shkëlqyer për vizitorët, duke kombinuar komfortin e lartë me pamjet e mrekullueshme të bregdetit dhe ambientit përreth. Ky investim është një hap i rëndësishëm në zgjerimin e ofertës së grupit dhe në forcimin e pozitave të tij në sektorin e turizmit.

RAFAELO 2019 RESIDENCE – MALI I ZI

Rafaelo 2019 në vitin 2023 ka investuar në Mal të Zi në 5 objekte:

- PODGORICË
- BUDVA
- TUZI
- BAR
- PODGORICË II

1. Në objektin PODGORICË , RRUGA 4 JULA është ndërtesë e realizuar me teknologjinë më të fundit arkitekturore. Deri më tani, në këtë objekt janë investuar përfundimisht 6,392,950.53 EUR.

2. Projekti në Tuz konsiston në krijimin e një kompanie për bazën e konstruksionit dhe betonit, krahas me hapësirë administrative, akomodim për stafin, depo e magazina që u përkasin materialeve të ndërtimit. Deri tani janë investuar 749,122.26 EUR.

3. Në BUDVA po realizohet një projekt madhështor hotelier. I pozicionuar në vijën e parë bregdetare, hoteli po ndërtohet sipas standardeve më të larta, duke u kategorizuar me 5 yje.

This sector has contributed to an increase in the number of employees, with 273 employees in Rafaelo 2002 and 338 employees in Rafaelo Resort during 2023. Located in Gjorm, Rafaelo Farm focuses on producing fresh products, including high-quality vegetables and fruits, cultivated to advanced standards. This investment underscores Rafaelo Group's commitment to providing fresh and healthy products to the market, supporting a sustainable and integrated agricultural production system.

RAFAELO LAKE HOTEL 5*

Rafaelo Group has made a significant investment in the tourism sector with the construction of the new Rafaelo Lake Hotel 5*, a project valued at 77,264,021 ALL. This hotel, located in Shëngjin, was inaugurated with a grand event on July 27, 2023, and has since achieved a turnover of 20,425,300 ALL. With a capacity of 180 rooms and the ability to accommodate up to 450 guests, Rafaelo Lake Hotel 5* is designed to offer an exceptional experience for visitors, combining high comfort with stunning views of the coastline and surrounding environment. This investment is a crucial step in expanding the group's offerings and strengthening its position in the tourism sector.

RAFAELO 2019 RESIDENCE - MONTENEGRO

In 2023, Rafaelo 2019 invested in Montenegro in five properties:

1. PODGORICA: A building on 4 JULY Street, constructed with the latest architectural technology. So far, approximately 6,392,950.53 EUR has been invested in this property.

2. TUZI: This project involves creating a company for construction and concrete bases, along with administrative space, staff accommodation, and storage warehouses for construction materials. To date, 749,122.26 EUR has been invested.

3. BUDVA: A magnificent hotel project is underway, located on the first coastal line. The hotel is being built to the highest standards and is categorized as 5 stars.



LUCA BUSI

President i “Coca-Cola Bottling Shqipëria”

Xhiro e biznesit 2023: 53.5 milionë euro
Ndryshimi në % 23/22: +13.9
Numri i punonjësve: 393
Vendndodhja: Tiranë

LUCA BUSI

President of Coca-Cola Bottling Albania

Turnover 2023: 53.5 million EUR
Difference in % 23/22: +13.9
No. of employees: 393
Location: Tirana

Kompania e mirënjohur, “Coca-Cola Bottling Shqipëria” vazhdon të rritet. Ashtu siç ka bërë edhe më parë, kur gjithmonë viti pasardhës ka qenë më i mirë sesa ai paraardhës, edhe përgjatë vitit 2023, CCBS realizoi një performancat më të mira të historisë së vet. Sigurisht, e kushëtuar kjo nga disa faktorë, të cilët i shpjegon më mirë presidenti i saj, Luca Busi.

“Çdo vit është një sfidë e re, me ambicien për t’u arritur: me synimin për rritje të vazhdueshme. CCBS ka forcuar planin e zhvillimit vit pas viti, me vizionin për të ndërtuar një rrugë të qëndrueshme ekonomike, duke pasur ndikim pozitiv në ekonomi”, nënvizon Luca Busi, presidenti i Coca-Cola Bottling Shqipëria, të vetmes kompani të autorizuar për të prodhuar, ambalazhuar, shitur dhe shpërndarë të gjitha produktet e The Coca Cola Company në Shqipëri. “Viti 2023 ishte strategjik për ne – vazhdon ai – me përmirësime të ndjeshme në asetet operative dhe financiare. Shumë faktorë kanë ndikuar në rezultate të jashtëzakonshme: në lidhje me optimizimin e prodhimit dhe risitë teknike, për shembull, ne kemi investuar në linjat tona dhe teknologjitë e reja për të rritur efikasitetin dhe për të garantuar cilësi gjithnjë e më të lartë të produktit.

Coca-Cola Bottling Albania continues to grow. Just as it has done in the past, where each year has been better than the previous one, in 2023, CCBS achieved one of the best performances in its history. This is certainly due to several factors, which its president, Luca Busi, explains better.

“Every year is a new challenge, with the ambition to be achieved: with the aim of continuous growth. CCBS has strengthened its development plan year after year, with the vision of building a sustainable economic path, having a positive impact on the economy;” emphasizes Luca Busi, president of Coca-Cola Bottling Albania, the only company authorized to produce, package, sell, and distribute all The Coca-Cola Company products in Albania. “2023 was strategic for us – he continues – with significant improvements in operational and financial assets. Many factors have contributed to exceptional results: regarding production optimization and technical innovations, for example, we have invested in our lines and new technologies to increase efficiency and guarantee ever higher product quality. These efforts have helped reduce costs and further optimize our production capacity. We have also

Adresa: Coca-Cola Bottling Shqipëria (CCBS), Tiranë-Durrës Km.5, Kashar, Tiranë
 Tel: +355 48 20 04 31/32/33/34, +355 42 379 776/789/779
 Fax: +355 4 48 20 04 30
 Email: @cocacola.al Web: www.ccbs.al

Address: Coca-Cola Bottling Shqipëria (CCBS), Tiranë-Durrës Km.5, Kashar, Tiranë
 Tel: +355 48 20 04 31/32/33/34, +355 42 379 776/789/779
 Fax: +355 4 48 20 04 30
 Email: @cocacola.al Web: www.ccbs.al



Këto përpjekje kanë ndihmuar në uljen e kostove dhe optimizimin e mëtejshëm të kapacitetit tonë të prodhimit. Ne kemi zgjeruar gjithashtu portofolin tonë të produkteve, duke prezantuar shije të reja dhe formate të reja paketime, të cilat janë pritur pozitivisht nga konsumatorët. Këto ndryshime kanë ndihmuar në rritjen e pjesës sonë të tregut dhe përmirësimin e pozicionit tonë konkurrues. Numrat flasin vetë: në vitin 2023 kemi shënuar një rritje të qarkullimit neto të shitjeve prej 13.9% (53.5 milionë euro), me një marzh Ebit prej 16.8% dhe një rritje në burimet njerëzore (+6, 8%), e cila u rrit nga 368 në 393 punonjës. Një trend pozitiv që tregon zhvillim të vazhdueshëm, të qëndrueshëm dhe cilësor dhe që na pozicionon si një model industrial, duke demonstruar se si një kompani familjare e shkëlqyer mund t'i përgjigjet nevojave të një territori shumë të larmishëm”.

Por kompania nuk ka ardhur duke përmirësuar vetëm performancën. Në realitetin shqiptar ajo renditet ndër më të mirat edhe sa i takon përgjegjësisë sociale të manifestuar.

“Përgjegjësia sociale e korporatës – vijon Presidenti Busi – ka qenë gjithmonë një nga prioritetet tona, por në vitin 2023 ishte vërtet thelbësore, duke udhëhequr të gjitha veprimet tona zhvillimore. Lajmi më i madh ishte prezantimi i parë Raportit të Qëndrueshmërisë¹ për një qasje të certifikuar dhe pragmatike ndaj përgjegjësisë sociale: një hap i rëndësishëm në rrugën e transparencës

¹ Të dhënat e raportit gjenden në <https://ccbs.al/en/perjegjiesia-sociale/ccbs-prezanton-raportin-e-pare-te-qendrueshmerise-per-nje-qasje-te-certifikuar-dhe-pragmatike-ndaj-perjegjiesise-sociale/>

expanded our product portfolio, introducing new flavors and new packaging formats, which have been positively received by consumers. These changes have helped increase our market share and improve our competitive position. The numbers speak for themselves: in 2023 we recorded a 13.9% increase in net sales turnover (53.5 million euros), with an Ebit margin of 16.8% and a growth in human resources (+6.8%), which increased from 368 to 393 employees. A positive trend that indicates continuous, sustainable, and quality development and that positions us as an industrial model, demonstrating how an excellent family company can meet the needs of a very diverse territory.”

But the company has not only improved its performance. In the Albanian reality, it is ranked among the best also in terms of the social responsibility it manifests. “Corporate social responsibility – continues President Busi – has always been one of our priorities, but in 2023 it was truly fundamental, guiding all our development actions. The biggest news was the presentation of the first Sustainability Report for a certified and pragmatic approach to social responsibility: a significant step in the path of transparency and continuous improvement implemented for several years. This official document – prepared by Deloitte, supported by detailed reports and verified by specialized consultants – in fact, demonstrates the company’s commitment to a sustainable future, with a path based on investments and good practices. A very important starting point to achieve the great goal, as well as it has already been communicated, we aim to become the first company in Albania to be Carbon

dhe përmirësimit të vazhdueshëm të zbatuar prej disa vitesh. Ky dokument zyrtar - i hartuar nga Deloitte, i mbështetur nga raporte të detajuara dhe i verifikuar nga konsulentë të specializuar - në fakt dëshmon përkushtimin e kompanisë për një të ardhme të qëndrueshme, me një rrugë të bazuar në investime dhe praktika të mira. Një pikënisje shumë e rëndësishme për të arritur qëllimin e madh, si dhe është komunikuar tashmë sy sinqerisht të bëhemi kompania e parë në Shqipëri Carbon Neutral deri në vitin 2030. Për të arritur këtë qëllim ambicioz, kemi zhvilluar një proces të detajuar dhe një Roadmap të qartë e transparent, me të gjitha investimet dhe operacionet që do të duhet t'i vëmë në zbatim në vitet e ardhshme. Kemi identifikuar tashmë reduktime të mundshme të emetimeve, si në operacionet e brendshme ashtu edhe me palët e treta.

Gjithashtu, intensifikuam projektet edukative - kulturore në vitin 2023 që synojnë promovimin e riciklimit dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme, duke arritur të rrisim vetëdijësimin, të stimulojmë dhe të marrim pjesë aktive në një ndryshim pozitiv sistematik që përfshin të gjithë komunitetin. E gjithë kjo për të demonstruar se CCBS është më shumë se një aktivitet sipërmarrës: është një realitet që po nxit ndryshimin në Shqipëri

Neutral by 2030. To achieve this ambitious goal, we have developed a detailed process and a clear and transparent Roadmap, with all the investments and operations that we will have to implement in the coming years. We have already identified possible reductions in emissions, both in internal operations and with third parties. Also, we intensified educational and cultural projects in 2023 aimed at promoting recycling and the use of sustainable resources, managing to raise awareness, stimulate, and actively participate in a positive systematic change that involves the entire community. All of this to demonstrate that CCBS is more than a business activity: it is a reality that is driving change in Albania with great energy. Since its inception, Coca-Cola Bottling Albania has promoted actions in favor of the environment through pioneering projects, hoping to have contributed to setting new standards within the market: our green initiatives – continues Busi – such as investments in photovoltaics, the use of 100% electric vehicles, the installation of fast charging stations in the cities involved, planting trees, are just the main examples of a daily commitment from all levels of the organization.”

Emigration has become a worrying problem for Albanian businesses, not only due to the difficulties



me shumë energji. Që nga fillimi i saj, Coca-Cola Bottling Shqipëria ka promovuar veprime në favor të mjedisit përmes projekteve pioniere, me shpresën se do të ketë kontribuar në vendosjen e standardeve të reja brenda tregut: iniciativat tona të gjelbra - vazhdon Busi - si investimet në fotovoltaike, përdorimi e automjeteve 100% elektrike, instalimi i stacioneve të karikimit të shpejtë në qytetet e përfshira, mbjellja e pemëve, janë vetëm shembujt kryesorë të një angazhimi të përditshëm nga të gjitha nivelet e organizimit”.

Emigrimi është kthyer në problem shqetësues për bizneset shqiptare, jo vetëm për vështirësitë që ka shkaktuar ky proces në sigurimin e fuqisë punëtore, por edhe sa i takon uljes së numrit të konsumatorëve. Por kompanitë prodhuese të produkteve të konsumit masiv e kanë gjetur lajmin e mirë tek turizmi, një sektori ky që po zhvillohet shumë dhe që po sjell flukse të mëdha konsumatorësh.

“Në kontekstin aktual, i cili vazhdon të shënojë rritje të numrit të turistëve – vijon presidenti i CCBS Luca Busi – ne shohim mundësi të mëdha dhe kufij për zhvillimin e mëtejshëm të realitetit tonë. Sa më shumë të rritet Shqipëria, aq më shumë rritemi ne: një proces i vërtetshëm që duhet mbështetur reciprokisht. Rritja e flukseve ka sjellë një rritje të vëllimeve të dukshme nga konsumi i produkteve tona dhe ne po planifikojmë të zgjerojmë më tej praninë tonë në tregun vendas, duke përfutur nga ky trend pozitiv me “Planet Turistike” shumë të fuqishme. Në vitin 2023 kemi aktivizuar një plan sfidues që synon shfrytëzimin e prezencave turistike veçanërisht gjatë verës, me investime të mëdha Outdoor të lidhura me aktivizimin e pikave të shitjes sezonale, me një forcë të dedikuar shitjeje dhe me materiale të veçanta dhe të dukshme, nëpërmjet aktiviteteve specifike mbështetëse të hoteleve dhe për mbështetjen e eventeve muzikore dhe ndërkombëtare. Coca-Cola ka qenë gjithmonë një pije e dashur për shqiptarët dhe shumë e kërkuar në të gjitha pikat e shitjes: forca jonë përfaqësohet nga një model i suksesshëm unik në botë, një markë që investon vazhdimisht në teknologji dhe komunikim. Nëpërmjet inovacionit të vazhdueshëm, ne do të angazhohemi gjithnjë e më shumë për të kënaqur kërkesat e një tregu gjithnjë në rritje.”



caused by this process in securing labor, but also in terms of the decrease in the number of consumers. But manufacturing companies of mass consumer products have found good news in tourism, a sector that is developing rapidly and bringing large flows of consumers.

“In the current context, which continues to record an increase in the number of tourists – continues CCBS president Luca Busi – we see great opportunities and boundaries for the further development of our reality. The more Albania grows, the more we grow: a virtuous process that must be mutually supported. The increase in flows has led to a significant increase in volumes from the consumption of our products and we are planning to further expand our presence in the domestic market, taking advantage of this positive trend with very powerful “Tourist Plans”. In 2023 we have activated a challenging plan aimed at exploiting tourist presences, especially during the summer, with large Outdoor investments linked to the activation of seasonal sales points, with a dedicated sales force and with special and visible materials, through specific support activities for hotels and for the support of musical and international events. Coca-Cola has always been a beloved drink for Albanians and very much in demand at all points of sale: our strength is represented by a unique successful model in the world, a brand that constantly invests in technology and communication. Through continuous innovation, we will be increasingly committed to meeting the demands of an ever-growing market.”

Note: This translation aims to be as accurate and comprehensive as possible, maintaining the original meaning and tone. However, there may be slight nuances in meaning or style due to the complexities of translation between languages. If you have any specific questions or require further clarification, please feel free to ask.



largest
64

successful
179



ASTRIT ISA, LUAN LARTI

Administratorë të kompanisë Larti sh.p.k

Emri i kompanisë: Larti sh.p.k
Xhiro e biznesit 2023: 52 milionë euro
Numri i punonjësve: 200
Vendndodhja: Korçë

ASTRIT ISA AND LUAN LARTI

Administrators of Larti LLC

Company name: Larti LLC
Turnover 2023: 52 million EUR
No. of employees: 200
Location: Korça

Edhe pse me njëfarë rënie krahasuar me një vit më parë, sërish, 52 milionë euro aktivitet, realizuar nga kompania Larti, gjatë vitit 2023, mjaftuan që dy pronarët e saj, Astrit Isa dhe Luan Larti të renditen ndër biznesmenët më të mëdhenj të Shqipërisë. Është ky një status i fituar kohë më parë dhe i demonstruar e përfurcuar vit pas viti, por sigurisht jo nga arsye rastësore apo fati. Por si rrjedhojë e vendimeve të shumta, në sensin e duhur dhe të marra në kohën e duhur, të cilat bënë të mundur ngjitjen e kompanisë Larti sh.p.k në nivelet që është sot. Themelet e këtij biznesi të suksesshëm u hodhën që në vitin 1992, kohë kur Luan Larti, shkoi si shumë të tjerë emigrant në Greqi, por si pak të tjerë u kthye brenda një kohe të shkurtër, pasi, bashkë me Astrit Isa shihnin mundësi më të mëdha në Shqipëri. Ishte pra ky momenti më i rëndësishëm, kur ata ndanë mëndjen për ndërtimin e perspektivës së tyre. Ishte ky vendimi më i rëndësishëm që i dha jetës së tyre këtë drejtim që ka edhe sot. Që i dha këtë aureole që kanë sot. Që i dha këtë profil që kanë sot.

Vendimi tjetër i rëndësishëm i Luan Lartit

Despite a slight decline compared to the previous year, the 52 million euros in activity achieved by Larti LLC in 2023 was still sufficient for its two owners, Luan Larti and Astrit Isa, to be ranked among the largest businessmen in Albania. This status was earned some time ago and demonstrated and reinforced year after year, but certainly not by chance or luck. It was the result of numerous well-timed decisions, which made it possible for Larti LLC to rise to the levels it is at today. The foundations of this successful business were laid back in 1992, when Luan Larti, like many others, emigrated to Greece, but unlike most, he returned within a short time, seeing greater opportunities in Albania. This was indeed the most significant moment when he decided to build his own future. This decision was crucial in steering his life in the direction it has taken today. It gave him the aura he possesses now. It gave him the profile he has today.

Another significant decision made by Luan Larti and Astrit Isa was the pursuit of personal and family progress solely in the field of business.

Adresa: Rruga kombëtare Bulgarec, Korçë
 E-mail: info@larti.al
 Tel: +355694064200

Address: Rruga kombëtare Bulgarec, Korçë
 E-mail: info@larti.al
 Tel: +355694064200

dhe Astrit Isa ishte kërkimi i progresit personal e familjar vetëm në fushën e biznesit. Nëse shumë shqiptarë në ato vite ishin të paqartë e konfuzë rreth të ardhmes së tyre, nëse shumë shqiptarë ranë në panik nga ndryshimi i sistemit, Luan Larti dhe Astrit Isa e kuptuan se kishte ardhur koha e një sistemi të ri ku përgjegjës për mirëqënien e individit ishte vetë individi. Ndaj dhe e drejtuan shikimin dhe energjinë e tyre vetëm në drejtim të ushtrimit të iniciativës së lirë. Pas një prove me tregtimin e fruta perimeve, kuptuan se ky lloj aktiviteti kishte limite dhe ishte i pafuqishëm për të përmbushur ambiciet e tyre të mëdha. Ndaj, ndryshuan natyrën e aktivitetit të biznesit, duke u marrë me tregtimin e materialeve të ndërtimit dhe në vitin 1999 themeluar përfundimisht kompaninë Larti sh.p.k. Dhe vazhduan në këtë linjë. Duke përmbushur kështu atë shprehjen e Andreë Carnegie se “njerëzit që kanë pasur sukses janë ata që kanë zgjedhur një linjë dhe i përmbahen asaj”.

Përkushtimi i madh në punë, shoqëruar ky me tregtimin e materialeve tepër cilësore, fryt i bashkëpunimit me partnerë të mirënjohur bënë që tregu i Korçës në vecanti, por edhe ai i Juglindjes së vendit të ishte i vogël për kompaninë Larti. Ndërkohë që kompania kishte ndërtuar një mekanizëm perfekt konkurues edhe për tregje të



While many Albanians at that time were unclear and confused about their future, and many fell into panic over the system change, Luan Larti and Astrit Isa understood that the time for a new system had arrived, where the responsibility for individual well-being lay with the individual themselves. Thus, they directed their focus and energy solely towards exercising free initiative. After experimenting with trading fruits and vegetables, they realized that this type of activity had limits and was inadequate to fulfill their big ambitions. Therefore, they changed the nature





tjera në përtej Juglindjes. Ndaj, sot ajo paraqitet me dy pika kryesorë magazinimi dhe shpërndarje të produkteve që tregton. Njëra në Korçë e tjetra në Elbasan. Duke patur për moto kryesore furnizimin e tregut me produktet më cilësore e standartet bashkëkohore, Larti sh.p.k ia ka dalë mbanë që të jetë tashmë një kompani që nuk ka kufij në treg.

Por rritja e kompanisë nuk është projektuar e siguruar vetëm nga zgjerimi i tregut të shitjes së produkteve të tyre kryesisht hekur dhe material të tjera ndërtimi. Rritja është stimuluar edhe nga diversifikimi i aktivitetit të kompanisë ose më saktë shtimi i aktivitetit të saj, duke u futur edhe në procesin e ndërtimit të komplekseve të banimit apo edhe transportit të mallrave për llogari të të tretëve. Ndonëse është e vështirë të përcaktohet se sa për qind zë ndërtimi në aktivitetin e kësaj kompanie të mirënjohur, ajo që mund të thuhet me bindje është fakti se Larti sh.p.k ka aktualisht aktivitetin më të madh në ndërtim në qytetin e Korçës. Ka ndërtuar komplekset kryesore dhe më të bukura të banimit në qytetin juglindor. Në harmoni të plotë me fizionominë e këtij qyteti. Zgjerimi i natyrës së aktivitetit të kompanisë edhe me ndërtimin është një zhvillim sa i natyrshëm i kompanisë, aq edhe veprim i mençur i drejtuesve, pasi Korça nuk e ka përjetuar barbarinë e ndërtimeve pa rregull e pa standarte, sikundër ka ndodhur në qytetet dhe zonat e tjera të Shqipërisë.

of their business activity, focusing on trading construction materials, and in 1999, they officially founded Larti LLC. They continued along this line, fulfilling Andrew Carnegie's saying that "successful people are those who have chosen a path and stuck to it."

Their great dedication to work, combined with trading high-quality materials and collaborating with well-known partners, meant that the market in Korçë, in particular, but also the southeastern region of the country, was too small for Larti LLC. Meanwhile, the company had built a perfect competitive mechanism for other markets beyond the Southeast. Today, it has two main storage and distribution points for its products: one in Korçë and the other in Elbasan. With its main motto being the supply of the market with the highest quality products and contemporary standards, Larti LLC has managed to become a company with no boundaries in the market.

However, the company's growth has not been secured solely by expanding its sales market for their products, primarily steel and other construction materials. Growth has also





Ky “dizavantazh” i saj, si dhe fillimi i vonshëm e ndërtimeve të reja, ka krijuar mundësinë që gjërat të bëhen sic duhet dhe kompani të tilla me reputacion si Larti sh.p.k janë garancia më e mirë për këtë. Jo më kot, në zyrat e kësaj kompanie kërkesat apo propozimet për zhvillime pronash të ndryshme janë të shumta dhe që japin garanci për një perspektivë të qëndrueshme afatgjatë të kompanisë. Aktiviteti i ndërtimit është një nga segmentët e veprimtarisë që i krijon Larti-t dinamikën e duhur, pasi tregtimi i materialeve të ndërtimit ka krijuar prej vitesh stabilitetin e saj. Tashmë kompania është në fazën e fundit të përfundimit të një kompleksi prej 60 mijë metra katror dhe para saj shpaloset një tjetër projekt shumë i rëndësishëm për qytetin e Korçës. Ai i ndërtimit të një kompleksi të ri me sipërfaqe dyfish më të madhe nga ky që është në “metrat e fundit”. Me këtë projekt të ri, i cili garanton të paktën 10 vite punë në sektorin e ndërtimit për kompaninë, si dhe një tjetër në fushën e energjisë së rinovueshme mund të thuhet me siguri që perspektiva e kompanisë “Larti” sh.p.k është e garantuar. Kurse dy aksionerët e saj, Astrit Isa dhe Luan Larti, kurorëzojnë një partneritet afatgjatë e të pazakontë për mjedisin shqiptar, por të karakterizuar nga përkushtimi e mirëkuptimi reciprok.

been stimulated by diversifying the company’s activities or more precisely, expanding its activities by entering the construction of residential complexes and even transporting goods for third parties. Although it is difficult to determine what percentage construction activity constitutes within this well-known company, it can be confidently said that Larti LLC currently has the largest construction activity in the city of Korçë. It has built the main and most beautiful residential complexes in the southeastern city, in full harmony with the city’s appearance.

The expansion of the company’s activities to include construction is both a natural development of the company and a wise move by the management, as Korçë has not experienced the barbarity of unregulated and non-standard construction, unlike other cities and regions in Albania. This “disadvantage,” along with the late start of new constructions, has created the opportunity to do things correctly, and reputable companies like Larti LLC are the best guarantee for this. Not surprisingly, the company’s offices are frequently approached with requests or proposals for various real estate developments, providing assurance of a stable long-term future for the company. The construction activity is one of the segments that gives Larti LLC the necessary dynamism, as trading construction materials has provided stability for years.

The company is now in the final phase of completing a 60,000 square meter complex, and ahead of it is another very important project for the city of Korçë: the construction of a new complex with twice the area of the current one in its “final meters.” With this new project, which guarantees at least 10 years of work in the construction sector for the company, as well as another project in the field of renewable energy, it can be said with certainty that the future of Larti LLC is secure. Meanwhile, its two shareholders, Astrit Isa and Luan Larti, crown a long-term and unusual partnership in the Albanian environment, characterized by commitment and mutual understanding.



KOMPANIA ELKA SA

Xhiro e biznesit 2023: 49.5 milion EURO
Ndryshimi në % 23/22: +5.9
Numri i punonjësve: 442
Vendndodhja: Vrisera, Gjirokastër

COMPANY ELKA SA

Turnover 2023: 49.5 million EUR
Difference in % 23/22: +5.9
No. of employees: 442
Location: Vrisera, Gjirokastra

Sa herë që mbaron viti kalendarik dhe financiar dhe biznesi bën bilancet e punës dhe të performancës, është e sigurtë që kompania Elka SA do të dalë në gjirin e kompanive më të suksesshme të tij. Ajo që është intriguese për këtë kompani lidhet me dinamikën e aktivitetit të saj. Pra sa është rritur ky aktivitet, ku është rritur më shumë, sa rentabilitet ka pasur kompania, si i ka përballuar tendencat dhe problematikat e kohës, etj. etj. Dhe që në fillim duhet të themi se ELKA SA, edhe pse na ka mësuar çdo vit me performancat e saj shumë të mira, edhe pse na ka ambientuar me përmirësimet e vazhdueshme të aktivitetit në shumë plane, në investime, rritje volumesh, përfitueshmëri, zgjerim impakti social etj., e mbylli vitin 2023 me një performancë të mrekullueshme.

Le t'i referohemi disa treguesve kryesorë që lejojnë me nxjerrë një konkluzion të saktë për ecurinë e kompanisë. Xhiro e saj gjatë vitit 2023 ishte 5.8 miliardë lekë, nga 5.1 miliardë lekë sa ishte gjatë vitit paraprak. Rritja pra është rreth 6 për qind. I gjithë ky volum aktiviteti u realizua në tregun e brendshëm dhe atë të eksportit. Shitjet brenda vendit ishin në kuotën e 4.8 miliardë

At the end of each calendar and financial year, as businesses tally their work and performance, Elka SA consistently ranks among the most successful companies. The intriguing aspect of this company lies in the dynamics of its activity. This includes how much the activity has grown, where it has grown the most, its profitability, and how it has addressed contemporary trends and challenges. From the outset, it must be said that ELKA SA, despite consistently delivering excellent performances and continuous improvements in various areas - such as investments, volume growth, profitability, and social impact - closed 2023 with remarkable performance.

Let's examine some key indicators that allow us to accurately assess the company's progress. Its turnover in 2023 was 5.8 billion ALL, up from 5.1 billion ALL the previous year. This represents an increase of about 6 percent. All this activity was realized in both the domestic and export markets. Domestic sales were 4.8 billion ALL, with an increase of 6.5 percent, while export sales were 954 million ALL, nearly the same as the previous year.

Adresa: Vrisera, Gjirokaster, Albania
 Tel. + 355 8426 7301
 Fax. + 355 884 90099
 e-mail: @elka-sa.com
 web-site: www.elka-sa.com

Adresa: Vrisera, Gjirokaster, Albania
 Tel. + 355 8426 7301
 Fax. + 355 884 90099
 e-mail: @elka-sa.com
 web-site: www.elka-sa.com



lekëve, me një rritje prej 6.5 për qind. Kurse shitjet nga eksporti ishin 954 milionë lekë, në një nivel thuajse të njëjtë me vitin paraprak.

Por ajo që nuk e bën të tepërt përcaktorin “i mrekullueshëm” për aktivitetin e ELKA SA gjatë vitit që u mbyll, lidhet me efektivitetin e kompanisë. Në analizë të fundit ky është edhe qëllimi pse ekziston dhe zhvillohet çdo biznes. Me rreth 896 milionë lekë fitim para tatimit të siguruar, ELKA duket se ka pasur një vit tejet produktiv dhe shumë më të mirë sesa viti paraprak.

Edhe në drejtime të tjera kompania ka njohur progres. Numri i punonjësve ka arritur në 442 vetë, ndërkohë që vetëm një vit më parë ishte 419. Nga këta, 60 për qind janë femra dhe 40 për qind meshkuj. Sigurisht se 23 të punësuar më shumë nuk përbëjnë ndonjë rritje e konsiderueshme, por kjo e ka vlerën e një treguesi domethënës në drejtim të progresit të mëtejshëm të kompanisë. Edhe fondi i pagave të kompanisë u rrit me 10 për qind, duke e kthyer ELKA SA-në ndër kompanitë me pagat më të mira në vend, me pagën mesatare

What justifies calling ELKA SA's performance “remarkable” is its effectiveness. Ultimately, this is the purpose of every business. With a pre-tax profit of around 896 million ALL, ELKA had a highly productive year, much better than the previous one.

The company also made progress in other areas. The number of employees reached 442, compared to 419 a year ago. Of these, 60 percent are women and 40 percent are men. Certainly, 23 additional employees do not represent a significant increase, but it is a meaningful indicator of the company's ongoing progress. The company's wage fund also increased by 10 percent, making ELKA SA one of the best-paying companies in the country, with an average annual salary exceeding 1.5 million ALL. It appears the company, with its consistent approach over the years, has no workforce issues, well illustrated by the fact that employees have an average employment duration of 7 years.

The company's contribution as a taxpayer





vjetore mbi 1,5 milionë lekë. Duket pra se kompania, me sjelljen e duhur ndër vite, nuk ka problem me fuqinë punëtore dhe këtë e ilustron mirë edhe fakti se punonjësit kanë një kohëzgjatje mesatare punësimi 7 vjet.

Jashtë analizës së performancës së kompanisë nuk mund të lihet edhe kontributi i saj si tatimpaguese dhe taksapaguese. Nuk janë pak, por plot 1.2 miliardë lekë, ose rreth 12 milionë Euro që institucionet e ndryshme të shtetit shqiptar kanë përfituar nga kompania ELKA SA, çka e rendit atë ndër taksapaguesit më të mëdhenj të biznesit shqiptar.

Përveçse ka qenë dhe mbetet kompani e suksesshme, pra përveç të kaluarës dhe të tashmës së lavdishme, ELKA SA duket se ka të tillë edhe perspektivën. Nuk ka si të jetë ndryshe, përderisa kjo kompani bën pjesë në rrethin e pak bizneseve shqiptare që nuk kanë asnjë detyrim kundrejt institucioneve bankare, ndërkohë që të gjitha sfidat e zgjerimit të aktivitetit që lidhen me nevojën e kryerjes së investimeve i ka përballuar nëpërmjet burimeve të veta. Ashtu sikundër po ndodhte konkretisht edhe me investimet që pritet të mbyllen gjatë këtij viti dhe që do ta rrisin kapacitetin prodhues të fabrikës.

Përmes 25 vitesh investimi në infrastrukturë të lartë, teknologji inovative dhe njerëz të motivuar, ELKA SA është bërë njëri nga distributorët drejtues në treg të disa prej produkteve konsumatore më të suksesshme në Shqipëri. Si rezultat, ELKA SA tashmë u siguron shërbime inovative distribucioni dhe plotësisht të integruara më shumë se 50 markave rajonale dhe botërore, të mundësuar nga logjistika në kohë reale, 250 punonjësit e shitjes, 110 furgonat, 12

is also significant. It paid a total of 1.2 billion ALL, or around 12 million Euros, to various Albanian state institutions, ranking it among the top taxpayers in Albanian business.

Besides being and remaining a successful company with a glorious past and present, ELKA SA seems to have a promising future as well. This is likely, given that this company is among the few Albanian businesses with no obligations to banking institutions, handling all the challenges of expanding its activities through its resources. This is evident with the investments expected to be completed this year, which will increase the factory's production capacity.

Through 25 years of investment in high infrastructure, innovative technology, and motivated people, ELKA SA has become one of the leading distributors of some of the most successful consumer products in Albania. As a result, ELKA SA now provides innovative and fully integrated distribution services to more





kamionat, një rrjet prej më se 10,000 dyqaneve, si dhe zgjidhjet të tregtimit dhe të marketimit. Për pothuaj dy dekada, markat e produkteve shtëpiake ELKA frymëzojnë besueshmëri, inovacion dhe cilësi tek konsumatorët.

Pavarësisht se në fillimet e saj është konceptuar dhe ka vepruar si kompani distribuimi dhe tregtimi të brandeve të mirënjohura ndërkombëtare në tregun shqiptar, ELKA është nga ato kompanitë që, me kalimin e kohës, e ka gërshetuar tregtimin me prodhimin, duke krijuar brandet e veta si Belino, Replay, Baretti, My Little Garden, Daily, etj. dhe duke eksploruar gjithnjë e më shumë tregjet e eksportit.

Synimi i kompanisë është që të zgjerohet më tej me produktet snack në tregjet e Kroacisë, Malit të Zi, Bosnjës dhe të Çekisë.

than 50 regional and global brands, enabled by real-time logistics, 250 sales employees, 110 vans, 12 trucks, a network of over 10,000 stores, and trading and marketing solutions. For nearly two decades, ELKA's household product brands have inspired reliability, innovation, and quality among consumers.

Initially conceived and operated as a distribution and trading company of well-known international brands in the Albanian market, ELKA has, over time, combined trading with production, creating its brands such as Belino, Replay, Baretti, My Little Garden, Daily, etc., and increasingly exploring export markets.

The company's goal is to further expand its snack products into the markets of Croatia, Montenegro, Bosnia, and the Czech Republic.





'TEUTA' KOMPANIA LIDER NE SEKTORIN USHQIMOR PREJ 30 VITESH

'Teuta' filloi 30 vite më parë si një sipërmarrje e guximshme dhe njëkohësisht modeste, u rrit pak nga pak duke përfshirë në portofolin e saj të gjithë gamën e produkteve të shportës dhe shumë më tepër. Tashmë prej 3 dekadash 'Teuta' mbetet pararojë e nevojave të konsumatorit Shqiptar duke sjellë në treg risi me produktet e saj.

Në këto 30 vite në biznes, fokusi i 'Teuta' mbetet gjithnjë krijimi i marrdhënieve të shëndetshme me furnitorët, klientët e kompanisë si dhe konsumatorin e besuar.

'Teuta' ka investuar në makineritë më bashkëkohore në fushën e industrisë ushqimore dhe automatizimin e proceseve në prodhim, duke ofruar kështu produkte të sigurta për konsumatorin. Cilësia e lëndës së parë është gjithmonë prioritet për të patur gjithnjë produktin me vlerat më të larta ushqyese dhe të shkëlqyer në shije. Me një mbulim të plotë të territorit Shqiptar, 'Teuta' sjell produktet e saj pranë konsumatorit në çdo pjesë të vendit tonë. Natyralisht investimet, përmirësimet dhe menaxhimi i tregut janë procese

KOMPANIA TEUTA DURRËS

Emri i kompanisë: Teuta Durrës
Xhiro e biznesit 2023: 40 milionë EURO
Numri i punonjësve: 200
Vendndodhja: Durrës dhe Tirane

"TEUTA DURRËS" COMPANY

Company name: Teuta Durres
Gross revenues in 2023: 40 million EUR
No. of employees: 200
Location: Durrës and Tirana

TEUTA THE LEADER COMPANY IN THE FOOD SECTOR FOR 30 YEARS

'Teuta' started 30 years ago as a bold and at the same time modest venture, it grew little by little including in its portfolio the entire range of pantry products and much more. For 3 decades now, 'Teuta' remains the vanguard of the Albanian consumer's needs, bringing new products to the market.

In these 30 years in business, 'Teuta's' focus remains maintaining healthy relationships with the suppliers, customers as well as 'Teuta's' trusted consumer.

'Teuta' has invested in the most modern machines in the field of food industry and the automation of production processes, thus offering safe products to the consumer. The quality of the raw material is a priority to always have the product with the highest nutritional values and excellent taste. With a complete coverage of the Albanian territory, 'Teuta' brings its products to the consumer in every part of the country. Naturally, investments, improvements and market management are continuous processes, and for 'Teuta's', staff they are part



të vazhdueshme, dhe për stafin e 'Teuta' janë pjesë e punës së tyre të përditshme. Kompania 'Teuta' u ngrit mbi ëndrra të mëdha, me shumë punë e një premtim: të bëhet pjesë e jetës së përditshme të shqiptarëve. Ky premtim u arrit shumë shpejt dhe tashmë i gjejmë në çdo tryezë. Prej vitesh, 'Teuta' është konsoliduar si një biznes i suksesshëm dhe i garantuar i prodhimit, paketimit dhe shpërndarjes së produkteve të cilësisë së lartë, që mbartin vlera të sigurta ushqimore.

Sot në treg gjejmë lehtësisht me dhjetra artikuj ushqimorë që mbajnë logon e firmës 'Teuta' dhe që përbëjnë bazën e tryezës shqiptare.

MARKAT E 'TEUTA' NË ÇDO TRYEZË DHE PËR ÇDO KËRKESË

Sot kompania 'Teuta' numëron 5 brande të krijuara për të plotësuar të gjitha nevojat konsumatore. Marka e parë e kompanisë, krijuar me emrin **GOLD**, vjen me 3 linja ushqimore të cilat është e sigurtë të gjenden në çdo tryezë shqiptare. Linja e parë e krijuar është ajo e Orizit **GOLD** me një shumëllojshmëri zgjedhjesh, ndër të cilat 4 varietete Premium si Carnaroli, Arborio, Basmati dhe ai Parboiled. Një tjetër linjë është ajo e **Fasules GOLD** e cila ka prezantuar në tregun

of their daily work.

The 'Teuta' Company was founded on big dreams, with hard work and a promise: to become part of the Albanians daily life.

This promise was achieved very quickly and we now can find them on every table. For years, 'Teuta' has been consolidated as a successful and guaranteed business of production, packaging and distribution of high quality products, which carry safe food values.

Today, you can easily find dozens of food items in the market that bear the logo of the 'Teuta' company and that form the basis of the Albanian consumer meals.

'TEUTA' BRANDS AT EVERY TABLE AND FOR EVERY REQUIREMENT

Today the company 'Teuta' counts 5 brands created to meet all consumer needs.

The company's first brand, created under the name **GOLD**, comes with 3 food lines which are sure to be found on every Albanian table. The first line created is that of **GOLD Rice** with a variety of choices, among which 4 Premium varieties such as Carnaroli, Arborio, Basmati and Parboiled. Another line is that of **GOLD Beans**,



shqiptar një miks të pasur nga ku të perzgjedhim, si dhe ka sjellë me pranë konsumatorit në të gjithë vendin produktin 100% shqiptar të fasules pllaqi.

Linja e tretë është **Vaji GOLD** i lulediellit i cili është perfekt për gatime të ndryshme.

Gama e gjerë e **SuperFoods** sjell një larmi produktesh të pasura me lëndë ushqyese që konsiderohen të jenë veçanërisht të dobishme për shëndetin dhe mirëqenien.

Ready Mix është linja me katër varietete miks të përgatitura me drithëra, fara dhe bishtaja, me plot proteina, hekur dhe fibra për tu konsumuar nga e gjithë familja. Të përshtatshme për tu gatuar në formën e supave, sallatave të ftohta verore apo risotto.

Easy Bake është miell special për të realizuar kek ose muffins me shijet vanilje apo çokolatë.

Një preparat i gatshëm miks ku ka brenda saj: miellin për kek, fryrësin, qumështin dhe shije vanilje/çokolatë. I thjeshtë, praktik dhe shumë i shijshëm.

Bio Energy e prodhuar në mënyrë artizanale ashtu siç do të përgatish vetë në kushte shtëpie recetat granola dhe muesli. Me mjaltë dhe pa ngjyruar artificialë.

Nën markën 'Teuta' mund të gjeni edhe kategori të tjera si: sardele, drithëra, produkte bishtajore, pluhura për gatim etj.

which has introduced to the Albanian market a rich mix to choose from, as well as bringing the 100% Albanian product of plallaki beans to the consumer all over the country.

The third line is the **GOLD Sunflower Oil** which is perfect for various cooking.

The wide range of **SuperFoods** bring various nutrient-dense foods that are considered to be particularly beneficial for health and well-being.

Ready Mix is a line with four varieties of mixes prepared with cereals, seeds and legumes, full of protein, iron and fiber to be consumed by the whole family. Suitable for cooking in the form of soups, cold summer salads or risotto.

Easy Bake is special flour for making cakes or muffins with vanilla or chocolate flavors. A ready-mix preparation containing: cake flour, baking powder, milk and vanilla/chocolate flavor. Simple, practical and very tasty.

Bio Energy artisanally produced as you would prepare your own granola and muesli recipes at home. With honey and no artificial colors.

Under the 'Teuta' brand you can also find other categories such as: sardines, cereals, legumes, cooking powders, etc.



FILIALET TEUTA

- **Zyra Qëndrore Durrës**
Zyra Qëndrore Durrës, hapur në vitin 1994 me adresë: Lagja 18. Rruga "Aleksander Goga" KP 2001. Durrës, Shqipëri
- **Filiali Fier**
Filiali Fier hapur në vitin 2014 me adresë: Rruga Nuredin Aliu, Unaza Fier
- **Filiali Tiranë**
Filiali Tiranë hapur në vitin 2016 me adresë: Rruga Petronini Luarasi, Kashar, Fushë Mëzezë, Tiranë, Shqipëri
- **Filiali Korçë**
Filiali Korçë hapur në vitin 2019 me adresë: Zona industriale, Rruga Eordeji, Korçë
- **Filiali Shkodër**
Filiali Shkodër hapur në vitin 2020 me adresë: Rruga 1 Qershori, Shkodër
- **Filiali Sarandë**
Filiali Sarandë hapur në vitin 2021 me adresë: Rruga Nacionale Delvinë-Sarandë, Ura e Bisticës, Sarandë

TEUTA BRANCHES

- **Durrës Headquarters**
Durrës Headquarters, since 1994 with address: Lagja 18. Rruga "Aleksander Goga" KP 2001. Durrës, Shqipëri
- **Fier Branch**
Fier branch opened in 2014 with address: Rruga Nuredin Aliu, Unaza Fier
- **Tirana Branch**
Tirana branch opened in 2016 with address: Rruga Petronini Luarasi, Kashar, Fushë Mëzezë, Tiranë, Shqipëri
- **Korça Branch**
Korça branch opened in 2019 with the address: Zona industriale, Rruga Eordeji, Korçë
- **Shkodra Branch**
Shkodra branch opened in 2020 with address: Rruga 1 Qershori, Shkodër
- **Saranda Branch**
Saranda branch opened in 2021 with address: Rruga Nacionale Delvinë-Sarandë, Ura e Bisticës, Sarandë



Kompania ‘Teuta’ përbëhet nga 6 lokacione në Republikën e Shqipërisë. Selia qendrore ndodhet në Durrës, ndërsa degët e tjera janë në: Tiranë, Korçë, Fier, Shkodër dhe Sarandë.

Kjo shpërndarje strategjike në të gjithë territorin, e ka fuqizuar më tej pozitën në treg të kompanisë ‘Teuta’.

PLOTËSIM I NEVOJAVE TË KONSUMATORIT

Nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit me publikun, ‘Teuta’ përqëndrohet në promovimin e një mënyre jetese të shëndetshme përmes ushqimeve të certifikuar bio, pa gluten, organike dhe pa laktozë. Ajo ofron një burim të pasur informacionesh për ata që kërkojnë të adoptojnë një stil jetese më të shëndetshëm dhe të balancuar, duke u fokusuar në produkte me përbërës natyralë dhe të sigurt.

Në llogaritë e tyre zyrtare paraqiten personazhe të ndryshme, si nutricionistë, kuzhinierë të specializuar dhe ekspertë të fushës, të cilët japin këshilla praktike për një ushqyerje të mirë.

‘Teuta’ Company consists of 6 locations in the Republic of Albania. The headquarters are located in Durrës, while the branches are located in: Tirana, Korça, Fier, Shkoda and Saranda.

This strategic distribution throughout the territory has further strengthened the market position of the ‘Teuta’ Company.

FULFILLMENT OF CUSTOMER NEEDS

Rritja e aktivitetit është gjë shumë pozitive për kompaninë, që bëhet edhe më pozitive kur konstaton se është “ushqyer” kryesisht nga eksporti. Deri para pak vitesh, të gjitha energjitë, të gjitha forcat e kompanisë ishin përqendruar për të përbushur kërkesat nga tregu vendas. Derisa erdhi një moment që Proletar Hasani kuptoi se bazamenti i kompanisë do të ishte edhe më i fortë po qe se produktet e “Albsteel”-it do të ishin të pranishme edhe në tregjet e huaja. Ndaj edhe i dha vëmendjen e duhur edhe këtij komponenti. Fillimisht me kuota modeste, por kjo prani në tregje të huaja filloi të rritej nga viti në vit për të arritë në vitin 2023 në rreth 500 milionë lekë. Pra, nëse deri para pak vitesh kompania “Albsteel” kishte zero eksporte, tashmë ajo realizon rreth 14 për qind të volumit të përgjithshëm nëpërmjet eksportit.

Duke parë dinamikën e këtij treguesi është mëse e sigurtë që prania e kompanisë në eksporte do të vijë duke u bërë gjithnjë e më e madhe. Aq më shumë që Proletar Hasani nuk gjen kurrë rehat

region for producing cold-formed, hot-formed, and galvanized steel sheet tubular profiles.

It is truly satisfying to note that this renowned company’s performance improved in 2023. The company’s turnover was over 3.7 billion ALL, compared to around 3.5 billion ALL the previous year, indicating a growth rate of 6-7 percent.

The growth in activity is very positive for the company and becomes even more positive when you see that it is primarily driven by exports. Until a few years ago, all the company’s efforts were focused on meeting domestic market demands. However, Proletar Hasani realized that the company’s foundation would be even stronger if “Albsteel” products were also present in foreign markets. Thus, he gave the necessary attention to this component. Initially with modest quotas, but this presence in foreign markets began to grow year by year, reaching around 500 million ALL in 2023. So, if until a few years ago the company “Albsteel” had zero exports, now it realizes about 14 percent of its total volume through exports.

Given this trend, it is very likely that the company’s presence in exports will continue to grow. This is further ensured by Proletar Hasani, who never rests or allows routine to set in, always considering things unfinished and focusing on market expansion. “Albsteel” resembles a mosaic, where there is always something to add. This is how Proletar acts year after year. Just when



e qetësi. Nuk bie dhe nuk lejon të bjerë në rutinën e aktivitetit, duke i quajtur gjërat të mbaruara dhe duke u kujdesur vetëm për zgjerim tregjesh. “Albsteel” i ngjan një mozaiku, ku gjithmonë ka diçka për të shtuar. Kështu vepron Proletari nga viti në vit. Kur ti mendon se tashmë gjithçka ka shkuar në vendin e vet, atë e gjen duke bërë investime të reja. Rreth 55 milionë lekë të reja ishte vlera e investimeve të tilla gjatë vitit 2023,

you think everything is in place, you find him making new investments. About 55 million ALL were invested in 2023, showing his philosophy of maintaining and strengthening his leadership position in this industry through systematic investments that provide solutions for the opportunities and challenges of the time.

The production and sales complex is built on a total area of 60,000 m², of which 25,000





çka tregon se filozofia e tij për të ruajtur e për të forcuar pozitat që ka si lider në këtë industri, është ajo e investimeve sistematike, nëpërmjet të cilave ofron zgjidhjet përkatëse për oportunitetet apo sfidat që paraqet koha.

Kompleksi i prodhimit dhe shitjeve është ndërtuar në një sipërfaqe totale 60.000 m², nga të cilat 25.000 m² janë sipërfaqe e mbyllur, e mirorganizuar dhe e pajisur me të gjithë infrastrukturën bashkëkohore. Rreth 1200 metra katrorë janë vetëm zyrat e kompanisë, të përfunduara së fundmi, së bashku edhe me zgjerimin e kapacitetit të saj. Profilët tubolare prodhohen në fabrikën e Papmetal dhe ofrohen ekskluzivisht vetëm nga Qendra e Shërbimit të Metaleve Albsteel. Formatet e ndryshme të lllamarinave të prodhuara në të ngrohtë dhe të ftohtë, të galvanizuara dhe inox janë produkt i makinerive të prodhimit italian, të pajisura me teknologjitë më të fundit në fushën e sheshimit dhe prerjes në gjatësi e gjerësi. Me qëllim të rritjes së standarteve të trajtimit të konstruksioneve metalike, ofrohet shërbimi i pastrimit me rërë çeliku dhe lyerje me primer. Makineritë dhe teknologjia e përdorur janë tërësisht gjermane. Standardet e administrimit, prodhimit dhe kontrollit të cilësisë janë në përputhje të plotë dhe të çertifikuara sipas Standardeve të Bashkimit European. Produktet janë çertifikuar dhe prodhohen në përputhje me normat e CE. Kompanitë janë çertifikuar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas standardeve ISO 9001 : 2008, ISO 9001 : 2015, Certificate Konformiteti CE sipas standardit EN 10219-1 : 2006 dhe për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor sipas standardit ISO 14001:2004.

m² are enclosed, well-organized spaces equipped with modern infrastructure. Approximately 1200 square meters are offices, recently completed along with the expansion of the company's capacity. Tubular profiles are produced in the Papmetal factory and offered exclusively by Albsteel's Metal Service Center.

Various formats of hot-formed, cold-formed, galvanized, and stainless steel sheet metal are produced with Italian manufacturing machinery equipped with the latest technology in flattening and cutting to length and width. To enhance the standards of metal structure treatment, sandblasting and primer coating services are offered, using entirely German machinery and technology.

Management, production, and quality control standards are fully compliant and certified according to European Union Standards. Products are certified and produced in accordance with CE norms. The companies are certified for Quality Management Systems according to ISO 9001: 2008, ISO 9001: 2015, CE Conformity Certificate according to EN 10219-1: 2006, and Environmental Management System according to ISO 14001: 2004.





HAJRI ELEZI

President i kompanisë “Lajthiza Invest”

Xhiro e biznesit 2023: 35 milion EURO
Ndryshimi në % 23/22: +25
Numri i punonjësve: 305
Vendndodhja: Lajthizë, Pukë

HAJRI ELEZI

President of the company “Lajthiza Invest”

Turnover 2023: 35 million EUR
Difference in % 23/22: +25
No. of employees: 305
Location: Lajthiza, Puka

Uji “Lajthiza” ka qenë alternativa e parë e konsumatorëve gjatë vitit 2023. Sigurisht që ky nuk është as opinion e as perceptim, por thjesht realitet i konfirmuar nga shifrat. Gjatë vitit 2023 kompania performoi në mënyrë të shkëlqyeshme, duke realizuar një volum aktiviteti prej afro 3.6 miliardë lekësh. Kjo është një rritje të ndjeshme krahasuar me një vit më parë, kur kompania regjistroi një aktivitet në kuotën e 2.8 miliardë lekëve. Arsyeja pse konsumatorët e kanë zgjedhje të parë ujin “Lajthiza” është e lehtë për t’u kuptuar. “Lajthiza” është uji më cilësor në treg dhe këtë e vërtojnë analizat e kryera në institucionet më prestigjioze ndërkombëtare.

Cilësia e produktit e bën krenar Hajri Elezin, e bën atë të ndjehet përherë kryelartë dhe i nderuar përpara konsumatorit. Njëherë në një panair ndërkombëtar ku merrnin pjesë kompani që tregtonin brande të njohura ndërkombëtarisht, presidenti i një kompanie të tillë e pyeti Hajri Elezin për arsyen e të qenit në panair. “Kam ardhur të marr pjesë me ujin më të mirë në botë”, iu përgjigj ai, duke nënkuptuar “Lajthiza”-n. Dhe kjo përgjigje nuk ishte ndonjë shfaqje megalomanie, por tregon

In 2023, “Lajthiza” water was the first choice for consumers. This is not just an opinion or perception but a reality confirmed by the numbers. In 2023, the company performed excellently, achieving a business volume of approximately 3.6 billion leks. This is a significant increase compared to the previous year, when the company recorded a business volume of 2.8 billion leks. The reason why consumers choose “Lajthiza” as their first choice is easy to understand. “Lajthiza” is the highest quality water on the market, as confirmed by analyses conducted in the most prestigious international institutions.

The quality of the product makes Hajri Elezi proud, making him always feel honored in front of the consumer. Once, at an international fair attended by companies selling well-known international brands, the president of such a company asked Hajri Elezi why he was at the fair. “I came to participate with the best water in the world,” he replied, referring to “Lajthiza.” This response was not an act of megalomania but rather a legitimate belief in the quality product he has.

Regarding the improvement of “Lajthiza



bindjen e ligjshme të tij për produktin cilësor që ka në duar.

Sa i takon përmirësimit të performancës ekonomike të kompanisë “Lajthiza Invest” ajo duket në disa drejtime. Së pari, sikurse thamë më lart, tek volumi i aktivitetit të kompanisë. Edhe pse në treg ka një mori ujërash, edhe pse tregut i shtohen përditë kompani që tregtojnë ujëra mineralë, jo vetëm nga vendi por edhe nga importi, kjo dukuri nuk ka mundur ta prekë kompaninë “Lajthiza Invest”. Më saktë, mund t’ia ketë reduktuar disi ritmin e rritjes, por pa e penguar të ketë rritjen e saj, ndoshta edhe përtej pritshmërive të drejtuesve. Sepse me pasë rritje përtej 25 për qind nga viti paraardhës, është thjesht fantastike. Rritja e numrave sasiorë që tregojnë xhiron e kompanisë është rrjedhojë e shtimit të konsumatorëve të saj, krahasuar me vitin paraardhës. Dhe në këtë kontekst një nga faktorët që mund të ketë ndikuar në këtë drejtim është edhe rritja e numrit të turistëve të huaj që kanë vërshuar drejt Shqipërisë. Por jo vetëm kaq.

Të bindur në cilësinë superiore të ujit “Lajthiza”, drejtuesit e kompanisë e kanë drejtuar vëmendjen edhe nga eksporti, duke kërkuar tregje të reja, klientë të rinj. Në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Londër, Bruksel, Dubai. Dhe numrat janë inkurajues. Rreth 20 për qind e totalit të shitjeve të ujit “Lajthiza” u përket tregjeve të këtyre vendeve. Dhe synimi në një të ardhme të afërt është që kjo kuotë të shkojë në 30 për qind të totalit.

Invest” company’s economic performance, it is evident in several aspects. Firstly, as mentioned above, in the company’s business volume. Despite the plethora of waters in the market and the addition of companies selling mineral waters, both locally and from imports, this phenomenon has not affected “Lajthiza Invest.” It may have slightly slowed the growth rate, but it has not prevented the company from growing, perhaps even beyond the expectations of its leaders. Achieving growth of over 25 percent from the previous year is simply fantastic. The increase in the company’s turnover is a result of the addition of new consumers compared to the previous year. One factor that may have contributed to this is the increase in the number of foreign tourists flocking to Albania. But that’s not all.

Confident in the superior quality of “Lajthiza” water, the company’s leaders have also focused on exports, seeking new markets and new clients in Kosovo, North Macedonia, London, Brussels, and Dubai. The numbers are encouraging. Around 20 percent of “Lajthiza” water sales are from these markets, with the aim to reach 30 percent in the near future.

Another strong argument for the company’s excellent performance is the profit achieved. This indicator has improved by 700 percent compared to the previous year, mainly due to controlling company expenses. On one hand, revenues have



Sensory Analysis Results, Brussels 2024

Lajthiza® Mineral Water

Lajthiza Invest sh.a



International Taste Institute

105A rue Colonel Bourg 1140 Brussels, Belgium | www.taste-institute.com

Nga ana tjetër, një argument i fortë i performancës së mrekullueshme të kompanisë është edhe fitimi i siguruar. Ky tregues është përmirësuar me 700 për qind krahasuar me një vit më parë dhe kjo është bërë e mundshme kryesisht në sajë të kontrollit të shpenzimeve të kompanisë. Nga njëra anë, të ardhurat e saj janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, nga ana tjetër shpenzimet janë

increased significantly, while on the other hand, expenses have grown at a much more moderate pace. The only expense category where the company has followed the trend imposed by the times is salaries, bonuses, and social security, which have seen respective increases.

Ordering “Lajthiza” water in a market or a local store is easy. However, the process and journey this

Blind tasting, for truly objective evaluations



Prepared, presented, and served with care



rritur me një ritëm shumë më të moderuar. I vetmi grup shpenzimi, në të cilin kompania ka ndjekë trendin që imponon koha, ka qenë ajo e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore që kanë pasur rritjen përkatëse.

Me porosinë e ujit “Lajthiza” në një market lokal është gjë e lehtë. Por procesi dhe rruga që bën ky produkt për të mbërritur tek konsumatori është edhe e gjatë, edhe e vështirë. E ndërtuar në fshatin Lajthizë të Pukës, buzë rrugës nacionale, fabrika moderne është një nga investimet më të rëndësishme të zonës, në të cilën janë punësuar shumë njerëz prej asaj zone. Qarku i Kukësit ka shumë biznesmenë të njohur e të mëdhenj në rang vendi, por asnjë nuk është në nivelin e Hajri Elezit, për çka ka bërë ai për zonën ku ka vite që ushtron aktivitetin.

Fabrika “Lajthiza” shfrytëzon burimin e ujit që vjen nga mali i Roshit, nëpërmjet disa proceseve që e bëjnë atë të gatshëm për t’ua çuar konsumatorëve anekënd Shqipërisë. Tashmë si rrjedhojë e investimeve të realizuara për shtimin e kapacitetit të saj, ajo është një nga fabrikat më të mëdha në vend. Por Hajri Elezi prej kohësh ka dëshiruar dhe njëkohësisht ka investuar për t’ia zgjeruar spektrin kompanisë. Jo vetëm duke prodhuar ujë në madhësi dhe ambalazhe të ndryshme, por duke futë në fabrikë edhe linja prodhimi të pijeve freskuese, çka do t’i lejojë kompanisë të pretendojë për një perspektivë akoma më të mirë. Nëse e tashmja është e mirë, është e sigurtë që e ardhmja e kompanisë do jetë edhe më e mirë.

product undergoes to reach the consumer is both long and difficult. Built in the village of Lajthiza in Puka, near the national road, the modern factory is one of the area’s most significant investments, employing many people from the region. Kukës County has many well-known and prominent businessmen nationwide, but none are on the level of Hajri Elezi for what he has done for the area where he has been active for years.

The “Lajthiza” factory utilizes the water source from Mount Roshi through several processes that make it ready to be delivered to consumers across Albania. As a result of investments made to increase its capacity, it is now one of the largest factories in the country. Hajri Elezi has long desired and simultaneously invested in expanding the company’s spectrum. Not only by producing water in various sizes and packaging but also by introducing production lines for soft drinks, allowing the company to aim for an even better future. If the present is good, the company’s future will be even better.





88

129



HELIDON RRUGA

Administrator i Përgjithshëm i kompanisë "Coral Fish"

Emri i kompanisë: "Coral Fish"
Xhiro e biznesit 2023: 30 milionë EURO
Numri i punonjësve: 339
Vendndodhja: Durrës

HELIDON RRUGA

General Administrator of "Coral Fish" Company

Company Name: "Coral Fish"
Turnover 2023: 30 million EUR
No. of employees: 339
Location: Durrës

Kompania e kultivimit dhe tregtimit të peshkut "Coral Fish" na ka mësuar çdo vit me performanca të shkëlqyeshme, që rezultojnë të përmirësuara kur krahasohen me ato të vitit paraardhës. Në këtë mënyrë, viti pasardhës, duke tejkaluar paraardhësin, është gjithmonë më i miri në jetën e kompanisë. Por kjo nuk mund të thuhet për çka është arritur gjatë vitit 2023. Sepse, në dallim nga vitet e tjera, kur tejkalmi i realitetit të vitit paraardhës ishte një dukuri e qartë, gjatë vitit 2023 "Coral" pësoi një tkurrje të lehtë të aktivitetit. Pra, nga rreth 3.4 miliardë lekë sa e kishte aktivitetin gjatë vitit 2022, në vitin pasardhës kompania siguroi një volum aktiviteti në kufirin e 3.1 miliardë lekëve. Edhe eksporti pësoi pak rënie, teksa, nga 1.9 miliardë lekë në vitin 2022, rezultoi në 1.77 miliardë lekë një vit më pas. Natyrisht që janë disa faktorë që kanë kushtëzuar veprimtarinë e "Coral"-it gjatë vitit të kaluar dhe që ia kanë ulur pak shpejtësinë e lëvizjes.

E para, sikundër mund të merret lehtë me mend nga të gjithë, është kursi i këmbimit të euros. "Coral Fish" është një kompani që më

“Coral Fish,” a company engaged in fish farming and trading, has consistently impressed us with excellent performances each year, showing improvements compared to the previous year. Thus, each successive year surpasses its predecessor, marking continual progress in the company’s life. However, this was not the case for the year 2023. Unlike previous years where surpassing the previous year’s reality was a clear trend, “Coral” experienced a slight decline in activity during 2023. Specifically, whereas the company had an activity level of around 3.4 billion lekë in 2022, the following year saw a reduced activity volume at around 3.1 billion lekë. Similarly, exports also experienced a slight decline from 1.9 billion lekë in 2022 to 1.77 billion lekë in the subsequent year. Several factors influenced “Coral’s” operations during the past year, contributing to a slowdown in its momentum.

Firstly, as widely acknowledged, the euro exchange rate played a significant role.

Adresa: Autostrada Durrës-Tiranë, km 2
 Tel: 052236800
 Fax: 052236801
 E-mail: alb@koralfish.com
 www.koralfish.com

Address: Autostrada Durrës-Tiranë, km 2
 Tel: 052236800
 Fax: 052236801
 E-mail: alb@koralfish.com
 www.koralfish.com



se gjysmën e aktivitetit e realizon në eksport, konform kontratave të fiksuar me partnerët. Pra, ka pak hapësirë për të bërë reflektime të situatave të paparashikuara. Prandaj zhvlerësimi i euros përgjatë vitit të kaluar ishte fatkeqësi për të gjithë eksportuesit shqiptarë në përgjithësi, ku nuk bën përjashtim as “Coral Fish”. Kontradikta mes realitetit të fiksuar në kontrata dhe asaj që është servitur në terren, ka ndikuar qoftë në uljen e lehtë të aktivitetit të kompanisë, qoftë në uljen e lehtë të përfitueshmërisë së saj.

Nga ana tjetër, kompanisë i është dashur të reflektojë edhe në drejtim të politikës së pagave. Zhvillimet e përgjithshme në ekonominë dhe biznesin shqiptar në lidhje me problematikën e marrëdhënieve të punës, me vështirësitë për sigurimin e fuqisë punëtore, me ritmet e larta të emigrimit etj., kanë imponuar, si refleks prej biznesit shqiptar, rritjen e pagave. Në kushtet kur kompania e ka të pamundshme ta shkarkojë këtë shpëzim ekstra në kontratat me blerësit, për arsye se, siç thamë më parë, ato janë të fiksuar në fillim të vitit, atëherë kjo manovër ka reduktuar disi efektivitetin e kompanisë.

Nuk janë pa ndikim as interesat e kredive të marra nga kompania për investimet e ndryshme, në mënyrë që të përmirësohet më tej procesi teknologjik, infrastruktura dhe logjistika e saj. E me gjithë këto vështirësi e sfida që i është dashur të përballojë përgjatë vitit 2023, sërish “Coral Fish” mbetet kompania më e mirë e sektorit të saj, që edhe pse me një dinamikë rënësë të lehtë, sërish,

“Coral Fish” conducts more than half of its operations through exports under fixed contracts with partners, leaving little room to navigate unforeseen circumstances. Therefore, the depreciation of the euro throughout the year was detrimental not only to “Coral Fish” but also to Albanian exporters in general. The contradiction between fixed contract realities and on-the-ground conditions affected the company’s activity and profitability.

Additionally, the company had to address wage policy issues. General economic and business developments in Albania concerning labor relations, difficulties in securing workforce, high emigration rates, etc., necessitated wage increases. However, incorporating these extra expenses into fixed contracts with buyers proved challenging, thereby somewhat reducing the company’s efficiency.

Furthermore, the company’s interests in loans taken for various investments also had an impact, aimed at further improving its technological processes, infrastructure, and logistics.

Despite these challenges faced throughout 2023, “Coral Fish” remains the top company in its sector, albeit with a slight downward trend, it has still managed to achieve a satisfactory performance in absolute terms. Moreover, it has increased its workforce compared to the previous year, which is a positive indicator.

Today, with 12 vessels and 29 fish farming



në terma absolutë, ka siguruar një performancë më se të kënaqshme. Dhe për më shumë, ka rritur edhe numrin e punonjësve, krahasuar me një vit më parë, gjë që është tregues mjaft pozitiv.

Kështu, me 12 anije e 29 vaska të kultivimit të peshkut në pronësi, “Coral Fish” është sot padyshim kompania më e madhe dhe kryesore e ekonomisë detare të Shqipërisë. Ka edhe mjaft kompani të tjera në këtë sektor, madje tendenca është drejt shtimit të tyre, e megjithatë “Coral Fish” vazhdon të mbajë prej shumë kohësh kurorën e liderit të sektorit. Dhe s’ka si të ndodhë ndryshe përderisa “Coral Fish” ka avantazhin e të qenit e para në këtë sektor dhe këtë avantazh jo vetëm që e ka ruajtur, por edhe e ka thelluar ndër vite. Duke u perfeksionuar vazhdimisht në të gjitha proceset e zënies, kultivimit e tregtimit të peshkut.

“Coral Fish” operon në sektorin e përpunimit të produkteve të detit që nga viti 1994. Prej shumë

tanks under its ownership, “Coral Fish” undoubtedly stands as the largest and leading company in Albania’s marine economy. While the sector sees increasing competition with several other companies, “Coral Fish” has maintained its leadership position for a long time, leveraging its advantage as a pioneer in the sector and continuously improving its processes in fishing, farming, and trading fish products.

“Coral Fish” has been operating in seafood processing since 1994. For many years, the company has also been active in international markets, intensifying its relationships in recent years. Its product range includes both locally sourced and imported fresh and frozen products, catering to a wide consumer base. Continuous improvements have been made in expanding activity spaces, adapting to labor and product quality standards consistent with EU norms.



vitësh, kjo kompani operon edhe në tregun ndërkombëtar, marrëdhëniet me të cilin janë intensifikuar së tepërmi vitet e fundit. Produktet e ofruara nga “Coral Fish” janë me origjinë nga vendi dhe importi. Gama e gjerë përfshin produkte të freskëta dhe të ngrira, duke kënaqur kështu nevojat e një numri të madh konsumatorësh. Që prej themelimit janë bërë përmirësime progresive për sa i takon zgjerimit të hapësirave të aktivitetit dhe përshtatjes së normave të punës dhe cilësisë së produkteve me të gjitha standartet e BE-së. Një përparësi të madhe biznesit i jep vendndodhja e stabilimentit pranë portit të peshkimit. Për më shumë, zotërimi i anijeve të peshkimit i jep “Coral Fish” mundësi peshkimi në detin Adriatik dhe Jon duke garantuar kështu një itinerar të shkurtër nga momenti i peshkimit deri në fazën e përpunimit dhe të ruajtjes.

Stabilimenti i ri me një imazh bashkëkohor është inaguruar në vitin 2008. Sipërfaqja e zhvillimit të aktivitetit është 6000 m², ndërsa baza ftohëse zë një hapësirë prej 5000 m³. Teknologjia e përdorur është mjaft bashkëkohore, gjë që i krijon kompanisë një avantazh konkurrues.



Its strategic location near the fishing port and ownership of fishing vessels enable efficient fishing operations in the Adriatic and Ionian Seas, ensuring a short journey from catching to processing and preservation phases.

The company inaugurated a modern facility in 2008, covering 6000 m² of operational space and a 5000 m³ refrigeration base, equipped with contemporary technology that gives “Coral Fish” a competitive edge.



ILIR LINZA

Drejtor i Përgjithshëm i FPM Group

Emri i kompanisë: **FPM Tutto Mobili (Fabrika e Prodhimit të Mobiljeve), Best Seller**
Khiri e biznesit 2023: **25 milionë euro**
Numri i punonjësve: **350**
Vendndodhja: **Tiranë**

ILIR LINZA

General Director of FPM Group

Company Name: **FPM Tutto Mobili (Furniture Manufacturing Factory), Best Seller**
Turnover 2023: **25 million EUR**
No. of employees: **350**
Location: **Tirana**

Fabrika e prodhimit të mobiljeve FPM (Tutto Mobili) është një kompani që çdo 1 janar e fillon betejën vjetore në treg me veten e saj. Jo se në sektorin e prodhimit të mobiljeve nuk ka kompani të tjera. Përkundrazi, edhe syri i një qytetari të zakonshëm e vë re se sa shumë të dendura e të përhapura janë njësitë e prodhimit dhe të shitjes së mobiljeve në Shqipëri. Disa janë kompani të mëdha, por shumë kanë mbetur në stadin e njëjësive të mesme e të vogla, megjithatë të afta, që nëpërmjet shtimit të ofertës në treg, të stimulojnë konkurrencën. Mirëpo, Fabrika e Prodhimit të Mobiljeve (FPM Tutto Mobili) është diçka krejt tjetër. Është një kompani që lëviz në sens të kundërt me atë të pothuajse gjithë kompanive të tjera në Shqipëri, sepse e tillë është projektuar që në fillimet e saj. Pra, kur Ilir Linza dhe ortakët e tij projektuan fabrikën si biznesin kryesor të tyre, ajo u konceptua si një kompani që do të ishte e aftë të funksiononte jo për tregun lokal e të vogël shqiptar, por për tregun ndërkombëtar. Pra do të ishte një kompani, e cila do të prodhonte, ndërkohë që i gjithë prodhimi

The furniture manufacturing company FPM (Tutto Mobili) is a company that begins its annual market battle with itself every January 1st. This isn't because there are no other companies in the furniture manufacturing sector. On the contrary, even the average citizen can notice how dense and widespread the furniture manufacturing and sales units are in Albania. Some are large companies, but many remain in the stage of medium and small units, which, by increasing market supply, stimulate competition. However, the Furniture Manufacturing Factory (FPM Tutto Mobili) is something entirely different. It is a company that moves in the opposite direction of almost all other companies in Albania because it was designed that way from its inception. When Ilir Linza and his partners designed the factory as their primary business, it was conceived as a company that would be capable of functioning not for the local and small Albanian market, but for the international market. It was envisioned as a company that would produce goods entirely

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km. 5, Tiranë-Shqipëri
 Tel: ++ 355 48 200 348; ++ 355 48 200 349, 048 200 350
 Fax: ++ 355 48 200 351

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km. 5, Tiranë-Shqipëri
 Tel: ++ 355 48 200 348; ++ 355 48 200 349, 048 200 350
 Fax: ++ 355 48 200 351



Bjorn Linza

do të destinohej e do të shitej në eksport.

Realiteti është se FPM kështu ka funksionuar, kështu funksionon e kështu do të funksionojë edhe në të ardhmen, duke qenë kompania më e madhe e prodhimit të mobiljeve, që pjesën më të madhe të prodhimit të saj e destinon në tregjet e vendeve të ndryshme të huaja. Në këtë mënyrë, funksionimi i kësaj kompanie, në një periudhë afatgjatë, sipas kësaj fizionomie, ua ka vërtetuar saktësinë e vizionit krijuesve e drejtuesve të saj. Fabrika e Prodhimit të Mobiljeve përfaqëson një kompani, aktiviteti i së cilës ka lëvizur çdo vit midis 1 dhe 1.2 miliardë lekëve. Gjatë vitit 2023, aktiviteti pati një farë rënie të lehtë, me një ndikim nga faktorë të jashtëm, sikurse ishin lufta Rusi-Ukrainë apo luhatjet e kursit të këmbimit, ndaj të cilëve është i ekspozuar çdo subjekt që ka aktivitet eksportues. Ndaj, s'kishte si të bënte dallim as FPM, e cila, përveç të tjerave, duhej të vuante edhe faktin që tregu global, në fushën e tregtisë ku vepron FPM, pati një ulje prej 30 për qind.

Megjithatë, duke pasur parasysh veprimin e të gjithë këtyre faktorëve, sërisht, për FPM mund të thuhet me siguri se viti 2023 ishte vit pozitiv, edhe pse, krahasuar me vitin paraardhës u shënuar një ulje prej 22 për qind. Por, sikurse e thamë edhe më lart, FPM këto llogari i ka vetëm me veten e saj, sepse me konkurrentët e ka fituar betejën e vitit 2023, ashtu sikurse e ka fituar çdo vit tjetër, pasi asnjë kompani e këtij sektori nuk i ka treguesit e FPM-së. Flasim për treguesit zyrtarë,



Elis Linza

destined for export.

The reality is that FPM has operated this way, continues to operate this way, and will operate this way in the future, being the largest furniture manufacturing company that allocates the majority of its production to foreign markets. In this way, the long-term operation of this company according to this business model has proven the accuracy of the vision of its creators and leaders. The Furniture Manufacturing Factory represents a company whose activity has ranged annually between 1 and 1.2 billion lekë. During 2023, the activity experienced a slight decline due to external factors such as the Russia-Ukraine war or exchange rate fluctuations, to which any exporting entity is exposed. Therefore, FPM was no exception, also suffering from the fact that the global market in the field in which FPM operates experienced a 30 percent downturn.

Nevertheless, considering all these factors, it can still be confidently stated that 2023 was a positive year for FPM, even though there was a 22 percent decrease compared to the previous year. But, as mentioned above, FPM measures its performance against itself, as it has won the battle against its competitors in 2023, just as it has in every other year, since no company in this sector matches FPM's metrics. We are referring to official metrics, as the furniture production and sales sector also has a lot of informality within it.

sepse sektori i prodhimit dhe shitjes së mobiljeve ka edhe shumë informalitet brenda tij. Drejtuesit e kompanisë parashikojnë rritje të mëtejshme të aktivitetit, duke pasur prioritet sigurimin e tregjeve të reja vendase dhe të huaja. Dhe garanci për këtë është cilësia e produkteve të tyre, që buron nga lëndë të para cilësore të blera në vende të BE-së, përshtatjen e modeleve të produkteve me dinamizmin e tregjeve vendase e të huaja, etj.

Por, Fabrika e Prodhimit të Mobiljeve është vetëm njëra nga “gjymtyrët” e FPM Group. Pasi, që nga viti 2016, këtij grupi i është shtuar edhe një tjetër, kompania Best Seller Albania. Sepse, vërtet që Fabrika e Prodhimit të Mobiljeve ishte ndërtuar dhe projektuar për të qenë konkurrenente në tregje të mëdha, por për shumë vite, ajo ishte e vetpërrjashtuar nga konkurrimi në tregun e brendshëm shqiptar. Derisa erdhi një moment, kur Ilir Linza e konsideroi edhe tregun e brendshëm shqiptar me potencial për të kontribuar në rritjen e biznesit të tyre, pa u dekurajuar fare nga fakti se tregu i brendshëm i prodhimit dhe shitjes së mobiljeve ishte tokë e xanun nga qindra kompani të tjera të vogla e të mëdha. Por, duke qenë besimplotë në aftësitë e veta konkurruese, në filozofinë e të bërit biznes, ai themeloi kompaninë Best Seller Albania. Rezultatet e saj ka vetëm një fjalë që i përshkruan saktë dhe kjo fjalë është: ecuri e shkëlqyer.

Me rritje spektakolare nga viti në vit, ajo i ngjante një makine të Formula 1, që ndonëse e kanë penalizuar të niset nga fundi, i parakalon



The company’s leaders anticipate further growth in activity, prioritizing securing new domestic and foreign markets. A guarantee for this is the quality of their products, which stems from high-quality raw materials purchased in EU countries, the adaptation of product models to the dynamics of domestic and foreign markets, and more.

But the Furniture Manufacturing Factory is just one of the “limbs” of FPM Group. Since 2016, another company, Best Seller Albania, has been added to this group. Although the Furniture Manufacturing Factory was built and designed to be competitive in large markets, for many years, it excluded itself from competing in the domestic Albanian market. Until the moment





të gjithë kundërshtarët dhe arrin të dalë në vend të parë brenda një harku kohor 7-vjeçar. Bestseller ka një bazë të qëndrueshme klientësh, të cilët i kanë qëndruar besnikë kompanisë ndër vite. Por edhe Bestseller u ka qëndruar besnik klientëve me moton: të përmbushim nevojat jo sipas mundësisë, por sipas kërkesave, në mënyrë që të kënaqim kërkesat dhe pritshmëritë e konsumatorëve.

Gjatë vitit 2023, Bestseller Albania arriti ta kalojë shifrën e 1.05 miliardë lekëve si aktivitet, çka do të thotë vazhdim i procesit të rritjes së saj, ndonëse me doza modeste, 3 për qind, në krahasim me vitet e mëparshme. Dhe receta e suksesit të saj është kryesisht raporti cilësi-çmim, si dhe marketing i vazhdueshëm. Në 10 vitet e ardhshme, drejtuesit e kompanisë, Erlis dhe Bjorn Linza, parashikojnë që Bestseller do të vazhdojë të ruajë pozicionin e fortë në treg, duke përmbushë kërkesat e konsumatorëve me koston më të ulët të mundshme dhe cilësinë më të lartë në sinkron me kërkesat e tyre.

arrived when Ilir Linza considered the domestic Albanian market to have potential to contribute to their business growth, undeterred by the fact that the domestic furniture manufacturing and sales market was already occupied by hundreds of other small and large companies. However, being confident in his competitive abilities and business philosophy, he founded the company Best Seller Albania. There is only one word that accurately describes its results: excellent progress.

With spectacular growth year after year, it resembled a Formula 1 car that, despite being penalized to start from the back, overtakes all competitors and reaches first place within a seven-year timeframe. Best Seller has a stable customer base that has remained loyal to the company over the years. But Best Seller has also remained loyal to its customers with the motto: meeting needs not according to our capabilities, but according to demands, in order to satisfy consumers' needs and expectations.

During 2023, Best Seller Albania surpassed the activity threshold of 1.05 billion lekë, which signifies the continuation of its growth process, albeit with modest doses of 3 percent compared to previous years. And the recipe for its success is primarily the quality-price ratio, along with continuous marketing. Over the next 10 years, the company's leaders, Erlis and Bjorn Linza, foresee that Best Seller will continue to maintain a strong market position, fulfilling consumer demands at the lowest possible cost and the highest quality in line with their expectations.



ROBERT MASHA

*Administrator i Përgjithshëm
i kompanisë “Maccaferri Balkans”*

Xhiro e biznesit 2023: 25 milionë euro
Ndryshimi në % 23/22: +14
Numri i punonjësve: 220
Vendndodhja: Durrës

ROBERT MASHA

*General Administrator
of “Maccaferri Balkans”*

Turnover 2023: 25 million EUR
Difference in % 23/22: +14
No. of employees: 220
Location: Durrës

Kompania “Maccaferri Balkans” ka mbushur plot 15 vjet aktivitet në Shqipëri. Për periudhën më të gjatë ndër këta 15 vjet, ajo ka përmbyshur nevojat e tregut të Shqipërisë, të Kosovës dhe të Maqedonisë veriore për materiale të ndryshme si: gabione, gjeogride, tela lidhës, rrjeta teli, gjeomat, materase, rrjeta perde, etj. Në vitin 2022 nisi një projekt i rëndësishëm transformues i kompanisë. Një proces që synonte kthimin e saj nga një kompani thjesht tregtare, në qendrën kryesore të prodhimit për zonën europiane dhe të Lindjes së Mesme. Dhe ky mision i korrespondoi kompanisë në kohën që në krye të saj u emërua Robert Masha, një djalosh i ri shqiptar, i diplomuar në Bolonja të Italisë dhe që vinte nga një karrierë në studio italiane të auditimit. Natyrisht që për të përmbyshja e këtij misioni ishte dhe vazhdon të jetë më shumë sesa sfidë. Kjo pasi me marrë detyra prodhimi dhe me i plotësu ato nga një kompani e themeluar në vitin 1879, sikurse është Officinë Maccaferri, do të thotë me qenë para një sprove jo të lehtë.

“Maccaferri Balkans” has celebrated 15 years of activity in Albania. For the longest period during these 15 years, it has met the needs of the markets in Albania, Kosovo, and North Macedonia for various materials such as gabions, geogrids, binding wires, wire meshes, geomats, mattresses, mesh curtains, etc. In 2022, an important transformative project for the company began. This process aimed to turn it from a merely commercial company into the main production center for the European and Middle Eastern regions. This mission corresponded with the appointment of Robert Masha, a young Albanian man, as the head of the company. He graduated in Bologna, Italy, and came from a career in Italian auditing firms. Naturally, for him, fulfilling this mission was and continues to be more than a challenge. Undertaking production tasks and completing them for a company founded in 1879, like Officine Maccaferri, means facing a considerable test.

Adresa: Maccaferri Balkans Sh. P. k. Autostrada DR-TR; KM 6, SH2 Xhafzotaj,
Durrës, Albania
Tel: +355 4 450 3882
E-mail: info.al@maccaferri.com

Address: Maccaferri Balkans Sh. P. k. Autostrada DR-TR; KM 6, SH2 Xhafzotaj,
Durrës, Albania
Tel: +355 4 450 3882
E-mail: info.al@maccaferri.com



Të organizosh punën dhe prodhimin në mënyrë të tillë që të rezultojë në realizimin e kërkesave të Officinë Maccaferri, që është një lider global në inxhinierinë civile dhe mjedisore, me mbi 20 fabrika në 4 kontinente dhe me mbi 600 milionë euro gjatë vitit 2023, do të thotë të demonstrosh aftësi organizimi dhe menaxhimi. Dhe përgjatë këtyre 2 viteve të fundit, kur kompania është kthyer në fabrikë prodhuese për llogari të Officinë Maccaferri, rezultatet kanë qenë mbresëlënëse. Tërësisht brenda pritshmërive dhe kalkulimeve të drejtuesve të kompanisë dhe pronarëve të saj, me një trend rritjeje të rëndësishme nga viti në vit.

Edhe përgjatë vitit 2023, “Maccaferri Balkans” realizoi një performancë të kënaqshme për të gjithë. Aktiviteti i kompanisë rezultoi në mbi 2.8 miliardë lekë, që e krahasuar me vitin paraardhës tregon për një rritje të volumit të aktivitetit prej 14 për qind. Edhe sa i takon performancës në drejtim të përfitueshmërisë, kompania ka përmirësim të ndjeshëm nga viti paraardhës. Sigurisht, duke qenë kompani që prodhon për llogari të “Officinë Maccaferri”, fitimi i “Maccaferri Balkans” është më shumë një tregues i përmirësimit të mëtejshëm të punës së kompanisë në Shqipëri, në drejtim të optimizimit të kostove të saj. Pra është tregues domethënës i cilësisë së menaxhimit të kompanisë.

“Maccaferri Balkans” ka avancuar edhe disa treges të tjerë, sikurse është numri i fuqisë punëtore, duke kaluar në 220 të punësuar nga

Organizing work and production in such a way that meets the demands of Officine Maccaferri, a global leader in civil and environmental engineering with over 20 factories across 4 continents and over 600 million euros in 2023, means demonstrating organizational and management skills. Over the past two years, as the company has turned into a manufacturing plant for Officine Maccaferri, the results have been impressive. Entirely within the expectations and calculations of the company’s executives and owners, with a significant growth trend year after year.

Even in 2023, “Maccaferri Balkans” performed satisfactorily for everyone. The company’s activity resulted in over 2.8 billion ALL, indicating a 14% increase in activity volume compared to the previous year. Regarding profitability, the company



160 që ishin një vit më parë. Ndërkohë, gjatë vitit 2023 janë realizuar edhe rreth 500 mijë euro investime të tjera nga ana e kompanisë, të cilat konsistojnë në vendosjen e paneleve fotovoltaike. Është një investim që për të, si një konsumator i madh industrial, po rezultojnë mjaft efektiv, pasi arrin të përmbushë mbi 50 për qind të nevojave të kompanisë. Kurse shlyerja e investimit është parashikuar të kryhet brenda dy viteve.

Edhe një risi tjetër shënoi veprimtaria e “Maccafferri Balkans” gjatë vitit të kaluar. Tregu i brendshëm, që nënkuptohet tregu shqiptar, si dhe ai kosovar e maqedonas, pati një ecuri më të mirë se parashikimi, çka do të thotë se kjo kompani, krahas përmbushjes së porosive të “Officinë Maccafferri” duhet të parashikojë rritjen e kërkesave edhe nga tregu ballkanik, si rrjedhojë e projekteve të ndryshme në infrastrukturë që po zbatohen e do zbatohen aty. Edhe pse tashmë “Maccafferri Balkans” është një kompani që ushtron aktivitetin në një territor të madh, në disa godina, e megjithëse janë në funksion 12 linja prodhimi, Robert Masha tregon për plane të tjera investimi, që do të synojnë në vendosjen e dy lindjave të tjera të prodhimit, në rritjen e kapaciteteve magazinuese të kompanisë, etj. Në botëkuptimin e tij si menaxher dhe drejtues i kompanisë ka zenë vend koncepti i përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit, dhe kështu e percepton dhe interpreton ai punën në drejtim të “Maccafferri Balkans”.

Pra viti 2023 ishte i suksesshëm për “Maccafferri”, punonjësit dhe drejtuesit e

has seen a significant improvement from the previous year. Being a company that produces for Officine Maccafferri, “Maccafferri Balkans” profit is more an indicator of the company’s improved performance in Albania, in terms of optimizing its costs. Thus, it is a meaningful indicator of the company’s management quality.

“Maccafferri Balkans” has also advanced in other areas, such as the number of employees, increasing to 220 from 160 the previous year. Meanwhile, in 2023, the company made additional investments of around 500,000 euros, which included the installation of photovoltaic panels. This investment, as a major industrial consumer, has proven very effective, meeting over 50% of the company’s needs. The investment is expected to pay off within two years.

Another novelty marked the activity of “Maccafferri Balkans” last year. The internal market, which includes the Albanian market, as well as the Kosovo and Macedonian markets, performed better than expected. This means that the company, in addition to fulfilling Officine Maccafferri’s orders, must anticipate growing demands from the Balkan market due to various infrastructure projects being implemented or planned. Even though “Maccafferri Balkans” now operates in a large area with several buildings and 12 production lines, Robert Masha speaks of further investment plans, aiming to set up two additional production lines and increase the company’s storage capacities, among other



saj. Por “Maccaferri Balkans” si një kompani me përgjegjshmëri të theksuar sociale është angazhuar edhe në drejtim të përkrahjes financiare të projekteve të ndryshme siç është ekspozita Love as a Glass of Water e artistes Iva Lulashi në Ekspozitën e 60-të Ndërkombëtare të Artit-Bienale e Venecias.

Duke mbështetur Pavionin Shqiptar, Officine Maccaferri synon të theksojë angazhimin e kompanisë për vlerësimin e artit dhe kulturës vendase, ku Grupi është i pranishëm prej më shumë se njëzet vitesh, fillimisht me një prani tregtare dhe më pas, prej vitit 2009, me një fabrikë prodhimi, e sot ndër operatorët industrialë të konsoliduar. Që në fillim të viteve 2000, Maccaferri Balkans ka marrë pjesë në zbatimin e projekteve të rëndësishme të infrastrukturës dhe së fundmi ka inauguruar një fabrikë të re prodhimi në Shijak me synimin që ta kthejë në qendrën kryesore të prodhimit për zonën evropiane dhe të Lindjes së Mesme, si dhe qendër ekselence për zhvillimin e teknologjive bashkëkohore.

Bienalja e Venecias është ndër ngjarjet më prestigjioze të artit bashkëkohor, e njohur në të gjithë botën. E titulluar “Të huaj kudo” – “Foreigners Everywhere” dhe e kuruar nga Adriano Pedrosa, sivjet Ekspozita Ndërkombëtare shoqërohet me 88 Pjesëmarrje Kombëtare në pavionet historike në Xhardini, Arsenal dhe në qendrën historike të Venecias.

“Kemi kënaqësinë të mbështesim Pavionin Albania dhe artisten Iva Lulashi në një skenë të jashtëzakonshme si Bienalja e Venecias, një nga ngjarjet më të rëndësishme artistike në mbarë botën”, deklaroi Sergio Iasi, President i Officine Maccaferri. “Duke promovuar vlerën e artit dhe të kulturës shqiptare, ne synojmë të japim një demonstrim të mëtejshëm, për lidhjen tonë të fortë me vendin, ku pesëmbëdhjetë vjet më parë vendosëm të hapnim një degë prodhimi, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka tregu ballkanik në strategjinë tonë globale. Jemi krenar për investimet e kryera në Shqipëri dhe në një të ardhme të shpejtë do të angazhohemi për të zhvilluar më tej praninë tonë industriale”.

things. His managerial philosophy revolves around the concept of continuous management improvement, which is how he perceives and interprets his work at “Maccaferri Balkans.”

Thus, 2023 was successful for “Maccaferri,” its employees, and its leaders. “Maccaferri Balkans,” with a strong social responsibility, has also engaged in financially supporting various projects such as the “Love as a Glass of Water” exhibition by artist Iva Lulashi at the 60th International Art Exhibition - Venice Biennale. By supporting the Albanian Pavilion, Officine Maccaferri aims to emphasize its commitment to valuing local art and culture, where the Group has been present for over twenty years, initially with a commercial presence and since 2009 with a production plant, now among the consolidated industrial operators.

Since the early 2000s, “Maccaferri Balkans” has participated in the implementation of significant infrastructure projects and recently inaugurated a new production plant in Shijak, aiming to turn it into the main production center for the European and Middle Eastern regions, as well as a center of excellence for developing contemporary technologies.

The Venice Biennale is among the most prestigious contemporary art events globally. Titled “Foreigners Everywhere” and curated by Adriano Pedrosa, this year’s International Exhibition features 88 National Participations in the historic pavilions at Giardini, Arsenale, and Venice’s historic center.

“We are pleased to support Pavilion Albania and artist Iva Lulashi on an extraordinary stage like the Venice Biennale, one of the most important artistic events worldwide,” stated Sergio Iasi, President of Officine Maccaferri. “By promoting the value of Albanian art and culture, we aim to further demonstrate our strong connection with the country, where fifteen years ago we decided to open a production branch, considering the great importance of the Balkan market in our global strategy. We are proud of the investments made in Albania and will soon commit to further developing our industrial presence.”



RAM GECI

President i "GECI" Group

Emri i kompanisë: "GECI Group"
Xhiro e biznesit 2023: 21 milionë EURO
Numri i punonjësve: 300
Vendndodhja: Tiranë

RAM GECI

President of "GECI" Group

Company name: "GECI Group"
Turnover 2023: 21 million EUR
No. of employees: 300
Location: Tirana

Biznesi shqiptar tashmë ka një histori 30-vjeçare. Ai paraqitet i strukturuar dhe i konsoliduar, me një numër të konsiderueshëm operatorësh në çdo sektor. Por edhe pse ka mbi tri dekada që ushtrohet, të rralla janë bizneset që konkretizojnë idetë ose veprimet brilante të biznesit. Po qe se do të bëjmë një klasifikim me dhjetë idetë ose veprimet më brilante të biznesit shqiptar, padyshim që vendimin e biznesmenit të mirënjohur Ram Geci për të blerë "Hotel Tirana" do të duhet ta përfshijmë në to. Sepse nuk bëhet fjalë thjesht për blerjen e një aseti, sado i çmuar të jetë ai. Por nëpërmjet këtij veprimi të guximshëm – kujtojmë se Ram Geci ua bleu këtë hotel aksionerëve të tjerë private – ai shtroi një "rrugë" të re në veprimtarinë e tij. Pra pas qindra kilometrave rrugë të shtruara, të asfaltuara e të riparuar, pas ndërtimit ose rikonstruksionit të dhjetëra objekteve të infrastrukturës, ai gjykoj në momentin e duhur se kishte ardhë koha për një diversifikim të veprimtarisë së vet.

Zhvillimet e mëpasme treguan se ky nuk ishte një diversifikim i thjeshtë aktiviteti, pasi ecuria e Tirana International Hotel, e më vonë ndërtimi

Albanian business now has a 30-year history. It presents itself as structured and consolidated, with a considerable number of operators in every sector. However, despite over three decades of activity, it is rare for businesses to materialize brilliant business ideas or actions. If we were to classify the ten most brilliant business ideas or actions in Albanian business, we would undoubtedly have to include the decision of the well-known businessman Ram Geci to purchase "Hotel Tirana." This is not merely about acquiring an asset, however valuable it may be. Through this bold move—recalling that Ram Geci bought this hotel from other private shareholders—he paved a new "path" in his activity. After hundreds of kilometers of paved, asphalted, and repaired roads, and the construction or reconstruction of dozens of infrastructure objects, he judged at the right moment that it was time to diversify his activities.

Subsequent developments showed that this was not a simple diversification of activity, as the progress of Tirana International Hotel, and

Adresa: Zyra Qëndrore: Hotel Tirana Internacional, Nr 8 Tirane
 Tel/Fax: +355 4 22 70 723
 Cel: +355 67 406 0370
 E-mail: info@geci.com.al

Address: Central Offices: Hotel Tirana Internacional, Skenderbej Square, Nr 8 Tirane
 Tel/Fax: +355 4 22 70 723
 Cel: +355 67 406 0370
 E-mail: info@geci.com.al



edhe i hotelit superluksoz InterContinental i kanë dhënë Ram Gecit një identitet të ri: atë të një biznesmeni të rëndësishëm në sektorin e hotelierisë dhe të turizmit.

Askush nuk e di dhe nuk është në gjendje të kalkulojë se si do të ishte statusi i tij sot, po të vazhdonte në atë sektor ku ka vepruar që në fillimet e tij, pra në sektorin e punimeve në infrastrukturë. Mbase mund të kishte arritur sot që të kishte një ndër kompanitë që do të realizonte ndonjë projekt ndërtimi të ndonjë rruge me koncension, ashtu sikundër kanë vepruar biznesmenë të tjerë, por që aktivitetin e kanë

later the construction of the super-luxurious InterContinental hotel, gave Ram Geci a new identity: that of an important businessman in the hospitality and tourism sector.

No one knows and no one is able to calculate what his status would be today if he had continued in the sector where he began, namely in the infrastructure works sector. Perhaps he could have achieved having one of the companies that would carry out some construction project of a road under concession, just as other businessmen have done, but who started their activities later than he did. Because

nisur më vonë se ai. Sepse, kapacitetet teknike i kishte dhe i ka.

Shoqëria GECE Sh.p.k. ka në pronësi mbi 150 mekanizma, mjete dhe makineri, të cilat bëjnë të mundshëm realizimin me sukses të projekteve në fushën e ndërtimit:

- Fabrikë për prodhim asfalti.
- Fabrikë për prodhim betoni.
- Linjë për prodhim inertesh.
- Makineri të rënda gërmimi, eskavatorë me kapacitete të ndryshme.
- Mjete transporti të tonazheve të ndryshme, kryesisht mbi 25 tonë.
- Makineri dhe pajisje për ndërtimin e shtresave rrugore dhe asfaltike (asfaltoshtresues dhe rula vibratorë të llojeve të ndryshme, mjete për shpërndarje bitumi, instrumente matëse të ndryshme).
- Makineri për nivelime dhe ngarkime (autogredera, buldozerë, fadroma, JCB).
- Rimorkiator të tonazheve të rënda dhe të lehta, autovinç, autobote uji, autobote për transport dhe mbajtje karburanti.
- Mikser statikë dhe të lëvizshëm për prodhim dhe transport betoni.
- Servise statike dhe të lëvizshme për riparim të makinerive.
- Një numër të konsiderueshëm pajisjesh si: instrument për provat e ngarkesave statike, instrument për matjen e të dhënave rrugore, gjenerator trefazor e njëfazor, pompa uji, matrapik, miksera, vibrator, aparate saldimi, pajisje për lidhje plastike, skeleri, etj.

Pra, me fjalë të tjera kemi të bëjmë me një kompani që ka aftësinë dhe kapacitetet teknike dhe inxhinierike për të marrë përsipër çdo projekt, sado i vështurë e i komplikuar të jetë ai.

Por sikurse kemi thënë edhe herë tjetër, biznesi i rregullimit të infrastrukturës përfaqëson një aktivitet që kryhet nëpërmjet prokurimeve publike, e ku pretendentë për të marrë punë ka me dhjetëra e qindra kompani, përveçse ka qenë dhe mbetet biznes klientelist, ku shpesh nuk mjafton të japësh ofertën më të mirë. Ndaj, devijimi i Ram

he had and still has the technical capacities.

GECE Sh.p.k. owns over 150 mechanisms, tools, and machinery, which make it possible to successfully implement projects in the field of construction:

- Asphalt production plant.
- Concrete production plant.
- Inerts production line.
- Heavy excavation machinery, excavators with various capacities.
- Transport vehicles of different tonnages, mainly over 25 tons.
- Machinery and equipment for the construction of road and asphalt layers (asphalt pavers and vibratory rollers of various types, bitumen spreaders, various measuring instruments).
- Machinery for leveling and loading (motor graders, bulldozers, front loaders, JCB).
- Heavy and light-tonnage trailers, cranes, water tankers, fuel transport and storage tankers.
- Static and mobile mixers for concrete production and transport.
- Static and mobile services for machinery repair.
- A considerable number of equipment such as: instruments for static load tests, instruments for road data measurement, three-phase and single-phase generators, water pumps, jackhammers, mixers, vibrators, welding equipment, plastic connection equipment, scaffolding, etc.

In other words, we are dealing with a company that has the technical and engineering capabilities to undertake any project, no matter how difficult and complex it may be.

But as we have said before, the business of infrastructure regulation represents an activity carried out through public procurements, where there are dozens and hundreds of companies vying for work, besides being a client-based business, where often the best offer is not enough. Therefore, Ram Geci's deviation from



Gecit nga ky prioritet, por mosheqja dorë prej tij, përbën një leksion të vërtetë biznesi. “Rama i rrugëve” njihej dikur ai si rezultat i profilit që kishte ndërtuar nëpërmjet kompanisë GECL, ndërsa tani identiteti i tij kryesor është “Rama i 15-katëshit dhe i 37-katëshit”.

Se sa brilant ishte vendimi i tij për blerjen 100 për qind të kuotave të Tirana International Hotel u verifikua më vonë dhe vazhdon të verifikohet çdo vit, kur shikon rrugët e Tiranës të përmblytura me turistë. Se do vinte kjo ditë, mund ta kenë parashikuar pak vetë, por sigurisht që Ram Geci është njëri prej tyre. Ndaj dhe tashmë shijon suksesin e vet, qoftë nëpërmjet aktualitetit, qoftë nëpërmjet investimeve që i forcojnë së tepërmi perspektivën.

Prej të paktën tre vjetësh Grupi i tij realizon një aktivitet në kufirin e 25 milionë eurove dhe një fitim vjetor prej 3.5-4 milionë eurosh. Ndërkohë, investimi për përfundimin e InterContinental vazhdon pa ndërpreje, duke i ofruar kryeqytetit edhe një tjetër strukturë superluksoze me mbi 300 dhoma.

Miliarderi John Paul DeJoria e sheh suksesin si “shumë punë” gjatë gjithë kohës. Ai beson se “suksesi nuk ka të bëjë me paratë që keni. As me pozicionin që keni në punë e shoqëri. Suksesi ka të bëjë me sa mirë bëni diçka kur askush nuk është duke ju parë”.

Ky përcaktim i shkon fiks Ram Gecit.

this priority, without abandoning it, represents a true business lesson. He was once known as “Rama of the roads” due to the profile he had built through the GECL company, but now his main identity is “Rama of the 15-story and 37-story buildings.”

How brilliant his decision was to purchase 100% of the shares of Tirana International Hotel was verified later and continues to be verified every year, when you see the streets of Tirana flooded with tourists. Few could have predicted this day would come, but Ram Geci was certainly one of them. Thus, he now enjoys his success, whether through current achievements or through investments that greatly strengthen his prospects.

For at least three years, his group has realized an activity bordering 25 million euros and an annual profit of 3.5-4 million euros. Meanwhile, the investment for the completion of the InterContinental continues without interruption, offering the capital another super-luxurious structure with over 300 rooms.

Billionaire John Paul DeJoria sees success as “a lot of work” all the time. He believes that “success is not about the money you have. Nor about the position you have at work or in society. Success is about how well you do something when no one is watching.”

This definition fits Ram Geci perfectly.



ARBEN NDEREKA

President i kompanisë "LUFRA Foods"

Emri i kompanisë: "LUFRA Foods" Group
Xhiro e biznesit 2023: 21 milionë euro
Numri i punonjësve: 280
Vendndodhja: Lushnje

ARBEN NDEREKA

President of the company "LUFRA Foods"

Company Name: "LUFRA Foods" Group
Turnover 2023: 21 million EUR
No. of employees: 280
Location: Lushnje

Para pak kohësh komania LUFRA i ka bërë një ndryshim emrit të saj. Tani quhet "LUFRA Foods". Nuk është manovër e drejtuesve të saj për të përmirësuar a zbukuruar emrin e kompanisë, sepse LUFRA është tashmë nga brandet më të njohura të krijuara nga biznesmenët shqiptarë. Për hir të së vërtetës, brande shqiptare që qëndrojnë suksesshëm në treg nuk ka shumë. Kur i është dashur t'i gjenin një emër biznesit që krijuan, këtu e 32 vjet më parë, çifti Ndreka mund të mos jenë menduar shumë. I bënë një bashkim shkronjave të emrave të të dy djemve të tyre, Luis dhe Franc, dhe ja ku lindi emri i biznesit, LUFRA.

Zhvillimi i kompanisë përgjatë këtyre viteve e ka kthyer LUFRA-n në brandin më të suksesshëm shqiptar që konkuron fuqimisht edhe me brandet e njohura ndërkombëtare të kësaj natyre. Por le të mos i ndahemi arsyes së plotësisht të emrit, duke i shtuar LUFRA-s edhe shtesën Foods. Kjo ishte një nevojë, që nëpërmjet këtij emri më të plotë, të tregohet edhe më mirë e më saktë natyra e

Recently, the company LUFRA has changed its name. It is now called "LUFRA Foods." This is not a maneuver by its executives to improve or embellish the company's name, as LUFRA is already one of the most well-known brands created by Albanian entrepreneurs. To be fair, there are not many successful Albanian brands in the market. When they had to find a name for their business, 32 years ago, the Ndreka couple might not have thought much about it. They simply combined the letters from the names of their two sons, Luis and Franc, and thus the business name, LUFRA, was born.

The development of the company over these years has turned LUFRA into the most successful Albanian brand, competing strongly with well-known international brands of this nature. But let's not stray from the reason for completing the name by adding the suffix Foods to LUFRA. This was a necessity, as this more complete name better and more accurately reflects the nature of the company; its current physiognomy; and the stage

Adresa: Autostrada Lushnje - Fier km. 7
Lushnje – Albania
Tel: 037 47 30 74
Cel: 068 90 22 120
E-mail: marketing@lufra.net
Rrethet - Cel: 068 9022 123

Address: Autostrada Lushnje - Fier km. 7
Lushnje – Albania
Tel: 037 47 30 74
Cel: 068 90 22 120
E-mail: marketing@lufra.net
Rrethet - Cel: 068 9022 123



kompanisë; fizionomia aktuale e saj; stadi ku ka arritur ajo. Sepse është e vërtetë që kompania LUFRA, e themeluar që në vitin tashmë të largët 1992, nisi si biznes në fushën e përpunimit të qumështit. Mirëpo, përgjatë gjithë këtyre viteve ajo është rritur shumë, qoftë nga ana sasiore, duke zgjeruar pjesën e tregut që ka kapur në Shqipëri, e duke kërkuar tregje të reja nëpërmjet eksportit. Por nga ana tjetër, LUFRA ka zgjeruar edhe gamën e produkteve të veta. Pra tashmë LUFRA ofron edhe produkte të tjera përtej 43 produkteve dhe nënprodukteve të qumështit, rrjedhojë kjo e përpunimit të më se 60 tonëve qumësht në ditë, të siguruar nga bashkëpunimi me fermat më të mëdha të prodhimit të qumështit të freskët në vend, si dhe nga bashkëpunimi me më shumë se 1500 fermerë, e i pranuar pas një procesi analizash skrupuloze. Pjesë e aktivitetit të kompanisë tashmë janë bërë edhe shpërndarja dhe tregtimi i produkteve të tjera të njohura në tregjet globale si Estrela Damm, Paulaner, Bonizzi, Cremona, Nom etj.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit të LUFRA-s është edhe ambalazhimi dhe tregtimi i ujit “Dukat”. Pra, është e vërtetë që kur thuhet LUFRA, konsumatorët perceptojnë kompaninë e njohur të përpunimit të qumështit, pasi konsumatori “takohet” çdo ditë nëpër supermarketet ose marketet e lagjes me qumështin e freskët të saj, kosin, dhallën, e me djathrat

it has reached. It is true that the LUFRA company, founded in the now distant year of 1992, started as a business in the field of milk processing. However, over all these years, it has grown significantly, both in quantity, expanding the market share it has captured in Albania and seeking new markets through export. On the other hand, LUFRA has also expanded its product range. So now LUFRA offers other products beyond 43 dairy products and sub-products, a result of processing more than 60 tons of milk per day, secured through cooperation with the largest fresh milk production farms in the country, as well as collaboration with more than 1500 farmers, accepted after a scrupulous analysis process. Part of the company's activity now also includes the distribution and trading of other well-known products in global markets such as Estrela Damm, Paulaner, Bonizzi, Cremona, Nom, etc.

An important part of LUFRA's activity is also the packaging and trading of “Dukat” water. So, it is true that when LUFRA is mentioned, consumers perceive the well-known milk processing company, as the consumer “meets” its fresh milk, yogurt, buttermilk, and various cheeses produced by this company in supermarkets or neighborhood markets every day. Over 60 refrigerated vans and 30 transport vans distribute the company's products daily to over 95 percent of the country's territory, thus creating a close connection with the consumer.

In addition to the domestic market, LUFRA has

e ndryshme të prodhuara nga kjo kompani. Mbi 60 furgonë frigoriferikë dhe 30 furgonë transporti shpërndajnë çdo ditë në mbi 95 për qind të territorit të vendit produktet e kompanisë, duke krijuar kështu një lidhje të ngushtë me konsumatorin.

Përveç tregut vendas, ka disa vite që LUFRA ka zgjeruar aktivitetin edhe në Kosovë, duke ndërtuar një qendër të madhe shpërndarjeje atje, e cila i bashkëngjitet kështu edhe 4 qendrave të tjera moderne që ka kompania në Lushnjë, Tiranë, Sarandë dhe Korçë. Për ta ruajtur e forcuar reputacionin e kompanisë, drejtuesit jo më kot kanë ndjekur strategjinë e shpërndarjes në çdo qytet të Shqipërisë me metjet e veta dhe duke shërbyer në mbi 6000 pika shitjeje, pasi kjo mënyrë është gjykuar nga ata si më e mira për të ruajtur cilësinë e produkteve, për t'i çuar ato te konsumatori, ashtu sikurse ia kanë premtuar. Pra, si produkte të sigurta e cilësore.

Gjatë vitit 2023 LUFRA u vlerësua nga organizata Icertias me seli në Zvicër me çmimin “Best Buy” si kompania e përzgjedhur nga konsumatorët shqiptarë për raportin më të mirë cilësi-çmim për produktet e qumështit dhe kosit. Ky është një vlerësim shumë i rëndësishëm që e rendit “LUFRA”-n krahas kompanive më të mira globalisht si Unilever, P&G, Danone, etj.

Investimet që i shërbejnë perfeksionimit të aktivitetit nuk kanë munguar as gjatë vitit 2023. Këto investime strukturuan repartet e prodhimit të produkteve të ngurta e të lëngta, duke krijuar

expanded its activity in Kosovo for several years, building a large distribution center there, which joins the other 4 modern centers the company has in Lushnjë, Tiranë, Saranda, and Korça. To maintain and strengthen the company’s reputation, the executives have deliberately followed the strategy of distributing in every city of Albania with their own means and serving in over 6000 points of sale, as this method is judged by them as the best to maintain product quality, delivering them to the consumer as promised. So, as safe and quality products.

During 2023, LUFRA was awarded by the Icertias organization based in Switzerland with the “Best Buy” award as the company chosen by Albanian consumers for the best quality-price ratio for dairy products and yogurt. This is a very important recognition that ranks LUFRA alongside the best companies globally such as Unilever, P&G, Danone, etc.

Investments serving the perfection of activity have not been lacking during 2023. These investments structured the production departments of solid and liquid products, creating more space and opportunity to manage production more efficiently. New storage spaces were created for imported products, for which “LUFRA Foods” distributes in the Albanian market.

Certainly, in the context of global crises, LUFRA Foods’ activity would be somewhat challenged, and yet it not only withstood the storm but emerged stronger from it. Thus passing



më shumë hapësirë e mundësi për të menaxhuar më me efikasitet prodhimin. U krijuan hapësira të reja magazinuese për produktet e importuara, për të cilat “LUFRA Foods” bën distribucion në tregun shqiptar.

Sigurisht që në kontekstin e krizave globale edhe aktiviteti i LUFRA Foods do të sfidohej disi, e megjithatë ajo jo vetëm e përballoi stuhinë, por doli edhe më e fortë prej saj. Duke kaluar kështu një vit shumë të rëndësishëm në zgjerimin e kompanisë, inovacionin dhe angazhimin e palëkundur për përsosmëri.

Po nga ana financiare si performoi kompania përgjatë vitit 2023? Aktiviteti i saj rezultoi afro 21 milionë euro, çka do të thotë se krahasuar me një vit më parë ai u rrit me afro 30 për qind. Sigurisht që ndikimi i krizave globale ka ndikuar disi në efektivitetin e kompanisë, megjithatë ajo mundi të sigurojë sasinë e nevojshme të fondeve të investimeve vjetore, të jetë korrekte në maksimum me partnerët e saj, nga të cilët siguron lëndën e parë, si dhe t’u përgjigjet nevojave të kohës për t’i reflektuar e rritur pagat e punonjësve. “Lufra Foods” është kompani që bën pjesë në sektor të vështirë, siç është sektori prodhues, ndaj vlera e kësaj kompanie është e pallogaritshme për ndikimin e saj në stimulimin e blegtorisë. Por me manovrat e kohëve të fundit, duke shtuar në “shportën” e saj edhe shumë produkte të tjera, të njohura e më pak të njohura, është e sigurtë se kompania do të njohë rritje të mëtejshme në aktivitetin e saj.



a very important year in the company’s expansion, innovation, and unwavering commitment to excellence.

How did the company perform financially in 2023? Its activity resulted in approximately 21 million euros, which means it grew by about 30 percent compared to the previous year. Of course, the impact of global crises has somewhat affected the company’s effectiveness, yet it managed to secure the necessary amount of annual investment funds, be maximally correct with its partners, from whom it secures raw materials, as well as respond to the needs of the time to reflect and increase employee wages. “LUFRA Foods” is a company that is part of a difficult sector, such as the manufacturing sector, hence the value of this company is immeasurable for its impact on stimulating livestock. But with recent maneuvers, adding many other products to its “basket,” both well-known and less known, it is certain that the company will see further growth in its activity.



ALBAN UJKASHEJ

Drejtor i Përgjithshëm i kompanisë "NELT Albania"

Emri i kompanisë: NELT Albania
Xhiro e biznesit 2023: 20.7 milionë euro
Numri i punonjësve: 160
Vendndodhja: Tiranë

ALBAN UJKASHEJ

General Director of "NELT Albania"

Company Name: NELT Albania
Turnover 2023: 20.7 million EUR
No. of employees: 160
Location: Tirana

Biznesi është një organizëm gjigant, aktorët e të cilit përjetojnë realitete dhe dinamika të ndryshme dhe kanë perceptime, gjykime e vizione të ndryshme. Për rrjedhojë marrin edhe veprime të ndryshme. Për shembull, aty ku dikush sheh se ka arritur limitet dhe ka shteruar të gjitha mundësitë e rritjes, dikush tjetër sheh potenciale të mëdha, perspektiva të mira. Për rrjedhojë, i pari quan veprim të arsyeshëm shitjen, i dyti blerjen.

Në një kontekst si ky, një arsyetim dhe një logjikë e tillë është ndjekë në rastin e NELT Albania. Nuk është kompani e krijuar nga fillimi, por përfaqëson një rast shitblerjeje të një kompanie tjetër shqiptare, të themeluar në vitin 2005, e që kishte krijuar një identitet të caktuar në treg si kompani distribucioni dhe tregtimi artikujsh të ndryshëm. Por në vitin 2018, NELT Group e pa të arsyeshme dhe të përshtatshme për planet e saj që ta blente këtë kompani. Nëpërmjet kësaj blerjeje, NELT Group realizoi së pari synimin për shtrirje edhe në një treg si Shqipëria. Ashtu sikurse ka vepruar në të gjitha vendet e Ballkanit, në

A business is like a giant organism, whose actors experience different realities and dynamics, and have varying perceptions, judgments, and visions. Consequently, they take different actions. For instance, where one person sees the limits reached and no further growth opportunities, another sees great potential and promising prospects. As a result, one may find it reasonable to sell, while the other sees it fit to buy.

In a context like this, such reasoning and logic were applied in the case of NELT Albania. It wasn't a company created from scratch, but the result of an acquisition of another Albanian company founded in 2005, which had established a certain identity in the market as a distributor and retailer of various products. However, in 2018, NELT Group deemed it both reasonable and fitting for its plans to purchase this company. Through this acquisition, NELT Group achieved its goal of expanding into a market like Albania, as it had already done in other Balkan countries like Serbia, North Macedonia, Kosovo, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, and pursued expansion into the European and even African



Serbi, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Bosnje e Hercegovinë, Malin e Zi dhe sikurse e ka kërkuar zgjerimin në tregun europian e deri edhe në tregje të kontinentit afrikan. NELT Albania kështu u bë dhe vazhdon të jetë njëra nga 22 kompanitë e Grupit NELT, i cili duhet thënë që është një grup i madh, me rreth 165 mijë metra katror sipërfaqe magazinimi, me mbi 5500 të punësuar, 1400 mjete transporti dhe që vetëm gjatë vitit 2023 ka realizuar 1.3 miliardë euro xhiro biznesi. Ndërkohë që kur është krijuar, në vitin 1992, aktiviteti i kompanisë ka nisur me 2 makina, 4 punonjës dhe me 500 metra katrorë sipërfaqe magazinuese. Kemi të bëjmë pra me një dinamikë impresonuese biznesi të arritur brenda pak më shumë se 30 viteve. Bëhet fjalë për hapa gjigandë të realizuar, që kanë çuar në jetësimin e një realiteti të mrekullueshëm biznesi.

Përveç strategjisë për zgjerimin e tregjeve, NELT Group ka parë ndërkohë tek procesi i përthithjes së kompanisë së dikurshme shqiptare edhe mundësitë e rritjes së saj. Dhe duket se llogaritë i ka bërë mirë, me laps në dorë dhe me realizëm. Gjithçka është vërtetuar me kalimin e viteve. Që nga viti 2018, NELT Albania njih vetëm rritje të aktivitetit, për të mbërritur në vitin 2023, kur shënohet edhe performanca më e mirë e kompanisë ndër vite. Afro 21 milionë euro aktivitet i regjistruar në vitin 2023, përbën rezultatin më të mirë të arritur nga NELT Albania dhe pothuaj dyfishim i tij, krahasuar me performancën e kompanisë vetëm 4 vite më parë.

Ecuria bëhet edhe më pozitive po qe se

markets.

NELT Albania thus became, and continues to be, one of the 22 companies within the NELT Group, which is worth noting as a large entity, with around 165,000 square meters of warehouse space, over 5,500 employees, 1,400 transport vehicles, and a business turnover of 1.3 billion euros in 2023 alone. Yet, when the company was founded in 1992, it started with just two vehicles, four employees, and 500 square meters of warehouse space. This is indeed an impressive business growth dynamic achieved in a little over 30 years. These are giant steps that have led to the realization of an extraordinary business reality.

In addition to its market expansion strategy, NELT Group saw in the acquisition of the former Albanian company an opportunity for its growth. It seems they did the math correctly, calculating everything realistically and carefully. Over the years, this has been proven true. Since 2018, NELT Albania has seen continuous growth in its activities, culminating in 2023, when the company achieved its best performance to date. Nearly 21 million euros in revenue were recorded in 2023, marking the company's best result ever, nearly doubling its performance compared to just four years earlier.

The company's trajectory becomes even more positive when we note that NELT Albania continues to operate as a distribution and sales company for various world-renowned brands. It should be emphasized that competition in this sector is fierce, with many companies engaging in

nënvizojmë faktin se NELT Albania vazhdon të funksionojë si një kompani distribuimi dhe shitjeje të produkteve të ndryshme, të brandeve të mirënjohura në botë. Duhet theksuar se konkurrenca në këtë sektor, kompanitë që kanë të njëjtën natyrë aktiviteti dhe fizionomi të tillë, pra që shpërndajnë dhe tregtojnë produkte të ndryshme në tregun shqiptar, janë të shumta. Ndërkohë, tregu shqiptar është i vogël, i pamjaftueshëm për të kënaqur e plotësuar ambiciet dhe objektivat e çdo kompanie të tillë. Megjithatë, rritja e aktivitetit të NELT Albania nga viti në vit, tregon se ajo e ka gjetë çelësin e duhur për të shtuar praninë e saj në tregun shqiptar nga viti në vit. Konsumatorët shqiptarë po shtojnë gjithnjë e më shumë preferencën e tyre për produkte të tregtuara nga NELT Albania nëpërmjet partnerëve të biznesit si SPAR, BIG MARKET, Eco Market, Extra Market, Alb Market, Xhangolli, ETC, Well. Dhe nuk janë produkte dosido, por artikuj cilësorë, brande të mirënjohura si HELL, JACOBS, NIVEA, Milka, Philadelphia, ARCOR, BBF, MUTTI, TUC, Toblerone, etj. Me kompanitë që i prodhojnë këto produkte, NELT Group ka një histori partneriteti mbi 30 vjeçare, dhe siç është e kuptueshme, vlera e një bashkëpunimi të tillë afatgjatë i shtrin efektet edhe në tregun shqiptar nëpërmjet NELT Albania-s.

Duke analizuar ecurinë e NELT Group ndër vite, duke parë historinë se si e ka nisur

similar activities, distributing and selling various products in the Albanian market. Moreover, the Albanian market is small and insufficient to satisfy the ambitions and objectives of every such company. Nonetheless, NELT Albania's year-on-year growth demonstrates that it has found the right key to increase its market presence annually. Albanian consumers are increasingly favoring products distributed by NELT Albania through its business partners such as SPAR, BIG MARKET, Eco Market, Extra Market, Alb Market, Xhangolli, ETC, and Well. These are not just any products, but high-quality items from well-known brands such as HELL, JACOBS, NIVEA, Milka, Philadelphia, ARCOR, BBF, MUTTI, TUC, Toblerone, and more. NELT Group has a 30-year-long partnership with the companies that produce these brands, and the value of such a long-term collaboration naturally extends its effects into the Albanian market through NELT Albania.

Analyzing NELT Group's progress over the years, observing how its operations began and where they have reached today, and seeing how the vision of its founders, managers, and employees has been rewarded, the future of NELT Albania becomes even clearer. What its exact performance will be in the future remains to be seen, but what can be said with certainty is that each year's performance will be better than the previous one. This is the lesson NELT Albania





aktivitetin dhe ku ka mbërritë deri tani, duke konstatuar mënyrën se si është shpërblyer vizioni i krijuesve, menaxherëve dhe puna e punonjësve të saj, atëherë edhe perspektiva e NELT Albania-s qartësohet më shumë. Se si do të jetë performanca e saj në të ardhmen konkretisht, kjo mbetet të shihet, por ajo që mund të thuhet me siguri është se performanca e çdo viti do të jetë më e mirë sesa ajo e vitit paraardhës. Sepse këtë leksion na ka dhënë Nelt Albania deri tani, këtë pritshmëri na ka stimuluar ajo. Sa më shumë vite të kalojnë, aq më e madhe do të bëhet prania e produkteve të saj në treg, aq më i fortë do të bëhet pozicioni i saj në sektorin ku operon e akoma më shumë do të rritet fuqia konkurruese e saj. Nëse aktualisht Nelt Albania përfaqëson një kompani jo të vogël në biznesin shqiptar, me rreth 3750 metra katrorë sipërfaqe magazinimi, me 105 makina shpërndarjeje dhe me 160 punonjës, e sigurt është se në të ardhmen kompania do të jetë edhe më e madhe se kaq.

has taught us so far, and it's the expectation it has encouraged. The more years that pass, the larger its market presence will become, the stronger its position in the sector in which it operates will grow, and its competitive power will increase even more. If NELT Albania currently represents a significant company in the Albanian business scene, with around 3,750 square meters of warehouse space, 105 distribution vehicles, and 160 employees, it is certain that in the future, the company will be even larger than this.





ERIDAN SKANA

Një rrugëtim i suksesshëm

Emri i kompanisë: "Bourgogne Franche-Comté Signaux"
Xhiro e biznesit 2023: 20 milionë euro
Numri i punonjësve: 70
Vendndodhja: Francë

ERIDAN SKANA

A Journey of Success

Company Name "Bourgogne Franche-Comté Signaux"
Turnover 2023: 20 million EUR
No. of employees: 70
Location: France

Eridan Skana pak kohë më parë ka inauguruar një ambient të ri prej 7000 metrash katrorë pranë Besançon-it për kompaninë e tij "Bourgogne Franche-Comté Signaux", e cila prodhon sinjalistikën rrugore për autoritetet lokale, kompanitë e autostradave (50% e shitjeve) operatorët dhe tregtarët privatë të paneleve.

Në moshën 43-vjeçare, Eridan Skana kryeson një grup lokal të specializuar në sinjalistikën rrugore, me një ekip prej 70 punonjësish të shpërndarë në tri lokacione: "Global Signalization", me bazë në "École-Valentin", "Hicon" në Vesoul dhe "Bourgogne Franche-Comté Signaux", e themeluar së fundmi në një ambient prej 7000 metrash katrorë, në një truall prej 24000 m² në komunën "Chemaudin et Vaux". Kompania e fundit u krijua në vitin 2020, pas blerjes nga Eridan Skana të kompanisë "Franche-Comté Signaux", e vendosur më pas në Rurey për më shumë se 30 vjet dhe e vënë në likuidim të detyrueshëm. Në vetëm tre vjet, sipërmarrësi jo vetëm që do ta kthejë kompaninë në rrugën e duhur, që është rezultat i një strategjie të bazuar veçanërisht në modernizimin e objekteve të prodhimit dhe ripërcaktimin e proceseve të prodhimit, por do të rrisë në mënyrë spektakolare edhe shitjet me dy milionë euro në vit. Kjo e fundit tani arrin në nëntë milionë euro dhe në të ardhmen e afërt pritet të kalojë 15 milionë euro.

Eridan Skana recently inaugurated a new 7,000-square-meter facility near Besançon for his company, "Bourgogne Franche-Comté Signaux," which produces road signage for local authorities, highway companies (50% of sales), and private panel operators and traders.

At the age of 43, Eridan Skana leads a local group specializing in road signage, employing 70 people across three locations: "Global Signalisation" based in "École-Valentin," "Hicon" in Vesoul, and the newly established "Bourgogne Franche-Comté Signaux" in a 7,000-square-meter facility on a 24,000 m² plot in the commune "Chemaudin et Vaux."

This latest company was created in 2020 after Eridan Skana acquired "Franche-Comté Signaux," which had been based in Rurey for more than 30 years and had been placed into compulsory liquidation. In just three years, the entrepreneur not only put the company back on track, thanks to a strategy focused on modernizing production facilities and redefining production processes, but also dramatically increased sales from two million euros annually. Today, sales reach nine million euros, with projections to exceed 15 million euros in the near future.



IVETËM NUK MUND TË BËSH ASGJË

Kjo histori suksesi është arritur kryesisht falë të aftësisë së Eridan Skanës për të planifikuar në mënyrë afatgjatë, për të ndërtuar një vizion, për t'i qëndruar atij dhe për t'ia transmetuar këtë vizion ekipit të tij. “Të vetëm nuk jemi asgjë!» pohon ai.

“Të dish se nga cilët njerëz do të rrethohesh, ky është një nga çelësat e suksesit. Nuk jam njeri i lehtë, jam shumë kërkues. Nuk më kanë pëlqyer kurrë fjalët e bukura, njerëzit që premtojnë gjëra të mëdha dhe në fund nuk i realizojnë. Unë mendoj se vetëm veprimet kanë rëndësi. Të gjithë mund të gabojmë. E kush është ai që nuk ka gabuar asnjëherë? Por duhet të jemi në gjendje t'i korrigjojmë gabimet dhe kjo mund të arrihet vetëm duke pasur në kokë një qëllim të qartë.

“Kjo është ajo që ua mësoj kolegëve, në mënyrë që të jemi të gjithë në sinkron dhe të gjithë të lëvizim në të njëjtën drejtim. Ideja është që ta bëjmë rrugëtimin së bashku. Nuk bëhesh drejtues ndërmarrjeje nisur nga interesa ekonomike, të paktën për mua nuk është kështu. Është një aventurë njerëzore që përbëhet nga rreziqe që duhet të dimë t'i masim. Që një ekip të funksionojë, duhet të jemi të aftë të tregojmë vendosmëri, të japim besim dhe të vlerësojmë çdo njeri. Kështu, unë i vë vetes synimin që të përpiqem dhe të përcaktoj një metodë për ta arritur këtë qëllim. Por nëse dikush më sugjeron një mënyrë më të mirë që mund të sjellë të njëjtin rezultat, unë e pranoj”.

ALONE, YOU CAN'T DO ANYTHING

This success story is largely due to Eridan Skana's ability to plan long-term, to build a vision, to stick to it, and to communicate this vision to his team. “Alone, we are nothing!” he asserts.

“Knowing who to surround yourself with is one of the keys to success. I am not an easy person, I am very demanding. I have never liked empty promises, people who talk big but fail to deliver. I believe that only actions matter. We all make mistakes. Who hasn't? But we must be able to correct our mistakes, and that can only be achieved by having a clear goal in mind.

“This is what I teach my colleagues so that we are all in sync and moving in the same direction. The idea is to make the journey together. You don't become a company leader driven by financial interests; at least, that's not the case for me. It's a human adventure full of risks that must be measured. For a team to function, we must be capable of demonstrating determination, giving trust, and valuing each individual. I set myself the goal of trying and defining a method to achieve that goal. But if someone suggests a better way that can lead to the same result, I accept it.”

Eridan Skana exudes confidence and determination, which have become part of him. This persistence is rooted in his childhood. Born

Eridan Skana rrezatonte një vetëbesim dhe një vullnet që është bërë njësh me të. Kjo këmbëngulje i ka rrënjët në fëmijërinë e tij. I lindur në Shqipëri nga nja baba inxhinier automobilash dhe nga një nënë mësuese, ai u rrit në një mjedis ku vlera e punës nuk ishte fjalë boshe. “I kam parë gjithnjë prindërit duke punuar dhe megjithëse jam rritë në një vend të varfër, në një krahinë të krishterë, nuk kam përjetuar kurrë dhunë dhe nuk i kam parë asnjëherë prindërit të grinden. Pikërisht ky terren i shëndetshëm, ky themel i fortë, më lejoi të nis rrugën drejt suksesit. Nuk ka rrugëtim të përsosur, por kur ke këtë lloj trashëgimie dhe bën një hap përpara, kjo të çon gjithnjë në rrugën e duhur”.

Djaloshi Eridan nuk kishte mbushur ende 20 vjet kur me këtë dëshirë për liri u largua nga Shqipëria për të provuar fatin larg vendit, që një dekadë më parë kishte vuajtur njëherë nga diktaturat më të egra komuniste në Europë. Kishte dëgjuar për Francën, vendin ku nëse punon fort, në fund shpërblehesh. Kështu mbërriti në Besançon dhe u regjistrua në fakultetin e drejtësisë.

Për të paguar studimet, gjeti një punë sezonale në “Franch-Comté Signalaux”, në Rurey, Doubs. Pasi u diplomua në vitin 2002, iu bashkua ekipit të kësaj kompanie të sinjalistikës rrugore si montues. Në pak më shumë se dhjetë vjet, filloi të ngrihej në

in Albania to an automotive engineer father and a teacher mother, he grew up in an environment where the value of hard work was not an empty word. “I always saw my parents working, and although I grew up in a poor country, in a Christian province, I never experienced violence or saw my parents argue. It was this healthy environment, this strong foundation, that allowed me to start my journey toward success. There is no perfect path, but when you have this kind of heritage and take a step forward, it always leads you in the right direction.”

Young Eridan had not yet turned 20 when, with this desire for freedom, he left Albania to try his luck far from a country that a decade earlier had endured one of Europe’s harshest communist dictatorships. He had heard of France, a country where if you work hard, you eventually get rewarded. So, he arrived in Besançon and enrolled in law school.

To pay for his studies, he found seasonal work at “Franch-Comté Signalaux” in Rurey, Doubs. After graduating in 2002, he joined the team of this road signage company as an assembler. In just over ten years, he climbed the ranks, trying all positions until he became the company’s director.





detyrë dhe i provoi të gjitha pozicionet, derisa u bë drejtor i kompanisë.

Në vitin 2014, duke mos ndarë më vizionin e menaxherit, vendosi të krijojë kompaninë e tij, “Global Signalisation”, të cilën e themeloi në École-Valentin, pranë Besançon-it. Ishte një sukses i menjëhershëm (më se tre milionë euro shitje), gjë që i mundësoi Eridan Skanës të blinte, në vitin 2018, konkurrentin e atëhershëm “Hicon”.

Po atë vit, Quentin Bourgeois, kontabilist i kompanisë, u bë krahu i djathtë i Eridan Skanës, i cili më pas i besoi drejtimin e kësaj blerjeje të re. Pas dy vjetësh, sipërmarrësi mëson se kompania, që i kishte dhënë një shans kur mbërriti në Francë, ishte në likuidim gjyqësor. “Propozimi i një oferte blerjeje ishte i qartë për mua, por përfaqësonte njëkohësisht një sfidë të vërtetë”.

«JAM I BINDUR QË VETËM PUNA TË SHPËRBLËN»

“Eridani më pyeti nëse doja të provoja. Reagova menjëherë pozitivisht. Atëherë më tha që të mendohesha dhe ta diskutoja me familjen, sepse përmasat e sfidës kësaj here ishin të ndryshme. Të nesërmen përgjigjja ime ishte përsëri po, duke qenë se isha i bindur se me Eridanin çdo gjë ishte e mundshme”, thotë Quentin Bourgeois, sot përgjegjës finance dhe prodhimi në “Bourgogne Franche-Comté Signalaux”.

Oferta lokale e të dyve nuk u pranua nga gjykata tregtare, e cila preferoi atë të një grupi të madh nga Franca veriore. “Një blerës i cili, ndryshe nga ne, nuk kishte asnjë interes real industrial për këtë vend

In 2014, no longer sharing the vision of the management, he decided to create his own company, “Global Signalisation,” which he founded in École-Valentin, near Besançon. It was an immediate success (with more than three million euros in sales), allowing Eridan Skana to acquire his then competitor “Hicon” in 2018.

That same year, Quentin Bourgeois, the company’s accountant, became Eridan Skana’s right-hand man, who then entrusted him with the management of this new acquisition. Two years later, the entrepreneur learned that the company that had given him a chance when he first arrived in France was in judicial liquidation. “The decision to make a purchase offer was clear to me, but it also represented a real challenge.”

“I’M CONVINCED THAT ONLY HARD WORK PAYS OFF.”

“Eridan asked me if I wanted to try. I immediately responded positively. He then told me to think it over and discuss it with my family because the scale of the challenge this time was different. The next day, my answer was still yes, as I was convinced that with Eridan, anything was possible,” says Quentin Bourgeois, now responsible for finance and production at “Bourgogne Franche-Comté Signalaux.”

The duo’s local offer was not accepted by the commercial court, which preferred that of a large group from northern France. “A buyer who, unlike us, had no real industrial interest in this site and had no intention of maintaining

DATA TË RËNDËSISHME

- 1980** U lind, më 18 tetor në Mirditë, Shqipëri.
- 2000** Mbërrin në Francë.
- 2002** Punësohet në Franche-Comté Signaux, në Rurey, në Doubs.
- 2014** Krijon kompaninë e tij "Global Signalisation" në École-Valentin.
- 2018** Blen "Hicon"-in në Vesoul.
- 2020** Blen "Franche-Comté Signals", të cilën e quan "Bourgogne Franche-Comté Signaux".
- 2023** Transferon kompaninë "Bourgogne Franche-Comté Signaux" në "Chemaudin et Vaux", në një ndërtesë prej 7000 metrash katrorë, pranë hyrjes së autostradës A36.

IMPORTANT DATES

- 1980** Born on October 18 in Mirdita, Albania.
- 2000** Arrives in France.
- 2002** Hired at "Franche-Comté Signaux," in Rurey, Doubs.
- 2014** Creates his company "Global Signalisation" in École-Valentin.
- 2018** Acquires "Hicon" in Vesoul.
- 2020** Acquires "Franche-Comté Signals," which he renames "Bourgogne Franche-Comté Signaux".
- 2023** Transfers "Bourgogne Franche-Comté Signaux" to "Chemaudin et Vaux," into a 7,000-square-meter building near the entrance to the A36 highway.

dhe që nuk kishte ndër mend të ruante punësimin".

Në vend që të hiqte dorë nga çështja, dyshja vijoi duke kërkuar mbështetjen e prokurorisë së Besançonit, e cila e apeloj vendimin. Katër muaj më vonë, Gjykata e Apelit e Besançonit hodhi poshtë "Nord Signalisation", në favor të Eridan Skanës. Ky i fundit më pas nisi rithemelimin e kësaj kompanie, të cilën e quajti "Bourgogne Franche-Comté Signaux". "Mjetet e prodhimit ishin vjetruar, m'u desh të investoja dy milionë euro në makineri për të rritur produktivitetin dhe përgjegjshmërinë e kompanisë, përpara se të hidhja një hap të ri dhe të transferoja ambientet në komunën "Chemaudin et Vaux", që ndodhej në hyrje të një autostrade.

NJË ETAPË E RE

E ndërtuar në zonën industriale "Echange", ndërtesa e re ka 1500 panele fotovoltaike (që mbulojnë pothuajse 90% të çatisë, ndërkohë që kuadri ligjor kërkon vetëm 30%), duke e bërë ndërtesën 100% të pavarur në energji. "Ne gjenerojmë pothuajse dyfishin e nevojave tona për energji elektrike dhe mund t'ia shesim tepriçen EDF-së", shpjegon Quentin Bourgeois.

"Këto ambiente i projektua në funksion të tre aktiviteteve tona: prodhimit të sinjalistikës rrugore, dorezave dhe shtyllave të larta (PPHM), të cilat ne jemi të vetmit që i ofrojmë, si prej alumini

employment."

Instead of giving up, the duo continued by seeking the support of the Besançon prosecutor's office, which appealed the decision. Four months later, the Besançon Court of Appeal ruled against "Nord Signalisation," in favor of Eridan Skana. He then began the revitalization of the company, which he named "Bourgogne Franche-Comté Signaux." "The production equipment was outdated, so I had to invest two million euros in machinery to increase productivity and the company's responsiveness before taking the next step and transferring the facilities to the commune 'Chemaudin et Vaux,' located at the entrance to a highway."

A NEW STAGE

Built in the "Echange" industrial zone, the new building has 1,500 photovoltaic panels (covering almost 90% of the roof, while the legal requirement is only 30%), making the building 100% energy-independent. "We generate almost twice our energy needs and can sell the excess to EDF," explains Quentin Bourgeois.

"We designed these facilities for our three activities: road signage production, high pole manufacturing (PPHM), which we are the only ones to offer, both in aluminum and steel, and

ashtu edhe prej çeliku, dhe planifikimit urban. Në seksionin e sinjalistikës bëmë ridizajnim, me qëllim që të mos kthehemi më. Investuam në një prerës lazer që na lejon të punojmë tre telajo alumini në të njëjtën kohë. Pra, sot në tri orë prerje ne konsumojmë dy tonë material, ndërsa më parë duhej një javë punë për të njëjtin vëllim. Njëkohësisht, jemi pajisur me një makineri, e cila përveç kursimit të kohës dhe materialeve, ofron mundësinë e zhvillimit të një game të re produktesh. Kemi krijuar edhe një godinë dedikuar lysterjes, të cilën dëshirojmë ta japim me qira për kompanitë vendase, me 30% destinacion të brendshëm dhe 70% të jashtëm”.

“Këto investime, në shumën prej 12 milionë eurosh, na lejojnë të fitojmë në korrektësi ndaj klientëve (ne mund të prodhojmë një panel për klientët tanë në vetëm gjysëm ore), në cilësi (në Francë jemi vetëm dy që pretendojmë një nivel të tillë cilësie me standardin e dyfishtë CE dhe NF), të rrisim normat e prodhimit, të reduktojmë punën e mundimshme, të bashkërendojmë veprimtarinë me kompani të ndryshme simotra, të rrisim besueshmërinë e makinerive (për shembull, investim në një stol saldimit gjysmautomatik dixhital që garanton zgjidhjen e problemeve në më pak se 24 orë), të reduktojmë gjurmën ekologjike, etj. Kjo është receta që një biznes të funksionojë sot”, përfundon Eridan Skana.

urban planning. In the signage section, we redesigned it so we won't have to go back. We invested in a laser cutter that allows us to work on three aluminum canvases at the same time. Today, in three hours of cutting, we consume two tons of material, whereas previously it took a week to work the same volume. At the same time, we equipped ourselves with a machine that, besides saving time and materials, offers the possibility of developing a new range of products. We also created a building dedicated to painting, which we wish to rent out to local companies, with 30% internal and 70% external destination.”

“These investments, totaling 12 million euros, allow us to improve our accuracy with clients (we can produce a panel for our customers in just half an hour), quality (in France, we are only two who claim such a level of quality with the double standard CE and NF), increase production rates, reduce strenuous work, coordinate activities with various sister companies, increase machine reliability (for example, investment in a semi-automatic digital welding bench that guarantees problem-solving in less than 24 hours), reduce the ecological footprint, etc. This is the recipe for making a business work today,” concludes Eridan Skana.





ETLEVA LARO

*Administratore e kompanive
"EFA Solution" dhe "ProDyn"*

Emri i kompanisë: EFA Solution dhe ProDyn
Khiri e biznesit 2023: 18 milionë euro
Numri i punonjësve: 900
Vendndodhja: Tiranë

ETLEVA LARO

*Administrator of "EFA Solution"
and "ProDyn" Companies*

Company names: EFA Solution and ProDyn
Turnover 2023: 18 million EUR
No. of employees: 900
Location: Tirana

Vështirësitë me të cilat janë ndeshur eksportuesit shqiptarë kohët e fundit janë bërë të njohura për të gjithë. Arsyeja kryesore ka të bëjë me kursin e këmbimit, ose më saktë me zhvlerësimin e euros kundrejt lekut shqiptar. Duke i pasur të ardhurat në euro, ndërkohë që shumicën e shpenzimeve i kanë në lekë, kuptohet pra që luhatja e "humorit" të euros krijon situata problematike për të gjithë ata biznesmenë që produktet i destinjnë për eksport. Të shumta kanë qenë ankesat e eksportuesve shqiptarë në drejtim të qeverisë, por prej saj kanë marrë rekomandimin për përshtatje të aktivitetit në kushtet e reja të krjuara. Duket pra se ato lloj industrish që deri tani kanë funksionuar relativisht mirë, sikurse është industria e prodhimit të këpucëve me porosi nga të tretët ose të prodhimit të tekstileve, ndodhen tashmë përpara domosdoshmërisë së përshtatjes së aktiviteve.

Në këtë kontekst, nuk kishte si të bënin përjashtim as kompanitë e Etleva Laros. Pra EFA Solution dhe ProDyn. Sigurisht, zhvlerësimi i euros në raport me lekun vendas ua ka prishur

The recent difficulties faced by Albanian exporters have become widely recognized. The primary reason pertains to the exchange rate, specifically the depreciation of the euro against the Albanian lek. With revenues in euros and most expenses in lek, the fluctuation of the euro creates problematic situations for businesspeople who export their products. Numerous complaints have been directed at the government by Albanian exporters, but the response has been a recommendation to adapt their activities to the new conditions. Consequently, industries that have functioned relatively well so far, such as the custom shoe production and textile manufacturing industries, are now faced with the necessity of adapting their activities.

In this context, Etleva Laro's companies, EFA Solution and ProDyn, are no exception. The depreciation of the euro relative to the local currency has impacted these companies' financial results and activity volumes. Both indicators have been below what they showed the previous year, but for objective reasons.



disi terezinë këtyre dy kompanive sa i takon rezultatit final financiar, pra, treguesit të fitimit, por edhe sa i takon volumit të aktivitetit të realizuar prej tyre. Të dy këta tregues kanë qenë poshtë asaj që treguan gjatë një viti paraardhës, por sikurse thamë për arsye objektive. Por domethënëse në ecuri të këtyre dy kompanive të Etleva Laros është fakti se ato edhe për vitin 2023 e ruajtën rëndësinë e tyre në kuadrin e ekonomisë kombëtare. Pra, të dyja kompanitë ruajtën numrin e fuqisë punëtore si dhe kontributin fiskal të buxhetin e shtetit.

Përpara Etleva Laros, si krijuese dhe administratore e dy kompanive të mirënjohura, shpaloset tashmë një sfidë e re – ajo e përshtatjes së aktivitetit në kushtet e reja të krijuara, që e kanë bërë të vështirë këtë aktivitet. Si një identifikuese e saktë e problematikës me të cilën ndeshet industria ku bën pjesë, si dhe me aftësinë për t’i gjetë zgjidhjet përkatëse për të kaluar në një stad të ri, Etleva Laro ka filluar nga puna, duke kërkuar që numrit të klientëve kryesorë t’i shtojë edhe një sërë klientësh të rinj që i përkasin segmentëve me çmime më të larta sesa ato që ka aktualisht. Kjo është e vetmja mënyrë për vazhdimin e punës, duke përballuar kostot përkatëse. Pra, krahas klientëve sistematikë të saj si Clark’s, Josef Seibel, Waldlaufer (lugina), Peter Kaiser, Kennel&Schmenger të sigurojë edhe klientë të rinj. Me Clark’s që është edhe

However, significant to the progress of Etleva Laro’s companies is the fact that they maintained their importance within the national economy in 2023. Both companies preserved their workforce numbers and their fiscal contributions to the state budget.

As the founder and administrator of two well-known companies, Etleva Laro now faces a new challenge—adapting activities to the new conditions, which have made this activity difficult. As an accurate identifier of the problems facing her industry and with the ability to find appropriate solutions to progress to a new stage, Etleva Laro has begun working to add new high-priced clients to her existing key clientele. This is the only way to continue operations and manage the associated costs. Thus, in addition to her regular clients like Clark’s, Josef Seibel, Waldlaufer, Peter Kaiser, and Kennel & Schmenger, she aims to secure new clients. A long-term cooperation contract has been signed with Clark’s, one of the main clients. ProDyn also collaborates with well-known partners such as Puma and Alexander McQueen. Everyone knows who Puma is—founded in 1948, it achieved a turnover of 8.5 billion euros in 2022, with over 18,000 employees and a profit of 358 million euros. Thus, ProDyn and EFA Solution continue to concretize their company philosophy, which involves not only

një nga klientët kryesorë, është nënshkruar një kontratë afatgjatë bashkëpunimi. Por Prodyn bashkëpunon edhe me partnerë të tillë të njohur, si Puma ose Aleksandre McQueen. Se kush është Puma e dijnë të gjithë. Mjafton të kujtojmë që është themeluar në vitin 1948 dhe që gjatë vitit 2022 realizoi një qarkullim prej 8.5 miliardë eurosh, me mbi 18 mijë të punësuar e me fitim prej 358 milionë eurosh. Kështu, Prodyn dhe EFA Solution hedhin hapa të mëtejme të konkretizimit të filozofisë së drejtimit të kompanisë që konsiston jo vetëm në rritjen e numrit të partnerëve, por edhe në ngritjen e stadit të bashkëpunimit, duke bërë pjesë të veprimtarisë edhe produkte të shtrenjta.

Nga ana tjetër, Etleva Laro ka gjykuar se kompanitë e saj kanë të nevojshme të kontraktojnë volume shtesë pune, për të arritur shfrytëzimin optimal të kapaciteteve që kanë kompanitë e saj. Pra nuk kemi të bëjmë me një biznesmene të dekurajuar nga rrethanat e reja e disi të pafavorshme, të krijuara për biznesin e saj, por edhe kompanitë e tjera të kësaj natyre. Përkundrazi. Kemi të bëjmë me një luftëtare të vendosur, për të mos hequr dorë nga suksesi, ashtu sikurse ka qenë deri më tani. Me pasë periodha të vështira në biznes është normale, me i tejkalu ato flet për karakterin e fortë të atij ose asaj që e bën të mundshme këtë.

A është e mundshme të realizohet strategjia që ka përcaktuar Etleva Laro për forcimin e



increasing the number of partners but also elevating the level of cooperation to include high-end products.

Additionally, Etleva Laro has determined that her companies need to contract additional work volumes to optimize their capacities. Thus, we are not dealing with a businesswoman discouraged by the new and somewhat unfavorable circumstances created for her business and other similar companies. On the contrary, she is a determined fighter who does not give up on success, as she has demonstrated so far. It is normal to experience difficult periods in business; overcoming them speaks to the strong character of the person who makes it possible.

Is it possible to realize the strategy that Etleva Laro has defined for further strengthening





mëtejme të perspektivës së kompanive të saj? Kjo s'ka as më të voglin dyshim. Sepse duke vepruar si deri tani, duke pasë si tipare kryesore të kompanive të saj cilësinë dhe korrektësinë, ajo ka fituar besimin e palëkundshëm të partnerëve të saj që përmendëm më lart. Dhe jo partnerë dosido, por kompani të mirënjohura në rang europian e botëror. Dhe përderisa ajo ka qenë në gjendje të meritojë statusin e partneres së këtyre kompanive, kjo do të thotë se edhe me klientë të rinj ajo do të mund ta ketë këtë rezultat. Kuptohet që objektivat e Eva Laros nuk janë sigurimi i mbijetesës së kompanive të saj, por shndërrimi i tyre në kompanitë më të mira të industrisë ku bën pjesë dhe realizimi i këtij objektiwi është thjesht çështje kohe.

her companies' prospects? There is no doubt. By continuing to operate as she has until now, with the main characteristics of her companies being quality and reliability, she has gained the unwavering trust of the partners mentioned earlier. These are not just any partners but well-known companies on a European and global scale. Since she has earned the status of partner with these companies, it means she can achieve similar results with new clients. It is understood that Etleva Laro's objectives are not merely to ensure the survival of her companies but to transform them into the best in their industry. Achieving this objective is simply a matter of time.





ASLLAN BARAJ

Drejtor i Përgjithshëm i Kombinatit të Qeramikës, "KID-ALB"

Xhiro e biznesit 2023: 17 milionë euro
Ndryshimi në % 23/22: +40
Numri i punonjësve: 115
Vendndodhja: Maminas, Durrës

ASLLAN BARAJ

General Director of the Ceramic Combine, "KID-ALB"

Turnover 2023: 17 million EUR
Difference in % 23/22: +40
No. of employees: 115
Location: Maminas, Durres

Tek rasti i kompanisë "KID-ALB" gjendet shembulli më i mirë se si mund të lindë një biznes, si mund të menaxhohet dhe si mundet të krijohet suksesi i madh dhe i qëndrueshëm. Një leksion i vërtetë. Një përvojë e shkëlqyer dhe një histori brilante suksesi. Që nga mënyra e lindjes së tij. Sepse "KID-ALB" lindi si nevojë për vazhdimin e konkretizimit të pasionit që Asllan Baraj kishte për industrinë e qeramikës. Përvoja e gjatë e punës në këtë industri, si dhe skrupuloziteti i përhershëm në punë ishin "pasaporta" më e mirë, ishin dy garantuesit që një sipërmarrje e tillë, sikurse ishte ngritja e një fabrike të prodhimit të tullave do të kishte sukses.

Realiteti në atë kohë nuk ishte shumë bujar për stimulimin e nismave të tjera në këtë industri, pasi ekzistonin kompani të shumta. Ishin kompani që kshin pozicione të mira në treg, sikurse ishte fabrika e Lushnjes, e privatizuar nga italianët, fabrika e Tiranës, edhe kjo pronë e italianëve, dhe kishte fabrika të tilla në Lezhë, Fushë-Krujë, Korçë, Elbasan e në vende të tjera.

Mirëpo plani dhe vizioni për të mbërritur

The story of "KID-ALB" stands as a prime example of how a business can emerge, be managed, and achieve significant and sustainable success. It's a true lesson, an excellent experience, and a brilliant success story from its very inception. "KID-ALB" was born out of Asllan Baraj's passion for the ceramics industry, driven by his extensive experience and unwavering dedication to the field. These qualities were the best passports for such an enterprise, ensuring that a factory producing ceramic tiles would thrive.

At the time of its establishment, the reality wasn't very conducive to fostering new initiatives in this industry, given the presence of several well-established companies like the privatized Lushnja factory under Italians, the Tirana factory also owned by Italians, and others in Lezhë, Fushë-Krujë, Korçë, Elbasan, and beyond.

Nevertheless, the plan and vision for achieving success were clear in Asllan Baraj's mind. Utilizing new and contemporary technology to produce unquestionably high-quality products and managing costs to establish the right quality-



tek sukcesi ishte i qartë në kokën e Asllan Barajt. Teknologji e re dhe bashkëkohore që do të prodhonte produkt cilësor të padiskutueshëm, menaxhim i kostove me qëllim që të krijohet raporti i duhur cilësi-çmim. Ecuria e kompanisë ishte më shumë se e habitshme. Ajo arriti të ndërtonte reputacionin dhe besimin e palëkundshëm të klientit, zuri hapësirën e saj të konsiderueshme në treg dhe e konsolidoi atë vit pas viti. Por ajo çka e konfirmon edhe më shumë suksesin e kompanisë është se ajo arriti të likuadojë para afatit kredinë e marrë me qëllim ndërtimin e fabrikës, bashkë me interesat e saj.

Më pas, sikurse ka ndodhur shpesh në biznesin shqiptar, i erdhi radha ndarjes së partnerëve dhe Asllan Barajt iu desh të blinte kuotat e aksioneve nga partneri i tij. Për t'u bërë më pas pronar i 100 për qind të aksioneve. Të qenit pronar i vetëm i kompanisë i shtoi “shpejtësinë e lëvizjes” Asllan Barajt në menaxhimin dhe zgjerimin e biznesit. Sepse fill pas kësaj, duke qenë se vizionin për një kombinat qeramike nuk e kishte përmbushur plotësisht, iu përvesh punës për të ndërtuar edhe një fabrikë tjetër: atë të tullave dekorative.

Për investimin e saj, kompanisë së “vjetër” iu desh të merrte një kredi të re prej 5 milionë eurosh dhe tashmë fabrika e re është realitet. Por edhe pse ajo nuk ka filluar akoma nga puna, për arsye strategjike të kompanisë, kredia e marrë në sistemin bankar në emër të saj është likuiduar e tëra nga simotra e saj. Dhe kjo është bërë e mundur vetëm në sajë të ecurisë së shkëlqyer të kompanisë, e cila çdo

price ratio were pivotal strategies. The company's growth was remarkable. It built a reputation and unwavering customer trust, securing a significant market share and consolidating it year after year. What further confirms the company's success is its ability to settle its factory construction loan well ahead of schedule, including the interest.

Subsequently, as often happens in Albanian business, partnership divisions arose, leading Asllan Baraj to buy out his partner's shares, becoming the sole owner of 100% of the company's shares. This move accelerated Asllan Baraj's decision-making and business expansion. Shortly thereafter, driven by his unfulfilled vision for a ceramic combine, he dedicated himself to building another factory—a decorative tile plant.

For this new investment, the company had to secure a new loan of 5 million euros. Today, the new factory is a reality. Despite not yet being operational for strategic reasons, the company promptly repaid the entire loan and its interest thanks to its excellent financial performance, which records its outstanding achievements year after year. Each year sets envy-inducing benchmarks



vit regjistron performanca të shkëlqyeshme. Çdo vit shënon tregues për t'u pasë zili. Çdo vit përjeton realitetet e mrekullueshme, që i krijojnë mundësinë të jetë model në të gjitha aspektet.

Gjatë vitit 2023 “KID-ALB” regjistroi një aktivitet në nivelin e 17 milionë eurove, ndërkohë që në vitin paraardhës ai ishte 13 milionë euro. Në vitin 2023 kompania regjistroi një fitim fiskal prej 767 milionë lekësh, ndërkohë që një vit më parë ai ishte 550 milionë lekë. Në vitin 2023 kompania realizoi rreth 1.5 milionë euro investime të reja, kryesisht në mirëmbajtjen e teknologjisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të filtrimit, çka e e kthen atë në njërën nga fabrikat e tullave më miqësore me ambientin.

Sektori i ndërtimit në Shqipëri, sidomos në Tiranë, i është kthyer kohëve më të mira të tij. Kjo do të thotë një rritje e madhe për kërkesën për lëndë të para si tulla. Por KID-ALB ka vijuar me strategjinë dhe me politikën e gërshetimit të tregut të brendshëm me eksportin. Duke qenë se kjo kompani është e fokusuar dhe ka dëshmuar prej vitesh aftësi konkurruese në tregjet rajonale, ajo nuk e ka lënë pas dore eksportin, pavarësisht konjunkturës së favorshme në tregun e brendshëm. Sepse historia i ka mësuar kësaj kompanie leksionin se pikërisht eksporti ka qenë “varka” e shpëtimit të saj, atëherë kur sektori i ndërtimit në Shqipëri u bllokua nga mosdhënia e lejeve të ndërtimit për disa vjet.

Jo vetëm kaq, por edhe vetë fabrikat, si ajo e prodhimit të tullës masive, e ajo e tullave dekorative, janë konceptuar e ndërtuar me një kapacitet të tillë që një pjesë të produktit ta prodhojnë e ta destinojnë për eksport. Ndaj, nga ambientet e kësaj kompanie, çdo ditë dalin dhjetra e dhjetra kamionë të ardhur nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi e deri në Itali dhe kjo ndodh sepse ndërtuesit nga këto vende janë tashmë të bindur për cilësinë e “tullës së Maminasit”. Pavarësisht se gjatë vitit 2023 eksporti i kompanisë zuri rreth 30 për qind të totalit të aktivitetit, që për hir të së vërtetës duhet thënë se nuk është raporti më i mirë, pasi në vitet e mëparshme kompania ka mundur të ketë



and experiences remarkable realities, making it a role model in all aspects.

In 2023, “KID-ALB” recorded a turnover of 17 million euros, up from 13 million euros the previous year. The company achieved a fiscal profit of 767 million lekë, compared to 550 million lekë a year earlier. Additionally, it invested approximately 1.5 million euros in new technologies and further improvements to its filtration system, making it one of the most environmentally friendly tile factories.

The construction sector in Albania, especially in Tirana, is experiencing its golden age, leading to increased demand for primary materials such as tiles. However, “KID-ALB” continues its strategy of balancing domestic market focus with exports. Known for its competitive edge in regional markets, the company maintains its export orientation despite favorable domestic market conditions. History has taught this company that exports were its lifeline during years when the Albanian construction sector faced setbacks due to permit issues.

Moreover, the factory itself, both the mass production and decorative tile plants, were designed and built with capacity to allocate a portion of their products for export. Hence, trucks leave the company’s premises daily, bound for Kosovo, North Macedonia, Montenegro, and even Italy, as builders in these countries trust the quality of “Maminasit tiles.” Although exports

edhe 40 për qind të aktivitetit të saj në eksport. Megjithatë duke ditur që kushtet për eksport janë përkeqësuar si rrjedhojë e zhvlerësimit të euros, ulja e peshës në eksport duket e justifikuar.

Shumë kompani e biznese përjetojnë problematika me sigurimin e fuqisë punëtore. Vetë biznesi shqiptar ka qenë sistematikisht problematik me trajtimin, kryesisht financiar, të punonjësve të vet. Por “KID-ALB” nuk ka probleme të tilla. Dhe s’ka pse të ketë, pasi punonjësit i ka konsideruar gjithmonë si pjesë e rëndësishme të kompanisë, si pjesë të familjes, duke i trajtuar financiarisht ashtu siç duhet. Mjafton të kujtojmë se gjatë vitit 2023 paga mesatare bruto e 115 punonjësve ishte 120 mijë lekë në muaj, nivel ky që është thujse dyfishi i pagës mesatare bruto të biznesit shqiptar. E pra, në të tilla kushte nuk ka se si suksesi të mos jetë i pranishëm.

Koha ecën për çdokënd, e prandaj edhe për Asllan Barajn. Por ai akoma nuk ka rënë në rutinën e menaxhimit të asaj që ka arritur të ndërtojë. Projekte të tjera ka ndërtuar në kokën e tij, për të cilat ka filluar të punojë për konkretizim. Kur e filloi fabrikën e tullave, sipërfaqja e fabrikës ishte 2.5 hektarë. Tani ajo ka arritur në 10 hektarë. Një agrofermë moderne me të gjitha perimet dhe frutat e mundshme ka filluar të marrë formë, aty, ngjitur me fabrikën, produktet e të cilës do konsumohen nga vetë anëtarët e familjes 115 vetëshe “KID-ALB”. Por edhe pas mbarimit të këtij projekti nuk mund të thuash me siguri që Asllan Baraj do të bjerë në qetësi. I mësuar me punë sistematike, i provokuar në mënyrë të vazhdueshme drejt përmirësimit dhe perfeksionit, ai do të projektojë të tjera plane e të tjera punë. Për të qenë gjithmonë ashtu sikurse ka qenë deri më tani – një personalitet i suksesshëm absolut i biznesit shqiptar.



accounted for about 30% of total activity in 2023, down from previous years where it reached 40%, this adjustment reflects justified considerations amid the euro depreciation.

While many businesses in Albania struggle with workforce challenges, “KID-ALB” stands out for its systematic approach to treating employees, viewing them as integral to the company’s success and family. In 2023, the average gross salary for 115 employees was 120,000 lekë per month, nearly double the Albanian business average. Thus, under such conditions, success is inevitable.

Time moves forward for everyone, including Asllan Baraj. Yet, he remains vigilant in managing and expanding what he has built. He has other projects in mind, such as the modern agrofarm adjacent to the factory, where produce will be consumed by the “KID-ALB” family members. Even after completing this project, Asllan Baraj shows no signs of slowing down. Accustomed to systematic work, continuously driven toward improvement and perfection, he will design more plans and projects to maintain his status as an absolute success in Albanian business.



GJERGJ LUCA

President i kompanisë "ROZAFI"

Emri i kompanisë: "ROZAFI"
Xhiro e biznesit 2023: 16.5 milionë euro
Numri i punonjësve: 666
Vendndodhja: Elbasan

GJERGJ LUCA

President of the company "ROZAFI"

Company Name: "ROZAFI"
Turnover 2023: 16.5 million EUR
No. of employees: 666
Location: Elbasan

Gjergj Luca është sipërmarrës unik, i ndryshëm nga pothuajse e gjithë klasa e biznesmenëve shqiptarë. Ai ka dëshirë të flasë, të kritikojë, të predikojë, të përçojë mesazhe. Pra ka dëshirën për të qenë me ndikim në jetën publike me veprimtarinë e tij publike. Një sjellje e tillë nuk është ajo e një njeriu të vetëkënaqur, i cili, pasi ka shkruar kapituj të rëndësishëm suksesi me veprimtarinë e tij kryesore si biznesmen, ka vendosë ta shijojë e përjetojë këtë sukses në këtë mënyrë. Pra me protagonizëm publik. Kjo mënyrë të vepruari e të jetuari e të përjetuari nga ana e Gjergj Lucës është më se normale, është thjesht e zakonshme për të. Sepse Luca, sikurse e thërrasin pothuaj të gjithë, është një njeri me një raport të shkëlqyer me të vërtetën, një person inteligjent që di se si mund të ecë përpara shoqëria e Shqipëria. Është një person spektakolar. Ndaj nuk ngurron të "bërtasë", të "ulurasë" e të tregojë konkretisht se si e ka fituar këtë të drejtë sepse, si shumë persona të tjerë ka ditur të ndërtojë një kompani tejet të suksesshme, Rozafa-n.

Një kompani të vlefshme jo vetëm për të,

Gjergj Luca is a unique entrepreneur, distinct from almost the entire class of Albanian businessmen. He enjoys speaking, criticizing, preaching, and conveying messages. He desires to have an impact on public life through his public activities. This behavior is not that of a complacent man who, after having written important chapters of success with his main activity as a businessman, has decided to enjoy and experience this success through public protagonism. This way of acting, living, and experiencing is entirely normal for Gjergj Luca. It's simply common for him. Because Luca, as almost everyone calls him, is a man with an excellent relationship with the truth, an intelligent person who knows how society and Albania can move forward. He is a spectacular person. Thus, he doesn't hesitate to "shout," "yell," and demonstrate concretely how he earned this right, because, like many others, he knew how to build an extremely successful company, Rozafa.

A company valuable not only to him but one that represents, in its entirety, a national asset. A company that has made a significant contribution



por një kompani që përfaqëson në tërësinë e saj një pasuri kombëtare. Kompani, e cila ka një kontribut të madh në fuqizimin e ekonomisë detare në Shqipëri, duke grumbulluar, tregtuar e përpunuar peshk. Duke zënë me punë 666 punëtorë të zonave të Elbasanit e Maliqit. Duke qenë kompani aktive në eksport. Duke shndërruar zona të vdekura me ngrehina të amortizuara si ato të Labinotit apo Maliqit në oaza të shkëlqyera, ku punohet, jetohet e argëtohet. Por si pak të tjerë ose aspak të tjerë, Gjergj Luca nuk ka si qëllim final lekët që të kushtëzojë edhe sjelljen e vet në funksion të tyre. Pra nuk i ka përshtatur interesave të tij si biznesmen, sjelljen e tij si njeri i lirë, duke u mjaftuar me ecurinë e suksesshme të

to strengthening the maritime economy in Albania, by collecting, trading, and processing fish. Employing 666 workers from the areas of Elbasan and Maliq. Being active in exports. Transforming dead zones with dilapidated buildings like those in Labinot or Maliq into excellent oases where people work, live, and enjoy themselves. But unlike others, or perhaps no one else, Gjergj Luca does not have money as the final goal to condition even his behavior in their function. He hasn't adapted his behavior as a free man to his interests as a businessman, content with the successful progress of his business and remaining passive.

On the contrary, he wants to contribute to society not only as a businessman but also as a person who knows how to move forward, how





sipërmarrjes e duke ndejtur pasiv.

Përkundrazi. Ai dëshiron të japë kontributin e tij kundrejt shoqërisë, përveçse si biznesmen, edhe si një njeri që di se si ecet përpara, se si krijohet sukcesi. Ai ka një pikë të dobët, ndryshe nga biznesmenët e tjerë, që vetërrethohen me një heshtje misterioze dhe kërcënuese në të bërit të gjërave. Ai nuk mund të heshtë. Ai flet, ndoshta më hapur se ç'na pëlqen, thotë disa të vërteta, për të cilat nuk jemi gati t'i dëgjojmë, zemërohet për shqetësimet që pajtueshmëria jonë i asgjësoi me zakonshmëri. Ai i jep zë shpirtit të vet që trazohet keq nga gjërat e këqija. Flet sinqerisht dhe shpesh tregohet aq transparent, sa të na ballafaqojë me ujditë dhe kompromiset që bëjmë me të patoluerushmen, me fajet tona, të cilat kurrsesi nuk janë problem dhe aq më pak shqetësim për të, por si qytetar syhapur i këtij vendi, flet, bërtet, tensionohet, shpesh e tepron, por ama ai i thotë gjërat troç, i bindur se pak janë ata, të cilëve kjo u shkon sipas oreksit.

Në fund të fundit ai është ai, Gjergj Luca, njeriu që merr energji nga densiteti i veprimtarisë së përditshme, është ai që nuk mund ta parashikosh, është një potencial njerëzor që arrin të vërë në lëvizje një superstrukturë të përbindshme të veprimtarisë ekonomike shqiptare, siç është "Rozafa". Ai mund të jetë gjithkund dhe gjithkush në gjithçka dhe në çdo gjë që prania e tij sfidueshëm kërkon të jetë. Është i njerëzishëm në totalin e sjelljeve të veta, madje edhe kur shpërthen në urtësi të dliërë dhe në "çmenduri" të skajshme. Përgjithësisht paragjykohet dhe keqkuptohet, sikundër ai kurrë

success is created. He has a weak spot, unlike other businessmen who surround themselves with a mysterious and threatening silence in getting things done. He cannot remain silent. He speaks, perhaps more openly than we like, stating some truths we aren't ready to hear, getting angry at the concerns that our compliance has normalized. He gives voice to his soul, which is deeply disturbed by bad things. He speaks sincerely and is often so transparent that he confronts us with the deals and compromises we make with the intolerable, with our own faults, which are by no means a problem, and even less of a concern for him, but as a vigilant citizen of this country, he speaks, shouts, gets tense, often overdoes it, but he speaks the truth bluntly, convinced that few people will find this to their liking.

In the end, he is who he is, Gjergj Luca, the man who draws energy from the density of daily activities, the one who cannot be predicted, a human potential capable of setting in motion a monstrous superstructure of Albanian economic activity, like "Rozafa." He can be everywhere and anyone in everything and anything where his presence challengingly demands to be. He is humane in all his behaviors, even when he bursts into pure wisdom and extreme "madness."





nuk e ka pretenduar se ka ardhur në realitetin shqiptar si një sipërmarrës që duke u shtirur kërkon të tregojë se është ai që nuk mund të jetë.

Kjo për mënyrën se si ai ka zgjedhur t'i bëjë gjërat, për mënyrën e të bërit biznes, por edhe për konturimin e marrëdhënieve me njerëzit, si "thembra e Akilit" të suksesit. Sepse tek ai ka diçka përtej këtij kategorizimi, ose më saktë, tek ai është mishëruar një biznesmen i kalkuluar nga tekstet e mjeshtrisë së bërjes biznes dhe suksesit. Ai është në kuptimin e pakontestueshëm një biznesmen kalibri. Puna që ai shndërron në akt krijimi, tregon se ai është armik i këtij profili biznesmenësh, me të cilin ekonomia shqiptare ka pasur fatin e keq të lidhë të sotmen dhe të ardhmen e mirëqenies dhe të progresit.

E nisi aktivitetin rreth 30 vjet më parë, me pak varka të vogla, ndërsa sot ka një flotë të vërtetë peshkimi. Filloi aktivitetin me disa ambiente të thjeshta në portin e Shëngjinit, sot ka ndërtuar "qytete" në zonën e Labinotit e të Maliqit, duke i kthyer ato edhe në destinacione ku shkojnë klientë të panumërt për qëllime shijimi ushqimesh e kalimi kohe të lirë.

E nisi me kuota modeste peshku të zënë, kurse sot aktivitetin e ka të sofistikuar, ku përveç tregut vendas, një pjesë të mirë përfaqësohet nga eksporti.

Ky pra është Gjergj Luca, biznesmeni që influencon pozitivisht në jetën e komuniteteve me veprimtarinë e tij konkrete si sipërmarrës i suksesshëm.

Generally, he is prejudiced and misunderstood, just as he never claimed to have come to the Albanian reality as an entrepreneur pretending to be someone he could never be.

This is due to the way he has chosen to do things, the way of doing business, but also for shaping relationships with people, as the "Achilles' heel" of success. Because there is something beyond this categorization in him, or rather, in him, a businessman calculated from the texts of the art of doing business and success is embodied. He is, in the undisputed sense, a businessman of caliber. The work he transforms into an act of creation shows that he is an enemy of this profile of businessmen, with whom the Albanian economy has had the misfortune to tie the present and the future of welfare and progress.

He started the activity about 30 years ago, with a few small boats, while today he has a real fishing fleet. He began the activity with some simple facilities in the port of Shëngjin, today he has built "cities" in the area of Labinot and Maliq, turning them into destinations where countless clients go for the purpose of enjoying food and spending leisure time.

He started with modest quotas of fish caught, while today his activity is sophisticated, where besides the domestic market, a good part is represented by exports.

This is Gjergj Luca, the businessman who positively influences the lives of communities through his concrete activities as a successful entrepreneur.





HEKURAN BRAHIMAJ

Drejtor i Përgjithshëm i kompanisë EMANTE

Emri i kompanisë: EMANTE
Xhiro e biznesit 2023: 16.5 milionë euro
Numri i punonjësve: 135
Vendndodhja: Durrës

HEKURAN BRAHIMAJ

General Director of EMANTE

Company Name: EMANTE
Turnover 2023: 16.5 million EUR
No. of employees: 135
Location: Durrës

Shumica e biznesmenëve që kanë sot pozita të forta dhe dominuese në biznesin shqiptar janë bërë të tillë nëpërmjet një rrugëtimi që ka nisur në fillim të viteve 90-të. Pra, atëherë kur nisi ndryshimi i sistemit ekonomik dhe Shqipëria përqafoi sistemin që bazohej pikërisht tek ushtrimi i iniciativës së lirë private. Dhe kur shumëkush u turr të ngulë flamurin e aktivitetit të vet në truallin e lirë, në truallin e pazënë të biznesit shqiptar. Por ama, historitë më interesante dhe më të bukura të biznesit janë shkruar vite më pas. Atëherë kur edhe biznesi ishte i strukturuar dhe i konsoliduar, dhe ekonomia ishte më e formalizuar. Ashtu sikurse ka bërë Hekuran Brahimaj me kompaninë e tij, EMANTE.

Pasi futi në xhep diplomën e bio-kimistit nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ai e zgjidhi dilemën në kërkim të fatit e progresit të vet, në favor të emigracionit. Dhe shpenzoi jo pak, por plot 12 vjet në emigrim. Por nuk i konsumoi këta vjet në mënyrë rutinë. Nuk e përjetoi këtë periudhë të rëndësishme kohore duke u ndjerë i vetëkënaqur e i vetërealizuar pse arrinte të përmbushte nevojat bazike të jetës për vete e familjen.

Most businesspeople who hold strong and dominant positions in the Albanian business world today started their journey in the early 1990s. This period marked the beginning of a new economic system in Albania, one that embraced the free market and private enterprise. It was a time when many rushed to stake their claim in the unoccupied business landscape. However, the most interesting and inspiring business stories have been written in the years since, as businesses became more structured and consolidated, and the economy became more formalized. Such is the case with Hekuran Brahimaj and his company, EMANTE.

After earning a degree in biochemistry from the Faculty of Natural Sciences, Brahimaj chose to pursue his fortunes abroad. He spent 12 years in emigration but didn't pass these years in a routine manner. Instead of feeling satisfied simply by meeting the basic needs of life for himself and his family, he was driven by a strong desire for change. Armed with the willpower necessary to achieve such missions, his experience as an immigrant in Greece served as a valuable opportunity to explore



I pajisur me dëshirën e madhe për ndryshime të mëdha në statusin e vet, i “armatosur” edhe me vullnetin që duhet për të bërë të mundshme misionet të tilla, e gjithë eksperiencia si emigrant në Greqi i shërbeu edhe si përvojë për t’u orientuar e piketuar se çfarë aktiviteti mund të ndërtonte. Dhe paralel me këtë realizoi një mori vëzhgimesh e studimesh, për të konkluduar nëse ia vlejte të merrej me atë që kishte identifikuar si aktivitetin e ardhshëm. Dhe kur argumentet i dhanë përgjigje pohuese kësaj dileme, nuk vonoi, por ndërtoi në vitin 2006 një pikë tregtimi të materialeve të ndërtimit, paneleve sanduic, profileve metalike dhe plastike dhe përpunimit të llamarinës në Vorë të Tiranës. Sigurisht që suksesi nuk mungoi, pasi nisja që ndërmori nuk ishte spontane apo e tipit “kokë a pil”, por ishte një nismë e mirëstuduar.

Brenda një dekade, avantazhet e shumta konkurruese bënë dallimin e EMANTE-s nga kompanitë e tjera. Mirëpo Hekuran Brahimaj e dinte që me korrë një sukses nuk është më e vështirë sesa të vazhdosh të korrësh në vazhdimësi sukses. Ai e kishte shumë të qartë se suksesi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe afatgjatë dhe për ta bërë të mundshme këtë, duhej që tek EMANTE të mbizotëronte inovacioni dhe risitë, çka do të bënin të mundshme që ajo të qëndronte një hap përpara konkurrentëve. Dhe kështu, në vitin 2018 lindi fabrika e prodhimit të paneleve sanduic dhe e aksesoreve të tij. Në këtë mënyrë, Hekuran Brahimaj i bëri një ndryshim tejet të rëndësishëm biznesit, kur kaloi nga importues dhe tregtues i produkteve, në prodhues dhe tregtues të tyre. Është një metamorfozë e rëndësishme, që i siguron kompanisë një perspektivë akoma më të mirë, e më të qëndrueshme. Nëpërmjet një kompanie

and identify potential business activities. Alongside this, he conducted numerous observations and studies to determine whether pursuing his identified business venture was worthwhile. When the evidence pointed affirmatively, he didn’t hesitate, and in 2006, he established a trading point for construction materials, sandwich panels, metal and plastic profiles, and sheet metal processing in Vora, Tirana. The success of this initiative was not unexpected, as it was a well-studied move rather than a spontaneous one.

Within a decade, EMANTE’s numerous competitive advantages set it apart from other companies. However, Brahimaj knew that achieving initial success was not as challenging as maintaining continuous success. He was well aware that success must be sustainable and long-term, and to achieve this, EMANTE needed to prioritize innovation and new ideas, which would keep the company ahead of its competitors. Consequently, in 2018, a factory for the production of sandwich panels and their accessories was established. This significant shift transformed EMANTE from an importer and trader of products to a manufacturer and trader. This metamorphosis provided the company with a more stable and promising future. Through a modern, automated company that operates with only four employees and has significant production capacities, EMANTE has not only met the domestic market’s needs for quality products but also exported 50% of its production. The company’s success in international markets, where quality and reliability are key, brings Brahimaj a great sense of pride, as “you can’t break into international markets through connections or favoritism, but only through quality and correctness,” as he says.

moderne, të automatizuar, që funksionon me vetëm 4 punonjës, me kapacitete shumë të mëdha prodhimi, EMANTE ka arritur që jo vetëm të përbushë nevojat e tregut vendas me produkte cilësore, por njëkohësisht, të destinojë e të shesë 50 për qind të prodhimit të saj në eksport. Dhe është pikërisht treguesi i eksportit, projektet e ndryshme të realizuara nëpër vende të ndryshme të botës, ai që i jep Hekuran Brahimajt një kënaqësi të ligjshme. Sepse, “në tregjet ndërkombëtare nuk çahet dot me njohje e me konjuktura, por me cilësi e korrektesë”, thotë ai.

Së fundmi EMANTE, duke ndjekur edhe trendet e investimeve, i ka shtuar portofolit të produkteve dhe shërbimeve edhe realizimin e bazamenteve të parqeve fotovoltaike. Natyrisht, me cilësinë maksimale, por edhe të harmonizuar me çmimet e arsyeshme, krahasuar me produktet e kësaj natyre të ardhura nga importi. Kur njihesh me histori të tilla impresionuese suksesi, ku një person braktis statusin e emigrantit dhe kthehet në atdhe e ndërton një biznes, më pas transformohet nga tregtar në prodhues, e më vonë nga importues në eksportues, sigurisht që është e pashmanshme pyetja që ka të bëjë me çelësin e këtij suksesi.

“Çelësi i suksesit tonë? Dëshira për inovacion dhe për të qenë gjithmonë një hap përpara trendeve të industrisë. Teksa vijojmë të investojmë në teknologjinë më të fundit që ne të kryesojmë në industri dhe duke ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime të cilësisë së lartë, ne kemi fituar reputacionin e partnerit serioz dhe të besueshëm për klientët tanë. Fryma e ekipit dhe përkushtimi ynë për të garantuar cilësi kanë qenë thelbësore në rritjen dhe zgjerimin tonë përtej territorit shqiptar.



Recently, following investment trends, EMANTE has expanded its product and service portfolio to include the construction of foundations for photovoltaic parks. Naturally, this work is carried out with maximum quality, while also being harmonized with reasonable prices compared to similar imported products.

When you hear such impressive success stories—where someone leaves behind the status of an immigrant, returns home to build a business, and then transforms from a trader into a manufacturer and finally from an importer to an exporter—it’s inevitable to ask about the key to this success.

“The key to our success? A desire for innovation and to always stay one step ahead of industry trends. As we continue to invest in the latest technology to lead the industry while consistently offering high-quality products and services, we have earned a reputation as a serious and reliable partner for our clients. Team spirit and our commitment to ensuring quality have been essential in our growth and expansion beyond Albanian borders. We are always open to new opportunities and partnerships and welcome collaboration with our clients and partners. Our goal is to work together to provide the best possible solutions that meet your needs and requirements. Client and partner relationships are extremely important to us, and we are ready to



Ne jemi gjithmonë të hapur ndaj mundësive dhe partneriteteve të reja dhe mirëpresim bashkëpunimin me klientët dhe partnerët tanë. Qëllimi ynë është të punojmë së bashku për të ofruar zgjidhjet më të mira të mundshme që përmbushin nevojat dhe kërkesat tuaja. Marrëdhëniet me klientët dhe partnerët janë tepër të rëndësishme për ne dhe jemi të gatshëm të shkojmë edhe më tej për të vendosë marrëdhënie afatgjata”- shpejgon Hekuran.

Emante Manufacturing është kompani lider në fushën e prodhimit të paneleve sanduiç. Qëllimi i saj kryesor është arritja e standardeve më të larta të përsosmërisë. Të specializuar në prodhimin e paneleve sanduiç nëpërmjet teknologjisë së fundit, ne synojmë të sjellim produkte të besueshme që përmbushin më së miri kërkesat e investitorëve modernë dhe të ekspertëve të industrisë. Vite të tëra ia kemi kushtuar hulumtimit dhe inkorporimit të teknologjisë së fjalës së fundit, kryesisht në ndërtimin e godinave publike dhe private. Emante kërkon të përqafojë teknika të suksesshme dhe efikase, në mënyrë që më tej të ketë rezultat në punën e saj origjinale

Objektivi kryesor i saj është të ofrojë sisteme ndërtimi inovative të një cilësie të lartë, me kosto të leverdishme, që të mos dëmtojnë mjedisin dhe me konsum të ulët të energjisë elektrike. Kapaciteti prodhues i kompanisë për ndërtimin e kontenerëve, kryesisht për përdorim industrial dhe komercial, është i konsoliduar dhe i garantuar, duke ofruar produkte të cilësisë së lartë e me kosto të ulët, ku përparësi ka përmbushja e kërkesave të klientit. Në vitin 2015, kompania bëri investime të mëdha për zgjerimin e veprimtarisë dhe përmirësimin e teknologjisë.

Emante ka një fuqi punëtore prej 135 punonjësish, 39 me kohë të plotë dhe 96 me kohë të pjesshme. Stafi kryesor me kohë të plotë është përgjegjës për veprimtarinë bazë të kompanisë, ndërsa stafi ynë me kohë të pjesshme mbulon role specifike, si punë të përkohshme ose sezonale. Pasja e një përzierje të personelit me orar të pjesshëm dhe atij me orar të plotë i mundëson kompanisë t'i përgjigjet në mënyrë efikase ndryshimeve në kërkesë.

go further to establish long-term relationships,” explains Hekuran.

Emante Manufacturing is a leading company in the production of sandwich panels. Its main goal is to achieve the highest standards of excellence. Specializing in the production of sandwich panels through the latest technology, Emante aims to deliver reliable products that meet the needs of modern investors and industry experts. Years have been dedicated to research and incorporating the latest technology, primarily in the construction of public and private buildings. Emante seeks to embrace successful and efficient techniques, which will further impact the quality of its original work.

The company's main objective is to offer innovative construction systems of high quality, at affordable costs, that do not harm the environment and consume low amounts of electricity. Emante's production capacity for the construction of containers, mainly for industrial and commercial use, is consolidated and guaranteed, providing high-quality products at low costs, with a focus on meeting client demands. In 2015, the company made significant investments to expand its operations and improve technology.

Emante has a workforce of 135 employees, 39 full-time and 96 part-time. The core full-time staff is responsible for the company's basic operations, while the part-time staff covers specific roles, such as temporary or seasonal work. This mix of part-time and full-time personnel allows the company to respond efficiently to changes in demand.





FATOS CERENISHTI

*President i "Grand Blue Fafa"
dhe "Fafa Premium Resort"*

Xhiro e biznesit 2023: 15 milionë euro
Ndryshimi në % 23/22: +80
Numri i punonjësve: 300
Vendndodhja: Durrës

FATOS CERENISHTI

*President of "Grand Blue Fafa"
and "Fafa Premium Resort"*

Turnover 2023: 15 million EUR
Difference in % 23/22: +80
No. of employees: 300
Location: Durrës

Fatos Cerenishti njihet tashmë nga të gjithë si pionieri i turizmit shqiptar. Por fillimet e tij në biznes i ka në sektorin e ndërtimit. Pra në atë sektor që ka qenë dhe vazhdon të mbetet bujar sa u takon fitimeve që siguron si sektor. Kështu që është e lehtë të përfytyrohet se po që se Fatos Cerenishti do të vazhdonte aktivitetin në ndërtim, pse jo, sot ai mund të klasifikohet tek ndërtuesit e mëdhenj të Shqipërisë. Por një ditë të bukur, shumë vite më parë, ai vendosi t'i dedikohet turizmit, duke vlerësuar pikërisht ato avantazhe që ka Shqipëria, dhe që e bëni në atë kohë vendin tonë një vend të prapambetur, por me potencial e perspektivë turistike. Pra Fatos Cerenishti la një degë biznesi fitimprurëse, sikurse ishte ndërtimi, për t'i hyrë një tjetër biznesi, i cili kishte të dobët aktualitetin në atë kohë, por perspektivën e kishte të shkëlqyer.

Dhe kjo është ajo që dallon njerëzit vizionarë. Ata shikojnë larg, shikojnë atë që nuk mund ta shikojnë njerëzit e zakonshëm. Vizionarët e dinë se do të shpërblehen një ditë për saktësinë e

Fatos Cerenishti is now widely recognized as a pioneer in Albanian tourism. However, his beginnings in business were in the construction sector. This is the sector that has been, and continues to be, generous in terms of profits. It's easy to imagine that if Fatos Cerenishti had continued his activity in construction, he might well have been classified among the leading builders in Albania today. But one beautiful day, many years ago, he decided to dedicate himself to tourism, recognizing the very advantages that Albania had at that time, making our country a backward place but with tourist potential and prospects. Thus, Fatos Cerenishti left a profitable business sector like construction to enter a different business that had weak current relevance at the time, but excellent prospects.

This is what distinguishes visionary people. They look far ahead, seeing what ordinary people cannot. Visionaries know that they will be rewarded one day for the accuracy of their

Adresa: Mali i Robit, Golem, Durres, Shqipëri
 Cel: +355 69 70 01 353
 Fax: +355 55 800 800
 Email: @fafa.al
 Website: www.fafa.al

Address: Robi Mountain, Golem, Durres, Albania
 Cel: +355 69 70 01 353
 Fax: +355 55 800 800
 Email: @fafa.al
 Website: www.fafa.al



parashikimeve të tyre. Vërtet që Fatos Cerenishti mund të kishte disa para më shumë, nëse do të vazhdonte të ishte ndërtues midis mijëra ndërtuesve, por këngësinë që ka përjetuar duke qenë protagonist i turizmit shqiptar, nuk do ia jepte kurrë ndërtimi. Sepse, edhe kur vendosi t'i përkushtohet turizmit, nuk ishin parësore kërkesat për fitime të mëdha. Pra nuk e filloi eksplorimin e këtij sektori me idenë së do të bënte pasuri më të madhe sesa me ndërtimin. Për këtë ishte i vetëdijshëm. Protagonizmi i tij në turizëm filloi si ambicie, si “kokëfortësi” dhe sfidë e një personi që kur sheh resorte të bukura jashtë, e kap dëshira dhe guximi për të ndjekur të njëjtën rrugë. Njësoj sikurse kanë vepruar edhe kolegët e tij, pronarë të resorteve jashtë vendit. Por duke qenë ndër të parët biznesmenë që guxuan të investojnë në turizëm, Fatos Cerenishti iu desh të përballej edhe me vështirësi, që vinin nga infrastruktura e dobët e për të cilën është përgjegjëse shteti, me skepticizmin e të huajve për çdo gjë që lidhet me Shqipërinë, me mungesën e personelit të përshtatshëm që është i aftë për të ofruar shërbim cilësor, e që e duan aq shumë të huajt.

Parësore në të gjithë veprimtarinë e tij ka qenë

forecasts. Indeed, Fatos Cerenishti might have had a bit more money if he had continued to be a builder among thousands of builders, but the satisfaction he has experienced as a protagonist in Albanian tourism could never have been provided by construction. Even when he decided to focus on tourism, high profit demands were not a priority. He did not start exploring this sector with the idea of making greater wealth than in construction. He was aware of that. His role in tourism began as ambition, “stubbornness,” and a challenge for someone who, when seeing beautiful resorts abroad, felt the desire and courage to follow the same path, just as his colleagues who own resorts abroad did. But being among the first entrepreneurs to dare to invest in tourism, Fatos Cerenishti had to face difficulties, such as poor infrastructure for which the state is responsible, foreign skepticism about anything related to Albania, and the lack of suitable personnel capable of providing high-quality service, which foreigners greatly desire.

The primary focus of his entire activity has been to contribute to the development of the country, to the development of a sector for

dhënia e një kontributi për zhvillimin e vendit, për zhvillimin e një sektori, për të cilin Shqipëria ka të gjitha avantazhet dhe bukuritë natyrore. Të tjerat, ato që varen nga njeriu, nga politika, bëhen me kalimin e kohës, mjafton të ekzistojë dëshira e mirë. Me ngritjen e Fafa Premium Resort, e më vonë të Grand Blue Fafa Resort, me përshtatjen edhe të godinave të tjera në funksion të turizmit, Fatos Cerenishti e ka bërë të veten. Ka ndërtuar dy komplekse gjigante, pas asnjë dallim, për mënyrën si funksionojnë nga resorte të tjera jsh të Shqipërisë e ku shkojnë jo pak Shqiptarë.

Grand Blue Fafa Resort ndodhet pikërisht përballë Rivierës Shqiptare, në plazhin e bukur të gjatë të Golemit, Durrës. Vetëm 35 minuta nga Aeroporti i Tiranës 'Nënë Tereza' dhe më pak se 20 minuta nga Porti i Durrësit.

Grand Blue Fafa Resort është një hotel i ri mbresëlënës me një arkitekturë mahnitëse të ndërtuar në një plazh të mrekullueshëm të Golemit, ideal për ata që kërkojnë të kenë pushimet e tyre të qeta dhe që mbeten gjatë në kujtesë.

 Tel 00355 4 224 0148/274243
 Mobile 0692088200
 Fax: 355 4 223 0690
 Web: www.ak-invest.com
 Email: @ak-invest.com

Address: Rruga Bardhok Biba Pallati Lid, hyrja 2/9
 Tel 00355 4 224 0148/274243
 Mobile 0692088200
 Fax: 355 4 223 0690
 Web: www.ak-invest.com
 Email: @ak-invest.com



Prej vitit 2017 AK- Invest është aksioner në Bursën e Tiranës (ALSE).

Vendndodhja e shoqërisë:

- Zyra Qendrore e vendosur në rrugën “Bardhok Biba, objekti LID”, Tiranë
- 8 Zyra me adresë sekondare,
- 400 agjentë në të gjithë Shqipërinë.

Kemi arritur një numër klientësh / vëllimesh deri në fund të vitit 2021:

- për transferimin e parave dhe shërbimin e pagesave ndërkombëtare/vendase: 450,000 klientë;
- për shërbimet e arketimit të pagesave të shërbimeve: 500,000 konsumatorë.
- për huatë: portofol prej ~ 2,000,000 EUR.

Viti	Qarkullimi (ALL)	Fitimi Neto (ALL)
2023	571,621,034	85,005,815
2022	646,813,505	201,518,245
2021	689,740,752	274,097,558
2020	575,355,768	173,410,249
2019	444,947,704	148,184,805

Liberalizimi në ofrimin e shërbimeve financiare nga Institucionet Financiare Jobankare (SFJB) dhe Institucionet e Pagesave (IP), kanë nisur zbatimin me kohë, duke krijuar klimë më të shëndetshme në tregun e konkurrencës dhe duke lehtësuar klientët

Since 2017, AK-Invest has been a shareholder in the Tirana Stock Exchange (ALSE).

Company Location:

- Head Office: Located on “Bardhok Biba” street, LID Building, Tirana
- 8 Secondary Offices
- 400 Agents throughout Albania

Client and Volume Metrics (as of the end of 2021):

- Money Transfer and Payment Services (International/Domestic): 450,000 clients
- Utility Bill Payment Services: 500,000 consumers
- Loans Portfolio: Approximately EUR 2,000,000

Year	Turnover (ALL)	Net Profit (ALL)
2023	571,621,034	85,005,815
2022	646,813,505	201,518,245
2021	689,740,752	274,097,558
2020	575,355,768	173,410,249
2019	444,947,704	148,184,805

The liberalization of financial services offered by Non-Banking Financial Institutions (SFJBs) and Payment Institutions (IPs) has been timely implemented, creating a healthier competitive market environment and providing clients with

në kohë, largësi dhe kosto. SFJB, për ofrimin e shërbimeve financiare, krijojnë rrjet të gjerë dhe intensiv (agjentësh), që është një realitet tashmë i ndërtuar e i kërkuar nga klienti, që ka ndikuar në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit të atë, nëpërmjet vendndodhjes së çdo agjenti, përpunimit të shpejtë në kohë reale të transaksioneve dhe uljes së kostove për transaksion. Rrjeti i SFJB-ve tashmë funksionon si një one-stop-shop për shërbimet financiare, pra klienti përfton paketë shërbimesh financiare. Me licensimin si Institucion Pagesash, AK-Invest do të shtojë gamën e shërbimeve të pagesave të ofruara për klientët në përputhje me aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Prej 20 vitesh, AK-INVEST është përshtatur për klientët me pakicë dhe bizneset e vogla e të mesme, duke ofruar shërbime financiare, si: Kredi, Faktoring, Garanci dhe Angazhime Bankare, Pagesa (ndërkombëtare/kombëtare), Transferta

more convenience in terms of time, distance, and cost. SFJBs create an extensive and intensive network of agents, a reality now established and demanded by clients. This has led to improved service quality through real-time transaction processing and reduced transaction costs. The SFJB network now functions as a one-stop-shop for financial services, offering clients a comprehensive package of financial services. With its licensing as a Payment Institution, AK-Invest will expand its range of payment services offered to clients in accordance with the regulatory acts of the Bank of Albania.

For 20 years, AK-Invest has catered to retail clients and small to medium-sized businesses by offering financial services such as Loans, Factoring, Guarantees and Banking Commitments, Payments (International/Domestic), International Money Transfers

**TRANSFERO
PARA KURDO.**

MoneyGram.
transferim parash

AK INVEST
INSTITUCION FINANCIAR

**KRYEJ TRANSFERTA NË
PIKËN TËNDE MË TË AFËRT
AK-INVEST & MONEYGRAM.**



ndërkombëtare të parave – partner i MoneyGram Int. për Shqipërinë dhe kombëtare - TRAK, Pagesa Utilitare, Agjent në Sigurime, Këmbim valutash, Ndërmjetësim Financiar dhe Konsulencë.

AK-Invest u licencua nga Banka e Shqipërisë më 2021 dhe për shërbimin e parasë elektronike nëpërmjet aplikacionit eReja, duke dhënë kështu mundësi klientëve të marrin shërbime dhe të kryejnë pagesat e tyre tashmë dhe online pa nevojën e prezencës fizike.

Gjithashtu nëpërmjet eReja klientët kanë mundësi të dërgojnë para kudo në botë direkt nga walleti nëpërmjet partneritetit të eReja me MoneyGram International.

AK-Invest do të vijojë të investojë në burime të teknologjisë informatike dhe në burime njerëzore duke i konsideruar si dy asetet me vlerë të shtuar përkundrejt kohës.



(MoneyGram Int. partner for Albania) and Domestic Transfers (TRAK), Utility Payments, Insurance Agency Services, Currency Exchange, Financial Intermediation, and Consultancy.

In 2021, AK-Invest was licensed by the Bank of Albania to provide electronic money services through the eReja application, allowing clients to access services and make payments online without the need for physical presence.

Through eReja, clients can also send money anywhere in the world directly from their wallet via the partnership between eReja and MoneyGram International.

AK-Invest will continue to invest in IT resources and human resources, considering them as two valuable assets in adapting to the future.





ANTON NDRECA

*Drejtor i Përgjithshëm e kompanisë
"Gruppo Koni" sh.p.k*

Emri i kompanisë: Gruppo Koni sh.p.k
Xhiro e biznesit 2023: 5 milionë euro
Numri i punonjësve: 80
Vendndodhja: Lezhë

ANTON NDRECA

General Director of "Gruppo Koni" LLC

Company name: Gruppo Koni LLC
Turnover 2023: 5 million EU
No. of employees: 80
Location: Lezha

GRUPPO KONI është themeluar në Milano, ne vitin 1998 dhe zhvillon aktivitetin në fushën e ndërtimit duke realizuar vepra të ndryshme rezidenciale, civile dhe industriale. Zhvillimi i këtij aktiviteti realizohet nëpërmjet kompanive të mëposhtme:

- "GRUPPO KONI" s.r.l.
- "KONI" s.r.l.
- "KONI COSTRUZIONI" s.r.l.
- "M3" s.r.l.
- "GRUPPO KONI" sh.p.k.

Me eksperiencën e punës që në fillimet e aktivitetit deri në ditët e sotme duke ndjekur proceset e zbatimit të punimeve për ndërtimin e objekteve civile dhe industriale, që nga fazat e projektit deri në realizimin e tyre, solli që në vitin 2015 "Gruppo Koni" sh.p.k. të fillonte aktivitetin edhe në Shqipëri.

MOTOJA: "WE GIVE LIFE TO YOUR PROJECTS"

Slogani i kompanisë tonë lidhet ngushtë me zhvillimin e teknikave të reja të përpunimit të produkteve dhe optimizimin e prodhimit duke garantuar standarte të larta të cilësisë, sigurisë dhe besueshmerisë, duke i siguruar klientëve dhe bashkëpunetorëve fleksibilitet në hartimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme.

Gruppo Koni was established in Milan in 1998 and operates in the construction sector, undertaking various residential, civil, and industrial projects. The company's activities are carried out through the following companies:

- "GRUPPO KONI" s.r.l.
- "KONI" s.r.l.
- "KONI COSTRUZIONI" s.r.l.
- "M3" s.r.l.
- "GRUPPO KONI" LLC

With work experience gained from the beginning of its activities until today, following the processes of implementing works for the construction of civil and industrial buildings, from the project phases to their realization, in 2015, "Gruppo Koni" LLC also began operations in Albania.

MOTTO: WE GIVE LIFE TO YOUR PROJECTS"

Our company's slogan is closely tied to the development of new product processing techniques and the optimization of production, ensuring high standards of quality, safety, and reliability, while providing flexibility to our clients and partners in the design and implementation of various projects.

Adresa: Rruga Markatomaj, Ndertesa 4 kateshe, Shenkoll (Lezhe-Tirane Km 7),
Lezhë, Albania
Tel: 069 406 6800
infoal@gruppokoni.com

Address: Rruga Markatomaj, Ndertesa 4 kateshe, Shenkoll (Lezhe-Tirane Km
7), Lezhë, Albania
Tel: 069 406 6800
infoal@gruppokoni.com

BASHKËPUNETORET:

“Gruppo Koni” sh.p.k. e ka zhvilluar dhe zgjeruar aktivitetin, duke u rritur si biznes i qëndrueshëm ndër vite, bazuar në krijimin e marrëdhënieve korrekte dhe afatgjata me partnerët dhe bashkëpunetorët tanë, vendas dhe të huaj.

ALUMIL-Me një experiencë mbi 30 vite, specializuar në dizejnimin dhe prodhimin e sistemeve të aluminit.

SCHUCO-Lider botëror, mbi 60 vite eksperiencë, që ofron produkte inovative, sisteme alumini, pvc-je dhe çeliku, për ndërtesa banimi dhe komerciale, sisteme dyresh dhe dritaresh, sisteme rrëshqitëse, sisteme fasadash, etj.

ALUK- Një lider global në inxhinierinë, shpërndarjen dhe projektimin e dritareve, dyerve dhe zgjidhjeve të fasadave prej alumini.

GUARDIAN GLASS-Një nga prodhuesit dhe novatorët më të mëdhenj të xhamit në botë. Nga krijimi i xhamit arkitektonik për strukturat me famë botërore, historike deri te krijimi i ambienteve më të qëndrueshme të jetesës dhe punës.

EVEREST-Një nga firmat kryesore në prodhimin e profileve të aluminit në rajon me më shumë se 25 vite përvojë dhe me një kapacitet prodhimi gjithmonë në rritje.

SINANI-Një markë suksesi në sektorin e materialeve hidraulike, sistemeve të ngrohjes-ftohjes në Shqipëri.

EDIL-AL-IT- “Edil-Al” është një shoqëri e specializuar në fushën e ndërtimeve civile, infrastrukturës dhe industrisë. Puna në “Edil Al” është e përqendruar në një marrëdhënie besueshmërie dhe partneriteti me të gjithë bashkëpunetorët dhe klientët.

MET-INVEST- Veprimtari në fushën e ndërtimit, studimit, projektimit, supervizimit.

TDT & PARTNERS-Veprimtari në fushën e ndërtimit.

ATELIER 4-Një nga Studiot kryesore të arkitekturës në Shqipëri që përbëhet nga një skuadër arkitektësh, projektuesish dhe inxhinierësh që ofrojnë shërbime duke ndërthurur arkitekturën me inxhinierinë.

TEXAS DEVELOPMENT-Ndërtim dhe investime në fushën e ndërtimit.

DATON CONSTRUCTION-Veprimtari në fushën e ndërtimit.

PARTNERS:

Gruppo Koni LLC has developed and expanded its activity, growing into a sustainable business over the years, based on creating correct and long-term relationships with our local and international partners and collaborators.

ALUMIL - With over 30 years of experience, specializing in the design and production of aluminum systems.

SCHUCO - A global leader with over 60 years of experience, offering innovative products, aluminum, PVC, and steel systems for residential and commercial buildings, door and window systems, sliding systems, façade systems, etc.

ALUK - A global leader in the engineering, distribution, and design of aluminum window, door, and façade solutions.

GUARDIAN GLASS - One of the world's largest glass producers and innovators, creating architectural glass for world-renowned structures and sustainable living and working environments.

EVEREST - A leading firm in the production of aluminum profiles in the region, with more than 25 years of experience and an ever-growing production capacity.

SINANI - A successful brand in the hydraulic materials sector and heating-cooling systems in Albania.

EDIL-AL-IT - A company specialized in civil construction, infrastructure, and industry. Edil-Al focuses on building trust and partnerships with all collaborators and clients.

MET-INVEST - Engaged in construction, study, design, and supervision activities.

TDT & PARTNERS - Active in the construction sector.

ATELIER 4 - One of the leading architecture studios in Albania, consisting of a team of architects, designers, and engineers, offering services that blend architecture with engineering.

TEXAS DEVELOPMENT - Construction and investment in the construction field.

DATON CONSTRUCTION - Engaged in construction activities.

PROJEKTIMI, ASEMBLIMI DHE MONTIMI I FASADAVE TE VAZHDUARA PER NDERTESA

“Gruppo Koni” sh.p.k. ka një eksperiencë të gjatë pune ndër vite dhe sot është një ndër kompanitë lider në Shqipëri për përpunimin dhe furnizimin me Sisteme Alumini Termik, siç janë:

- Fasada xhami gjysëm strukturale dhe Strukturale.
- Dyer dhe Dritare te dimensioneve, serive dhe tipologjive te ndryshme.
- Fasadat e ventiluara: me veshje qeramike, Gur, Hpl dhe Alukobond

Gruppo Koni ka realizuar sisteme të ndryshme vetratash dhe fasadash brenda dhe jashtë vendit në objekte me funksione të ndryshme me funksion: banim, hoteleri, objekte industriale dhe shërbimi.

Gjatë eksperiencës së punës në këto vite në përpunimin dhe implementimin e sistemeve të aluminit, “Gruppo Koni” ka investuar vazhdimisht duke ndjekur ritmet e zhvillimeve dhe inovacioneve teknologjike. Gjithashtu është insistuar në krijimin e një ekipi profesional dhe të specializuar.

Bashkërendimi i këtyre faktorëve në këto vite ka ofruar produkte cilësore, janë rritur kapacitetet prodhuese duke mbajtur standarte të larta, është zgjeruar aktiviteti i kompanisë, janë shtuar bashkëpunetorët duke bërë që “Gruppo Koni” të jetë pjesë e projekteve të rëndësishme për realizimin e fasadave komplekse të objekteve shumë katëshe dhe Resorteve të ndryshme turistike.

Objektet në të cilat janë implementuar këto sisteme për realizimin e fasadave në Shqipëri, sipas projekteve të zbatimit, detajeve dhe specifikimeve teknike të tyre janë si më poshtë:

1. KOMPLEKSI TURISTIK “SAN PIETRO”, është ndërtuar në Gjirin e Lalëzit, në Durrës duke alternuar objektet rezidenciale, katër lloje vilash dhe katër lloje të ndryshme palazinash jo më shumë se tre kate dhe MELIA RESORT, hotel



DESIGN, ASSEMBLY, AND INSTALLATION OF CONTINUOUS FACADES FOR BUILDINGS

Gruppo Koni LLC has extensive work experience over the years and is now one of the leading companies in Albania for processing and supplying Thermal Aluminum Systems, such as:

- Semi-structural and structural glass facades.
- Doors and windows of various dimensions, series, and typologies.
- Ventilated facades: with ceramic cladding, stone, HPL, and Alukobond.

Gruppo Koni has implemented various glass and façade systems both domestically and abroad in buildings with various functions: residential, hospitality, industrial, and service.

Over the years, Gruppo Koni has continuously invested in the processing and implementation of aluminum systems, following technological developments and innovations. The company has also focused on creating a professional and specialized team.

The combination of these factors over the years has produced high-quality products, increased production capacities while maintaining high standards, expanded the company's activities, and added new collaborators, making Gruppo Koni part of significant projects for realizing complex facades for multi-story buildings and various tourist resorts.

The buildings where these systems have been implemented in Albania, according to the implementation projects, details, and technical specifications, are as follows:

1. TOURIST COMPLEX “SAN PIETRO”, located in Gjiri i Lalëzit, Durrës, alternating between residential buildings, four types of villas, and four different types of three-story buildings, as well as MELIA RESORT, a four-story, 5-star hotel.





4 katesh me 5 yje.

Architectural Designer: “Ettore De Lellis”

Sistemet e përdorura: sisteme te vetratave me hapje, Sisteme supreme, sistemet me rrëkitje, Sisteme skylight, etj.

2. MET TIRANA BUILDING, ndodhet në një zonë strategjike dhe qendrore të qytetit të Tiranës, ne anë të Bulevardit “Zhanë D’Ark”. Architectural Designer: “Mario Cucinela Architects”

“Gruppo Koni” sh.p.k si bashkëpunëtor i shoqërisë “MET INVEST” ka realizuar furnizimin dhe instalimin e fasadave, vetratave dhe dritareve të kësaj godine polifunkionale.

Fasada është realizuar me shumë kujdes nga kompania Gruppo Koni dhe përmban një artikulum të moduleve opake dhe transparente mbi një nivel të tokës plotësisht me xham, duke optimizuar dritën natyrale të ditës duke reduktuar rrezatimin diellor.

Sistemet që janë përdorur për realizimin e fasadave të këtij objekti janë sisteme “SCHUCO”.



Architectural Designer: “Ettore De Lellis”

Systems used: window systems with opening, supreme systems, sliding systems, Skylight systems, etc.

2. MET TIRANA BUILDING, located in a strategic and central area of Tirana, along the “Zhanë D’Ark” Boulevard.

Architectural Designer: “Mario Cucinela Architects”

Gruppo Koni LLC, as a collaborator of MET INVEST, has supplied and installed the facades, windows, and doors of this multifunctional building.

The facade has been carefully crafted by Gruppo Koni and features an articulation of opaque and transparent modules, with the ground level fully glazed, optimizing natural daylight while reducing solar radiation.

Systems used for the facades: SCHUCO systems.





3. BOOKBUILDING është një godinë shumëkateshe me një dizajn unik që po ndërtohet në qendër të Tiranës, ndërmjet rrugës “28 Nëntori” dhe rrugës “Abdi Toptani”. Architectural Designer: “51N4E & CENTRAL”. “Gruppo Koni” sh.p.k si bashkëpunëtor i shoqërisë “T.D.T. & PARTNERS” do të realizojë furnizimin dhe instalimin e fasadave, vetratatave dhe dritareve të kësaj godine polifunkionale. Sistemet që janë përdorur: Sistem Fasade Alumil M7, Sistem me hapje Alumil S77 phos, Sistem me rrëshkitje Alumil Supreme S650 phos, Sistem me rrëshkitje Alumil Supreme S700.

4. GALERIA ROMA

Objekti: “GALERIA ROMA” me vendodhje në Rrugën e Kavajës, Tiranë. Architectural Designer: “Atelier 4”.

5. HOTEL M-GALLERY

Objekti: “HOTEL M-GALLERY”, 5 STARS HOTEL, me vendodhje në kompleksin “Green Coast”, Palasë. Architectural Designer: “51N4E & CENTRAL”.

NDERTIMI

Objekti: “SEASIDE 2”, me vendodhje pranë zonës së Ranës së Hedhun, Shëngjin, Lezhë. Architectural Designer: “ATELIER 4”. Zhvillues: “GRUPPO KONI” sh.p.k. Koni Seaside 2, një nga projektet më të reja rezidenciale e cila shtrihet buzë detit e ndërthurrur me natyrën unike të zonës dhe ujrat e kristalta të Adriatikut. Është e lokalizuar në vijën bregdetare të Shëngjinit, pranë zonës së Ranës së Hedhun. Zona ku po zhvillohet projekti i ri tashmë ka potencial të lartë zhvillimi në fushën e turizmit

3. BOOKBUILDING, a multi-story building with a unique design, being built in the center of Tirana, between “28 Nëntori” street and “Abdi Toptani” street.

Architectural Designer: “51N4E & CENTRAL” Gruppo Koni LLC, as a collaborator of T.D.T. & PARTNERS, will supply and install the facades, windows, and doors of this multifunctional building.

Systems used: Alumil M7 Facade System, Alumil S77 Phos Opening System, Alumil Supreme S650 Phos Sliding System, Alumil Supreme S700 Sliding System.

4. GALERIA ROMA

Location: “GALERIA ROMA”, located on Rrugën e Kavajës, Tirana.

Architectural Designer: “Atelier 4”.

5. HOTEL M-GALLERY

Location: “HOTEL M-GALLERY”, 5 STARS HOTEL, located in the “Green Coast” complex, Palasë.

Architectural Designer: “51N4E & CENTRAL”.

CONSTRUCTION

Project: “SEASIDE 2”, located near the Ranë e Hedhun area, Shëngjin, Lezhë.

Architectural Designer: “ATELIER 4”

Developer: “GRUPPO KONI LLC”

Koni Seaside 2 is one of the latest residential projects situated by the sea, blending with the unique nature of the area and the crystal-clear waters of the Adriatic. It is located along the coastline of Shëngjin, near the Ranë e Hedhun area. The area where the new project is being developed already has high



falë numrit të lartë të ndërtimeve të komplekseve rezidenciale për vendasit dhe të huajt. Rezenca është konceptuar si një strukturë e veçantë e cila do të jetë uniform me natyrën, me 4 thyerje secila e zhvilluar në 5-6 kate. Punimet në këtë objekt do të jenë tepër cilësore, fasadat që do të kenë elementë dekorativ, imitim të grilave prej alumini, sistem kapote, të gjitha ballkonet do të kenë gjelbërim natyral duke e bërë këtë objekt njesh me natyrën ekzistuese. Vetratat dhe dritaret janë të mëdha të cilat mundësojnë ndriçim natyral. Të gjitha hapësirat e përbashkëta dhe sistemimet e jashtme janë të mirëorganizuar dhe do të jenë në shërbim të gjithë banorëve përgjatë gjithë vitit. Objekti është godine banimi dhe shërbimesh 5-6 kate mbi tokë me 1 kat dhe 2 kate parkimi nëntokë. Në këtë objekt janë 99 apartamente banimi, me tipologji te ndryshme: 1+1, 2+1 dhe 3+1.

PUNIMET E SISTEMEVE MEKANIKE (HVAC):

“Gruppo Koni” sh.p.k. është specializuar në realizimin dhe zbatimin e punimeve të sistemeve mekanike. Teknikët dhe inxhinierët e kompanisë realizojnë montimin dhe instalimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe të ajrit të kondicionuar (HVAC), në objekte me funksione të ndryshme si, objekte rezidenciale duke filluar nga një kat deri në objekte shumë katëshe, dhe në godina jo rezidenciale siç janë objektet industriale, hotelet, objektet publike, shkolla, konvikte, ambiente sportive, spitale etj. “Gruppo Koni” sh.p.k. është distributor i produkteve të SYSTEM AIR në Shqipëri dhe gjithashtu bashkëpunon ndër vite për produktet e sistemeve HVAC, të brandit lider botëror DAIKIN.

SYSTEM AIR është furnizues kryesor global i produkteve dhe sistemeve të ventilimit, ngrohjes dhe ftohjes me cilësi të lartë, duke ju shërbyer klientëve me produkte HVAC që japin zgjidhje të qëndrueshme dhe efikase të konsumimit të energjisë.

development potential in the tourism sector due to the high number of residential complexes built for both locals and foreigners. The residence is conceived as a unique structure, which will be uniform with nature, with 4 breaks, each developed over 5-6 floors. The work on this project will be of high quality, with facades featuring decorative elements, aluminum grille imitation, insulation systems, and all balconies will have natural greenery, making the building blend with the existing nature. The windows and glass facades will be large to allow natural light to enter. All common areas and external landscaping will be well-organized and serve all residents throughout the year. The building is a 5-6 story residential and service structure above ground with 1 and 2 floors of underground parking. This building contains 99 residential apartments, with various typologies: 1+1, 2+1, and 3+1.

MECHANICAL SYSTEMS WORKS (HVAC):

Gruppo Koni LLC is specialized in the implementation of mechanical systems works. The company's technicians and engineers carry out the installation of heating, ventilation, and air conditioning systems (HVAC) in buildings with various functions, including residential buildings ranging from single-story to multi-story structures, and non-residential buildings such as industrial facilities, hotels, public buildings, schools, dormitories, sports facilities, hospitals, etc. Gruppo Koni LLC is a distributor of SYSTEM AIR products in Albania and has also collaborated for years on HVAC systems products with the global leader DAIKIN.

SYSTEM AIR is a leading global supplier of high-quality ventilation, heating, and cooling products and systems, serving customers with HVAC products that offer sustainable and energy-efficient solutions.



KRIENKO MEMO

President i kompanisë "Blue Sky"

Emri i kompanisë: Blue Sky sh.p.k (Krienko Jeans)
Xhiro e biznesit 2023: 3 milion EURO
Numri i punonjësve: 300
Vendndodhja: Fier

KRIENKO MEMO

President of the company "Blue Sky"

Company name: Blue Sky sh.p.k (Krienko Jeans)
Turnover 2023: 3 million EUR
No. of employees: 300
Location: Fier

Zakonisht drejtuesit e kompanive të ndryshme janë të ndikuar nga natyra e aktivitetit të asaj që kanë krijuar dhe e drejtojnë. Kështu, nuk është e zakonshme të shohësh një drejtues të një kompanie, bie fjala tregtimi makinash BMW, të ketë si mjet kryesor udhëtimi të tijin një Mercedes. Një arsytim të tillë e ilustron më së miri edhe biznesmeni fierak Krienko Memo. Në dhjetor të vitit të kaluar ai festoi 30-vjetorin e kompanisë, çka e rendit atë ndër biznesmenët e parë, jo vetëm në zonën e Fierit, por të të gjithë Shqipërisë. Në ambientet e kompanisë ku ke lënë takim me të, ai shfaqet i veshur hijshëm me pantallona e bluzë të prodhuara nga kompania e tij, duke qenë kështu një nga "topmodelët" e parë reklamues të tyre.

Sot, ai njihet si një nga prodhuesit e mjaft firmave prestigjioze në botë, që mbajnë firmën "Made in Albania". "Krienko ka arritur të prodhojë, për markat më të famshme si: "Meltin' Pot", "Versace" "Only jeans", "Jack & Jones", "Tommy Hilfiger", "Angel Devil", "Free Soul", "Ted Baker" dhe tanimë, ne kemi sjellë në treg markën tonë "Krienko Jeans", pohon z. Memo,

Usually, the leaders of different companies are influenced by the nature of the activity of what they have created and manage. Therefore, it is uncommon to see a leader of a car trading company, say BMW, using a Mercedes as their primary mode of transportation. Such reasoning is best illustrated by the businessman from Fier, Krienko Memo. Last December, he celebrated the 30th anniversary of his company, placing him among the first businessmen, not only in the Fier area but in all of Albania. In the company's premises where you have an appointment with him, he appears elegantly dressed in trousers and a shirt produced by his company, thus being one of the first "top models" promoting them.

Today, he is known as one of the producers for many prestigious brands in the world that carry the "Made in Albania" label. "Krienko has managed to produce for famous brands such as: 'Meltin' Pot', 'Versace', 'Only Jeans', 'Jack & Jones', 'Tommy Hilfiger', 'Angel Devil', 'Free Soul', 'Ted Baker', and now, we have brought our brand 'Krienko Jeans' to the market," states Mr.

në këtë bashkëbisedim.

Ai pohon se në një moshë fare të re, ka qenë i prirur për modën, ashtu siç edhe ndodh gjithnjë, me njerëzit e kësaj fushe. Pohon se ka filluar të stilojë dhe të përgatisë veshje për vete dhe miqtë, duke tentuar të dilnin përtej prerjeve standarde, që do të thotë, një fashetë më shumë, apo pak kauboj, por pa i hapur shumë telashe vetes, nën regjimin e dikurshëm. Fill pas kësaj përvoje dhe pasioni, që me siguri nuk e dinte se ku do ta shpiente, ai pohon se përfundoi studimet në Univesitetin e Tiranës për financë, madje një degë që do ta ndihmonte mjaft në profesionin e tij të preferuar.

Në fillim, ai ka drejtuar një punishte të veshjeve të njohura për ato vite të para të '90, për të vijuar më tej, sërisht po me drejtimin e një kompanie veshjesh, por këtë radhë, duke u lidhur me firmat prestigjioze, fillimisht të vendit fqinj, Italisë.

“Nisëm bashkëpunimet me firmën Italiane ‘Eldo S.P.A’ me biznesmenin Luciano Fragolo në Firenze. Filluam të realizonim veshje për fëmijë, kryesisht xhinse. Më pas, mora një kredi dhe formova një repart prej 19 vetash”. Sot, numri i punëtorëve të kompanisë “Krienko” arrin në 300 dhe janë ndërtaur fabrika me tetë reparte, që përfshijnë: prestari, laboratoprestari, laboratorë konfeksionesh, repart për punimet artistike, qëndistari, stampim, repart të rrudhosjes, reparte ambalazhimi, lavanteri industrial, etj. dhe shumë prej këtyre proceseve kryhen me dorë, duke ndërthurrur qepjen me makineritë moderne dhe qepjen me dorë të disa proceseve vizive.



Memo in this conversation.

He admits that from a very young age, he was inclined towards fashion, as is always the case with people in this field. He states that he began designing and preparing clothes for himself and his friends, trying to go beyond the standard cuts, meaning an extra flap, or a bit of cowboy style, but without causing too much trouble for himself under the former regime. Following this experience and passion, which he surely didn't know where it would lead him, he completed his studies at the University of Tirana in finance, a field that helped him a lot in his preferred profession.

Initially, he led a clothing workshop known in those early '90s, and later, he continued by managing a clothing company, but this time by connecting with prestigious firms, initially from the neighboring country, Italy.

“We started collaborations with the Italian firm ‘Eldo S.P.A’ with businessman Luciano Fragolo in Florence. We began making children's clothing, mainly jeans. Then, I took a loan and formed a department with 19 people.” Today, the number of workers in the “Krienko” company reaches 300, and factories have been built with eight departments, including cutting, confectionery laboratories, an artistic works

Prodhimet, fillimisht eksportoreshin në Firenze, të papërfunduara, pasi ende nuk kishim investuar për lavanterinë industriale që është tani ndër më të mëdhatë në Ballkan, duke eksportuar në të gjithë Europën. Fillimisht, ata prodhoni 100 palë konfeksione të ndryshme në ditë, ndërsa sot kanë arritur dhe deri më 4 mijë palë të tilla, duke qenë fleksibël në treg, me mbi 25 modele të reja në muaj dhe me çmim konkurrues.

Një mirënjohje të veçantë, zoti Krienko ka marrë nga qarku i Fierit, si «Nderi i Qarkut» dhe Bashkia e Fierit, për zbutjen e papunësisë, kontributin në zhvillimin rajonal të qytetit dhe për kujdesin ndaj mjedisit.

Viti i mbrapshtë për të gjithë shqiptarët, ai famëkeq i '97-ës, bëri që firma italiane të tërhiqej. Por edhe në këtë moment, Krienko Memo mori frytin e partneritetit të sigurtë e besnik me partnerin e tij italian, i cili kishte blerë disa vila në Sauk të Tiranës. Dhe kur i duhej të largohej e ftoi Krienko Memon dhe i ofroi blerjen e këtyre vilave. Kur dëgjoi çmimin, biznesmeni fierak reagoi "i trembur" duke thënë: "Ku kam unë aq lekë?!". Mirëpo miku i tij italian vazhdoi ta bindte, se ky ishte një okazion i shkëlqyet për të dhe i ofroi ndërkohë edhe garanci të shumta, të tilla, që blerjen e bënin veprim thuajse pa asnjë risk. Nën efektin e këtyre garancive, Krienko Memo i bleu vilat, duke marrë një kredi, të cilën e shleu në një kohë të shkurtër dhe zhvillimet e mëvonshme i zbuluan akoma më shumë dashamirësinë e partnerit italian, i cili nuk kërkoi në Shqipëri blerësin më të mirë e më me interes për të, por vlerësoi së tepërmi miqësinë dhe përkushtimin e Krienkos, duke e shpërblyer atë me një ofertë, përfitimet e të cilës u bënë të qarta me kalimin e kohës.

Me ikjen e kompanisë italiane, ai do të lidhej me një firmë tjetër italiane në Leçe, "Romano S.P.A", pronare e markës "Meltin' Pot". Me bashkëpunëtorin e tij më të ngushtë Carmelo Romano (i ndarë nga jeta kohë më parë), krijoi një bashkëpunim shumë të suksesshëm në gjetjen e tregjeve nordike.

Duke qenë se kjo kompani ka pasur një

department, embroidery, printing, a wrinkling department, packaging departments, industrial laundry, etc., and many of these processes are done by hand, combining sewing with modern machinery and hand sewing for some visual processes. Initially, the products were exported unfinished to Florence, as we had not yet invested in the industrial laundry, which is now one of the largest in the Balkans, exporting throughout Europe. Initially, they produced 100 different garments per day, while today they have reached up to 4,000 such pieces, being flexible in the market, with over 25 new models per month and at competitive prices".

Mr. Krienko has received special recognition from the Fier district as "Honor of the District" and the Municipality of Fier, for reducing unemployment, contributing to the regional development of the city, and caring for the environment.

The infamous year of 1997 for all Albanians caused the Italian firm to withdraw. But even at this moment, Krienko Memo reaped the fruits of a sincere and loyal partnership with his Italian partner, who had bought several villas in Sauk, Tirana. When he had to leave, he invited Krienko Memo and offered him the purchase of these villas. When he heard the price, the businessman from Fier reacted "fearfully" saying, "Where would I get that much money?!". However, his Italian friend continued to convince him that this was an excellent opportunity for him and offered numerous guarantees, making the purchase almost risk-free. Under these guarantees, Krienko Memo bought the villas, taking a loan, which he paid off in a short time, and later developments revealed even more the goodwill of the Italian





bashkëpunim të frytshëm me firmat prestigjioze, me gjithë sigurinë e plotë, ato tashmë mund të prodhojnë veshje të një cilësie të lartë, krahasuar këto me tregjet ndërkombëtare dhe firmat më me emër sot në botë. Tek Krienko Jeans prodhohen modele të reja veshjesh, çka do të thotë xhinse të një cilësie të lartë, bluza, këmisha, për djem dhe vajza, por edhe për mosha më të mëdha. Më e rëndësishmja është se çmimet janë shumë konkurruese.

Aktualisht, “Krienko Jeans” gjendet në qendrat tregtare më të mëdha të Shqipërisë, me nëntë dyqane të çelura, të arreguara nga arkitektë italianë, ku ndërthuren druri, hekuri dhe guri. Tani do të jenë të pranishëm edhe në Prishtinë dhe duan të dalin edhe në Montreal dhe Milano, me prodhimet e tyre. Shumë me rëndësi për klientët e Krienkos është fakti se të gjitha materialet që ata përdorin për prodhimin e veshjeve, janë të një cilësie shumë të lartë.

partner, who did not seek the best and most profitable buyer in Albania but greatly valued Krienko’s friendship and dedication, rewarding him with an offer whose benefits became clear over time. With the departure of the Italian company, he would connect with another Italian firm in Lecce, “Romano S.P.A”, owner of the “Meltin’ Pot” brand. With his closest collaborator Carmelo Romano (who passed away some time ago), he created a very successful collaboration in finding Nordic markets.

Since this company has had a fruitful cooperation with prestigious firms, with complete certainty, they can now produce high-quality garments, comparable to international markets and the world’s most renowned brands. At Krienko Jeans, new clothing models are produced, meaning high-quality jeans, shirts, and blouses for boys and girls, but also for older ages. The most important thing is that the prices are very competitive. Currently, “Krienko Jeans” can be found in the largest shopping centers in Albania, with nine stores opened, designed by Italian architects, combining wood, iron, and stone. Now they will also be present in Pristina and aim to expand to Montreal and Milan with their products. Very important for Krienko’s customers is the fact that all the materials they use for producing clothes are of very high quality.





ARJETA PUCA

Presidente e kompanisë "Timak"

Emri i kompanisë: Timak
Numri i punonjësve: 25
Vendndodhja: Tiranë

ARJETA PUCA

President of "Timak" Company

Company Name: Timak
No. of employees: 25
Location: Tirana

Mund të thuhet tashmë se Arjeta Puca është një person i njohur, e pse jo, edhe i famshëm, në Shqipëri. Për të shkruajnë e flasin mediat e ndryshme, e thërrasi për intervista nëpër televizione ose podcaste, por ndryshe nga shumë të rinj të tjerë, Arjeta Puca ka prodhuar shkakun real për t'u bërë e njohur. Ka krijuar diçka të rëndësishme dhe të veçantë, që i "detyron" mediat e ndryshme ta kenë personazh të tyre. Ajo ka themeluar dhe drejton kompaninë "Timak", objekti i veprimtarisë së të cilës është prodhimi i autoambulancave, zjarrfikësve, makinave të policisë, makinave ushtarake, etj.

Në pak vjet ia ka dalë të prodhojë disa qindra të tilla mjete, e së fundi dhe prototipin e makinës së parë të blinduar ushtarake, e cila do të ekspozohet në panairin Eurosatory në Paris. Nën moton "gratë në timonin e ndryshimit", zonja Puca po ndërton të ardhmen e saj në Shqipëri, pas kthimit nga emigracioni. "Pas 25 viteve të ngarkuara me mall për Shqipërinë, më në fund e vendosa të kthehem. Në familje vazhdimisht dëgjoja të thuhet "do kthehemi në Shqipëri". Nuk dija asgjë, thjesht kisha mallin për vendin tim", nis rrëfimin, Arjeta Puca, themeluese e Kompanisë "Timak".

Arjeta Puca is now a well-known and even famous figure in Albania. The media frequently writes and talks about her, inviting her for interviews on television and podcasts. Unlike many other young people, Arjeta Puca has earned her recognition through substantial achievements. She has founded and leads the company "Timak," which specializes in manufacturing ambulances, fire trucks, police cars, military vehicles, and more.

In just a few years, she has managed to produce several hundred of these vehicles, including the prototype of the first armored military vehicle, which will be showcased at the Eurosatory fair in Paris. Under the motto "Women behind the wheel of change," Arjeta Puca is building her future in Albania after returning from emigration. "After 25 years filled with longing for Albania, I finally decided to return. In my family, I always heard, 'We will return to Albania.' I knew nothing, just had a deep longing for my country," begins Arjeta Puca, the founder of "Timak."

Arjeta, originally from Dibra, returned to Albania after 25 years, having left for Ankara, Turkey, with her parents in the early 1990s when

Adresa: Tirana Industrial Park, Nr. 37
Tel +355 69 2056663
Cel +355 4 4803383
E-Mail: info@timak.com

Address: Tirana Industrial Park, Nr. 37
Phone +355 69 2056663
Mobile +355 4 4803383
E-Mail: info@timak.com



Arjeta është vajza nga Dibra që pas vitesh 25 vitesh vendosi të rikthehet në Shqipëri, prej nga ishte larguar për në Ankara të Turqisë me prindërit në fillim të viteve '90, në moshën 4-vjeçare. E arsimuar në degën e inxhinierisë kompjuterike, me një përvojë pune në Japoni dhe Gjermani, ajo vendosi të sjellë me vete gjithë çka kish fituar krah prindërve. Ata zotërojnë një kompani për prodhimin e makinerive borëpastruese si dhe të atyre për panelet diellore prej gati 20 vitesh në Ankara. Fillimi pas rikthimit para nëntë vjetësh ishte i vështirë.

“Fillimi ishte i vështirë, nuk e dija mirë gjuhën, nuk kisha shoqëri, e ndjeja veten të izoluar. Përpiqesha të krijoja rrjetin e duhur të komunikimit, të mësoja sa më shumë. Ka qenë më shumë mësim dhe krijim i njohjeve të reja. Kam mësuar jashtë mase shumë. Puna ime e parë ka qenë shitja e automjeteve borëpastruese. Nuk ka pasur shumë kërkesë dhe bëja çdo punë tjetër”, tregon Arjeta. Por ajo nuk dorëzohet, dhe krijon Kompaninë “Timak” si një nismë për shtimin e produkteve “Made in Albania”. Gjatë fillimeve të punës që bazohet në tregtimin e automjeteve të ndryshme, Arjeta tregon se e tërhoqi autoambulanca dhe ia doli ta prodhonte atë për herë të parë në Shqipëri.

“Dy deri në tri vite nuk kishte punë, thjesht bëja aplikime. Në kohën e Covid19 ishte kaos. Më pas filluam prodhimin e autoambulancave. Në bashkëpunim me një kompani në fillim për prodhimin e tyre. Ajo na e la punën në mes



she was just four years old. She was educated in computer engineering and gained work experience in Japan and Germany. She brought back all the knowledge and skills she had acquired while working alongside her parents, who have owned a company producing snowplows and solar panel machinery for nearly 20 years in Ankara. The beginning after returning nine years ago was tough.

“The start was difficult; I didn’t know the language well, had no friends, and felt isolated. I tried to build the right communication network and learn as much as I could. It was mostly about learning and creating new connections. I learned an enormous amount. My first job was selling snowplows. There wasn’t much demand, so I did any job available,” Arjeta explains. But she didn’t give up and founded “Timak” as an initiative to increase “Made in Albania” products. During the early days, focused on trading various vehicles, Arjeta was drawn to ambulances and managed to produce them for the first time in Albania.



dhe e përfunduar vetë. Pas kësaj filluan të vijnë kërkesa të tjera. Patëm dhe kërkesa për prodhimin e makinave zjarrfikëse, të makinave të policisë apo të klinikave mjekësore të lëvizshme. Për të gjitha ne thamë po. I studiuam dhe i bëmë. Për Ukrainën në morëm një kërkesë nga OKB-ja për të prodhuar autoambulanca. Ia dolëm të prodhojmë 11 të tilla për dy javë. Kemi punuar natë-ditë”, shprehet ajo.

Kjo ishte një pikënisje e fortë dhe sot kompania e themeluar prej saj, e cila ka në qendër punën e vajzave, prodhon disa lloj automjeteve dhe i tregon ato në më shumë se 20 shtete.

Së fundi Arjeta synon të prekë një tjetër përmasë. “Shota” quhet prototipi i makinës së parë të blinduar ushtarake të prodhuar në Shqipëri nga kompania “Timak”, e themeluar prej saj 8 vjet më parë. Ka zgjedhur emrin e luftëtares shqiptare “Shota”, që luftoi për mbrojtjen e trojeve shqiptare, në fillim të shekullit të kaluar.

“Ishte shumë e mundimshme. E kemi projektuar për dy muaj. Kemi pasur mbështetjen e dizajnerit shqiptar Gregor Andoni. Bashkë

“For two to three years, there was no work, just applications. During the Covid-19 pandemic, it was chaotic. Then we started producing ambulances. Initially, we partnered with a company for their production. They left the work midway, and we finished it ourselves. After that, more requests came in. We received orders to produce fire trucks, police cars, and mobile medical clinics. We said yes to all of them, studied, and made them. For Ukraine, we received a request from the UN to produce ambulances. We managed to produce 11 in two weeks, working day and night,” she says.

This was a strong starting point, and today, the company she founded, which focuses on women’s work, produces various types of vehicles and exports them to over 20 countries.

Recently, Arjeta aims to reach another milestone. “Shota” is the prototype of the first armored military vehicle produced in Albania by “Timak,” founded by her eight years ago. She chose the name of the Albanian fighter “Shota,” who fought to defend Albanian territories at the beginning of the last century.





me inxhinierët dhe vajzat e stafit kemi punuar me shumë emocione, sepse është makina e parë ushtarake shqiptare. Ne emrin e kishim lënë surprizë. Të gjithë ishin të emocionuar për emrin kur e panë. Kemi punuar me të vërtetë me shumë dashuri”, thregon Arjeta Puca.

Makina ushtarake, vepër e mendjes dhe pasionit të një vajze si Arjeta Puca, u ekspozua në panairin e mbrojtjes dhe të sigurisë “Eurosatory” në Paris nga data 17 deri më 21 qershor, ku morën pjesë rreth 60 vende. Shqipëria u përfaqësua me ‘Shotën’ e Kompanisë “Timak”, nën logon “Gratë në timonin e ndryshimit”. Arjeta është e rrethuar nga 20 vajza. Ka zgjedhur të punojë me to, të ofrojë dhe të marrë prej tyre më të mirën. “Nuk është projekti i parë kaq sfidues. Na pëlqejnë sfidat dhe gjithmonë i marrim përsipër. Nuk i themi jo asnjë oferte dhe projekti të ri”, thotë ajo.

Por “Timak” a është rastësi, produkt rrethanash, apo ka një bazë reale dhe Arjeta Puca a ka arritur deri këtu si destinim dhe si ndjekje e ëndrrës së saj? E vërteta është se botëkuptimi profesional i Arjetës është mburrur në industrinë automotivë nëpërmjet intershipeve të ndryshme, nëpërmjet punëve të realizuara në kompani të këtij lloji, etj. Por edhe më herët, Arjeta përfaqëson fëmijën që është mësuar herët me “hekurat” e makinës, pasi që e vogël shkonte pas të atit.

Arjeta Puca është në fillimet e rrugës për realizimin e ëndrrave të bukura të saj, të cilat janë shumë më të avancuara e të sofistikuar sesa këto që ia ka dalë mbanë të realizojë deri tani.

“It was very challenging. We designed it in two months with the support of Albanian designer Gregor Andoni. Together with the engineers and the female staff, we worked with great emotions because it is the first Albanian military vehicle. We kept the name a surprise. Everyone was excited about the name when they saw it. We truly worked with a lot of love,” Arjeta Puca explains.

The military vehicle, a product of the mind and passion of a woman like Arjeta Puca, was exhibited at the “Eurosatory” defense and security fair in Paris from June 17 to 21, where around 60 countries participated. Albania was represented by “Shota” from the “Timak” company, under the logo “Women behind the wheel of change.” Arjeta is surrounded by 20 women. She has chosen to work with them, offering and receiving the best from them. “This is not the first challenging project. We like challenges and always take them on. We don’t say no to any new offer or project,” she says.

But is “Timak” a coincidence, a product of circumstances, or does it have a real foundation, and has Arjeta Puca reached this point as a destination and pursuit of her dream? The truth is that Arjeta’s professional outlook has been shaped in the automotive industry through various internships and jobs at companies of this kind. Even earlier, Arjeta represented a child accustomed early to the “irons” of machinery, as she would follow her father around from a young age.

Arjeta Puca is at the beginning of her journey to realize her beautiful dreams, which are much more advanced and sophisticated than what she has achieved so far.



Renditja e kompanive më të mëdha, sipas fitimeve (euro)

NR	Subjekti	Aktiviteti	FITIMI
			2023
1	BANKA KOMBETARE TREGTARE	Veprimtari bankare	76 415 194
2	RAIFFEISEN BANK SH.A	Veprimtari bankare	76 018 718
3	DEVOLL HYDROPOWER	Prodhim energjie elektrike	65 085 091
4	OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT OST	Transmetim i energjise elektrike	59 669 987
5	KURUM INTERNATIONAL SH.A.	Prodhim hekuri	51 249 002
6	TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK	Sherbime aeroportuale	40 585 469
7	BANKA OTP ALBANIA	Veprimtari bankare	39 680 097
8	INTEGA SANPAOLO BANK ALBANIA	Veprimtari bankare	35 456 194
9	ANTEA CEMENT	Prodhim dhe tregtim l cimentos	33 236 728
10	GJOKA KONSTRUKSION	Punime infrastrukture	32 560 223
11	BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA	Veprimtari bankare	30 410 155
12	BANKA E TIRANES	Veprimtari bankare	22 766 786
13	CREDINS BANK	Veprimtari financiare	21 000 000
14	GSA	Import energjie elektrike, prodhim ferrokrom	17 901 233
15	ITX ALBANIA	Tregtim veshjesh	16 734 039
16	ENERGJI ASHTA	Prodhim dhe tregtim l energjise elektrike	16 346 604
17	KASTRATI GROUP	Tregti hidrokarburesh	13 460 435
18	AYEN AS ENERGJI	Prodhim energjie elektrike	12 366 591
19	SHOQËRI E THJESHTË INTEKAR - ASL	Projekti i tunelit të Llogarasë	12 288 397
20	FIRST INVESTMENT BANK- ALBANIA	Veprimtari bankare	11 984 029
21	TIRANA EAST GATE	Oender tregtare	11 126 508
22	ROSSMANN-LALA	Zinxhir supermarketesh	10 854 369
23	E. H. W.	Përpunim mishi	10 705 331
